



Republika e Shqipërisë

Ministri për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit e Komunikimit

**Amendimet e propozuara në
ligjin 9918 për komunikimet elektronike
dhe ligjet e tjera të lidhura me të**

Maj 2010

Versioni shqip

Përmbledhje

Ky dokument përmban projekt propozimet për amendimin e legjislacionit shqiptar, në veçanti ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008, për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë.

Ky projekt propozim është përgatitur nga grupi i punës i udhëhequr nga Ministri i Shtetit për Reformë dhe Marrëdhënie me Kuvendin, mbështetur nga Projekti i BERZH-it për Zhvillimin Rregullator të Komunikacioneve.

Titulli i dokumentit do të jetë “Amendimet në ligjin 9918”.

Projekt propozimi është përgatitur sipas objektivave si vijon:

Harmonizim i plotë me kuadrin rregullator të BE-së për vitin 2002 për komunikimet elektronike

Ligji nr. 9918 është bazuar në kuadrin rregullator të BE-së për vitin 2002 për komunikimet elektronike (Direktivat 2002/19/EC, 2002/20/EC, 2002/21/EC, 2002/22/EC dhe 2002/58/EC. Megjithatë, përvoja ka treguar se disa nga nenet e ligjit nr 9918 nuk janë plotësisht të harmonizuara me kuadrin e BE-së dhe në këtë draft propozohen amendime në këto nene.

Në veçanti, këto amendime përfshijnë si vijon:

- afate kohore më të shkurtëra për përgjigjet e AKEP-it ndaj njoftimeve (neni 14) dhe aplikimeve për numra (neni 82);
- rregulla më të qarta për pagesat administrative të arkëtuara nga AKEP, të cilat duhet të bazohen në shpenzimet e AKEP (nenet 24, 78, 86 dhe 117);
- saktësimi se vendimet e AKEP duhet të jenë proporcionale (nenet 16 dhe 34);
- rregulla më të qarta për procedurat për dhënie e frekuencave të kufizuara nëpërmjet konkurrimit publik (nenet 68 dhe 69), me afate kohore për çdo hap të procedurës dhe shpërndarje më të qartë të përgjegjësisë të AKEP dhe Ministrit; dhe
- forcimin e rolit të AKEP-it lidhur me mbrojtjen e konsumatorëve duke futur një procedurë për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërmjet konsumatorëve dhe sipërmarrësve jashtë gjykatave (nenet e reja 120/1).

Amendimet e propozuara në ligjin 9918 për komunikimet elektronike

- Amendimet e propozuara në ligjin 8410 e bëjnë të ratë që rrjetet e televizionit kabllor (infrastruktura) nuk janë kompetencë e ligjit 8410 por e ligjit 9918, që do të thotë se liçenca nuk është e nevojshme për këto rrjete. Gjithashtu e bëjnë të qartë se programet e televizionit kabllor (përmbajtja) rregullohen sipas ligjit 8410 si edhe programet kombëtare tokësore. Po punohet veçanërisht në zëvendësimin e plotë të ligjit 8410 me një ligj të ri për mediat audio vizuale.

Transpozimi i kuadrit rregullator të BE-së për komunikimet elektronike të vitit 2009

Direktivat e BE-së të vitit 2002 janë amenduar në vitin 2009 me Direktivat 2009/136/EC dhe 2009/140/EC. Këto dy direktiva përfshijnë një numër ndryshimesh. Shumë prej këtyre ndryshimeve janë vetëm saktësime të rregullave të paraqitura me Direktivat e vitit 2002.

Shtetet anëtare të BE-së duhet të transpozojnë dispozitat e reja në ligjet e tyre kombëtare deri në maj të vitit 2011. Drafti i paraqitur në këtë dokument parashikon amendimet e duhura në ligjin 9918 në mënyrë që legjislacioni shqiptar të jetë në përputhje të plotë me *acquis*.

Amendimet e prozuara si vijon janë veçanërisht të rëndësishme:

- Çështja thelbësore e kuadrit rregullator të BE-së të vitit 2009 është bashkëpunimi i rritur në nivel të BE-së. Shqipëria ende nuk mund të marrë pjesë plotësisht në këtë bashkëpunim, por një fjali shtesë në nenin 7 pika 1 e ligjit do të detyrojë AKEP-in të marrë parasysh rekomandimet përkatëse dhe vendimet e Komisionit Europian si dhe Organin e sapo ngritur të Rregullatorëve Europianë për Komunikimet Elektronike (BEREC)
- Amendimet në nenin 62 do të garantojnë se menaxhimi i radio frekuencave është në parim asnjëherë ndaj teknologjisë dhe shërbimit. Paanshmëria e shërbimit do të thotë se përdoruesit e radio frekuencave mund të përdorin frekuencat e caktuara për çdo lloj shërbimi (për shembull telefoni zanore, aksesin në Internet me brez të gjerë ose shpërndarjen e përmbajtjes multimediale). Paanshmëria teknologjike do të thotë se përdoruesit e radio frekuencave mund të përdorin çdo teknologji të mundshme (për shembull GSM, UMTS ose LTE). Dispozitat e reja gjithashtu përfshijnë përjashtimet e mundshme nga këto dy parime.
- Dispozitat për portabilitetin e numrit do të zgjerohen në parim për të gjithë numrat e Planit Kombëtar të Numeracionit dhe në parim, numrat do të barten brenda një dite pune. Kjo kërkesë e dalë nga Direktiva e amenduar e Shërbimit Universal tashmë është marrë parasysh nga AKEP në përgatitjen e rregullores për portabilitetin e numrit.
- Kuadri rregullator i BE-së i vitit 2009 paraqet disa dispozita për të forcuar të drejtat e konsumatorëve dhe të drejtat e përdoruesve me aftësi të kufizuara. Për shembull, periudha fillestare e detyruar me kontratë nuk duhet të jetë më shumë se 24 muaj dhe gjithashtu, operatorët duhet të ofrojnë kontrata me

Amendimet e propozuara në ligjin 9918 për komunikimet elektronike

një kohëzgjatje maksimale prej 12 muajve (neni 99 pika 3). Në rastet e shkeljes së sigurisë së të dhënave personale, operatorët duhet të informojnë AKEP-in dhe pajtëtarët e prekur (neni 122).

Funksionimi i AKEP-it

Ky projekt propozim përmban disa dispozita lidhur me funksionimin e brendshëm të AKEP-it:

Sipas ligjit aktual Kryetari i Këshillit Drejtues të AKEP-it është gjithashtu Drejtor Ekzekutiv. Kjo do të thotë që personi i njëjtë duhet të përmbushë dy role: si kryetar të drejtojë Këshillin Drejtues (megjithëse duke pasur të njëjtën të drejtë vote si katër anëtarët e tjerë të Këshillit) dhe si Drejtor Ekzekutiv duke qenë në vartësi të Këshillit Drejtues.

Drafti parashikon ndarjen e dy funksioneve në mënyrë që të bëhet një ndarje më e qartë ndërmjet vendim-marrjes, detyrave strategjike dhe drejtuese të Këshillit Drejtues dhe detyrave administrative. Drejtori Ekzekutiv do të zgjedhet nga Këshilli Drejtues, ai është përgjegjës ndaj Këshillit Drejtues dhe mund të shkarkohet ose lirohet nga Këshilli Drejtues. Ky është një post administrative dhe personi i përzgjedhur duhet të ketë përvojë në drejtim e menaxhim institucioni. Neni i ri i propozuar 116/1 përmban përcaktimet kryesore.

Lidhur me anëtarët e Këshillit Drejtues të AKEP-it, projekt propozimi parashikon që anëtarët e Këshillit mund të rëmërohen (maksimalisht edhe dy periudha të njëpasnjëshme në detyrë). Pasi që njohuritë institucionale humbasin me skadimin e periudhës së shërbimit në të njëjtën ditë për të gjithë anëtarët, projekt propozimi parashikon se Këshilli i ardhshëm do të ketë një ndryshim të periudhave në detyrë të anëtarëve të Këshillit, pesë vjet (Kryetari), katër vjet (dy anëtarë) dhe tre vjet (dy anëtarët e tjerë). Megjithatë, kjo do të aplikohet vetëm njëherë pasi të ketë përfunduar periudha e në detyrë e anëtarëve aktualë të Këshillit Drejtues. Neni 116 pika 3 e qartëson se vetëm një anëtar i shkarkuar i Këshillit Drejtues nuk mund të emërohet përsëri, kurse anëtarët të cilët janë liruar pa shkelje (për shembull me kërkesë të tyre ose për shkak të pamundësisë së përkohshme fizike) mund të rëmërohen.

Nenet e reja të propozuara 116/2 dhe 116/4 rregullojnë kompetencat e Këshillit Drejtues, Kryetarit dhe Drejtorit Ekzekutiv. Këto nene fokusohen në rolet drejtuese, ndarjen e fuqive ndërmjet organeve të ndryshme dhe përgjegjësitë, për të shmangur bllokimin e veprimtarisë së organizatës sic ka ndodhur disa here vitet e fundit. Ato synojnë të rrisin kapacitetet ekzekutive në zbatim të detyrave të këtij ligji, dhe realizim të objektivave e planeve strategjike të qeverisë në këto sektor, duke e bërë organizatën eficiente dhe efektive.

Dispozitat për gjokat

Dispozitat e reja të propozuara për gjokat janë të bazuara në vlerësimet si vijon:

Amendimet e propozuara në ligjin 9918 për komunikimet elektronike

Gjobat më të rënda trajtojnë shkelje serioze të konkurrencës, në veçanti mos respektimin me detyrimet e vendosura mbi operatorët me fuqi të ndjeshme në treg pas analizave të tregut. Vendosja e këtyre gjobave zakonisht kërkon një analizë komplekse që përfshin specialistë nga disa drejtori. Gjobat të cilat janë të rënda duhet të vendosen nga Këshilli Drejtues i AKEP-it dhe jo nga inspektorë individualë të AKEP-it të cilët mund të hezitojnë në vendosjen e gjobave më të rënda.

Prandaj, projekt propozimi përmban nenin e ri 136 për gjobat e vendosura për shkelje serioze të vendosura nga Këshilli Drejtues si dhe nenin e ri 137 për shkeljet e tjera të vendosura nga Inspektorët.

Niveli aktual i gjobave është shumë i lartë dhe në veçanti hapësira e vogël ndërmjet gjobës maksimale dhe minimale nuk duket e përshtatshme, si lidhur me ndarjen e kategorive e shkeljeve të shkeljeve ashtu edhe lidhur me hapësirën për zgjedhjen e gjobës për secilën kategori. Aktualisht, ka një ndryshim prej vetëm 10% ndërmjet rasteve më të rënda (pragu i sipërm: 10% të xhiros) dhe rasteve më pak të rëndësishme (pragu i sipërm: 1% të xhiros). Brenda secilës kategori, gjoba minimale është rreth 50% deri 70% të gjobës maksimale. Por, për shembull, mos respektimi i detyrimeve për t'i dhënë akses konkurrentëve mund të ketë ndikim të rëndë për ata (nëse akses refuzohet plotësisht) ose ndikim më të vogël (nëse refuzohet implementimi i disa detajeve).

Prandaj, projekt propozimi parashikon një shkallë më të gjerë lirie në zgjedhjen e gjobave të përshtatshme bazuar në peshën dhe kohëzgjatjen e shkeljes. Brenda secilës kategori të gjobave, vetëm pragu i sipërm është përcaktuar me ligj, kurse pragu i poshtëm është zero. Dispozita e re (neni 137/1) ofron udhëzim për përdorimin e hapësirës brenda gjobës minimale dhe maksimale.

Lista e ndryshimeve të propozuara

Çdo rradhë e kësaj tablele përmban numrin e neneve përkatëse të ligjit 9918, indikim për arësyen për të cilën janë propozuar ndryshimet, tekstin aktual të nenit përkatës, tekstin e ri të propozuar dhe shpjegimet. Arsyeja mund të jetë:

- BE 2002: harmonizim i plotë me kuadrin rregullator të vitit 2002
- BE 2009: harmonizim i plotë me kuadrin rregullator të vitit 2009
- të tjera: ndryshime të tjera të propozuara të cilat nuk janë vetëm të natyrës redaksionale, por jo të domosdoshme për harmonizim me acquis: ose
- ndryshime redaksionale

Neni	Arsyeja	Teksti aktual	Teksti i propozuar	Shpjegim
3	BE 2009	<p>4. “Facilitet”, si pjesë e infrastrukturës shoqëruese të komunikimeve elektronike, përfshin ndërtesën, pjesë të një ndërtese, apo mjediset e pavarura brenda një ndërtese ku janë instaluar pajisje të komunikimeve elektronike, si edhe elemente ndërtimore, të tilla si tubacione kabllore, shtylla, antena etj.</p> <p>5. “Facilitete shoqëruese” janë facilitetet e lidhura me një rrjet të komunikimeve elektronike dhe/ose një shërbim të komunikimeve elektronike, të cilat mundësojnë ose mbështesin ofrimin e shërbimeve nëpërmjet këtij rrjeti ose shërbimi.</p> <p>45. “Shërbim telefonik i disponueshëm për publikun” është një shërbim i disponueshëm për publikun për origjinimin dhe marrjen e thirrjeve kombëtare dhe ndërkombëtare dhe aksesin në shërbimet e emergjencës nëpërmjet</p>	<p>4. (hiqet)</p> <p>5. “Facilitete shoqëruese” janë ato shërbime shoqëruese, infrastrukturë fizike dhe facilitete të tjera ose elemente të lidhura me një rrjet të komunikimeve elektronike dhe/ose një shërbim të komunikimeve elektronike të cilat mundësojnë dhe/ose mbështesin ofrimin e shërbimeve nëpërmjet të rrjeteve dhe/ose shërbimeve ose kanë potencial për ta bërë këtë, dhe përfshijnë ndërmjet të tjerash ndërtesa ose hyrje në ndërtesa, kabllot e ndërtesave, antena, kulla dhe ndërtime të tjera mbështetëse, kanale, tuba, shtylla, puseta dhe kabinete;</p> <p>45. Shërbim telefonik i disponueshëm për publikun” është një shërbim i disponueshëm për publikun për origjinimin</p>	<p>Për shumicën e përkufizimeve të reja në direktivat e amenduara të BE-së transpozimi nuk është i nevojshëm, pasi amendimet në nivel të BE-së janë vetëm sqarime të mëtejshme apo pasi formulimi i ri është marrë tashmë parasysh në ligjin 9918. Gjithsesi kjo duhet shqyrtuar serish gjatë procesit të hartimit. .</p> <p>Përkufizimi I vjetër I “shërbim telefonik në dispozicion të publikut” (PATS) në nenin 2 pika c) e Direktivës së Shërbimit Universal ishte mjaft e gjatë dhe përmbantë një deklaratë “rrethore”. Ishte pjesë e përkufizimit të PATS të ofrojë akses për shërbimet e urgjencës, por në anën tjetër ofruerit e PATS ishin të detyruar ta ofronin këtë akses. Kjo shkaktonte konfuzion nëse disa shërbime VoIP duhet të detyrohen të ofrojnë akses në shërbimet e urgjencës apo nëse ato nuk mund të detyrohen pasi ato nuk janë PATS.</p>

Amendimet e propozuara në ligjin 9918 për komunikimet elektronike

Neni	Arsyeja	Teksti aktual	Teksti i propozuar	Shpjegim
		<p>një ose më shumë numrave në një plan numeracioni telefonik. Ky shërbim mund të përfshijë ofrimin e një ose më shumë nga shërbimet e mëposhtme:</p> <p>a) shërbimin e operatorit;</p> <p>b) rubrikën e shërbimeve të kërkimit të informacionit, numeratorin telefonik;</p> <p>c) ofrimin e telefonave publikë me pagesë;</p> <p>ç) shërbimet në kushte të veçanta, sipas përcaktimeve në pikën 3 të nenit 27 të këtij ligji;</p> <p>d) ofrimin e pajisjeve fundore të veçanta të telekomunikacioneve për konsumatorë me aftësi të kufizuara ose nevoja sociale të veçanta; dh) aksesin në shërbimet me numra jogeografikë</p>	<p>dhe marrjen e drejtpërdrejtë ose jo të drejtpërdrejtë të thirrjeve kombëtare ose kombëtare dhe ndërkombëtare nëpërmjet një ose më shumë numrave në një plan numeracioni telefonik kombëtar apo ndërkombëtar.</p> <p>x1. “Organi i Rregullatorëve Europeanë për Komunikimet Elektronike”, organ i krijuar nga Rregullorja (KE) Nr 1211/2009 i Parlamentit European dhe të Këshillit të 25 nëntorit 2009;</p> <p>x2. “Caktimi (i një brezi frekuencash)“ hyrja në Planin Kombëtar të Frekuencave e një brezi të dhënë frekuencash me qëllim përdorimi nga një ose më shumë shërbime radio-komunikimi sipas kushteve specifike’.</p> <p>x3. “Pranim” (Pëlqim): cdo shprehje specifike dhe e informuar e dëshirës, e dhënë në mënyrë të lirë nga personi sipas të cilës ai/ajo pranon dhënien e të dhënave personale që të përpunohen;</p> <p>x4. “shkelje e të dhënave personale” do të thotë cdo shkelje e sigurisë që con në shkatërrimin, humbjen, ndryshimin ose shpërndarjen aksidentale apo të paligjshme ose aksesin në të dhënat personale të transmetuara, të ruajtura ose të përpunuara në lidhje me ofrimin e një shërbimi të komunikimeve elektronike të disponueshëm për publikun;</p>	<p>Neni 3 pika 45 e ligjit 9918 transponon përkufizimin e vjetër dhe duhet të zëvendësohet nga përkufizimi I ri më i shkurtër.</p> <p>Propozim: të shtohet përkufizimi I “pëlqimit” dhe “shkeljes së të dhënave nga neni 2 I Direktivës së Privatësisë (të amenduar). Është shtuar një përkufizim për BEREC, pasi është i nevojshëm për nenin 7. KKRT sugjeron që të përfshihet përkufizimi për “vendosje” (allocation) dhe caktim (assignment) bazuar në rregulloren Radio të ITU-së. Ne shtuam një përkufizim të “vendosje” dhe korrigjuam terminologjinë në nenin 62.</p> <p>Në lidhje me “caktim”, ky term I Rregullores radio, përfshin autorizimin individual ose të përgjithshëm për të përdorur frekuencat. Në kontekstin e ligjit kombëtar është e nevojshme të bëhet dallimi mes ketyre dy koncepteve dhe ne nuk shohim nevojën për të shtuar termin “caktim” në përkufizimet ligjore.</p>
5	të tjera	Neni 5	Neni 5	Ne propozojmë që të rritet përgjegjshmëria e AKEP-it dhe raportimi në Parlament (shih

Amendimet e propozuara në ligjin 9918 për komunikimet elektronike

Neni	Arsyeja	Teksti aktual	Teksti i propozuar	Shpjegim
		<p>Kompetencat e Ministrit</p> <p>Ministri përgjegjës ka këto kompetenca:</p> <p>10. Miraton kufizimet e mundshme për dhënien e frekuencave dhe procedurat përkatëse të tenderimit për dhënien e tyre, bazuar në propozimet e AKEP-it.</p> <p>10/1. Emeron Drejtorin Ekzekutiv të AKEP</p> <p>...</p> <p>12. Bashkërendon shërbimet kombëtare të radiondërlidhjes bregdetare.</p> <p>13. Mbështet veprimtarinë e radioamatorizmit në Republikën e Shqipërisë.</p>	<p>Kompetencat e Ministrit</p> <p>Ministri ka këto kompetenca:</p> <p>...</p> <p>10. Përcakton kufizimet e mundshme në caktimin e frekuencave të fundme dhe cmimin rezervë në bazë të propozimeve të AKEP-it.</p> <p>12. i raporton Kuvendit në fund të vitit për gjendjen e sektorit të komunikimeve elektronike dhe zbatimin e politikave të Këshillit të Ministrave.</p> <p>12 varianti i vjetër (hiqet)</p> <p>13 (hiqet)</p>	<p>nenin 9 më poshtë). Në këtë kontekst ne sugjerojmë që jo vetëm AKEP të paraqesë raportin para Parlamentit, por edhe Ministri. Raporti i ministrit mund të përqëndrohet në gjendjen e sektorit dhe zbatimin e politikave.</p> <p>Idealisht raporti vjetor dhe raporti i Ministrit duhet t'i paraqiten Kuvendit në të njëjtën kohë (rreth Prillit për vitin e shkuar kalendarik).</p> <p>Ndryshimet në pikën 10 pasqyrojnë përshkrimin më të detajuar të kompetencave në nenin 68 dhe 69 (shih më poshtë). Ne propozojmë që të fshihen pikat 12 dhe 13. Pika 12: radiondërlidhja bregdetare është një çështje e parëndësishme. Aktualisht rregullohet me një vendim të Këshillit të Ministrave, jo me ndonjë akt ligjor të Ministrit. Nuk ka rëndësi përsa i përket politikave dhe mund të rregullohet me një rregullore të AKEP-it bazuar në kapitullin e spektrit të ligjit.</p> <p>Pika 13: është e paqartë se çfarë lloj “mbështetjeje” nënkuptohet nga kjo pikë.</p>
7	BE 2009	<p>1. AKEP-i ushtron funksionet në përputhje me këtë ligj dhe me aktet e tjera ligjore, si dhe në përputhje me politikat sektoriale kombëtare të zhvillimit të komunikimeve elektronike dhe me marrëveshjet ndërkombëtare në fushën e komunikimeve elektronike, ku Republika e Shqipërisë është palë.</p>	<p>1. AKEP-i ushtron funksionet në përputhje me këtë ligj dhe me aktet e tjera normative, si dhe në përputhje me politikat sektoriale kombëtare të zhvillimit të komunikimeve elektronike dhe me marrëveshjet ndërkombëtare në fushën e komunikimeve elektronike, ku Republika e Shqipërisë është palë. AKEP merr parasysht rekomandimet përkatëse dhe vendimet e Komisionit Europian dhe të Organit të Rregullatorëve Europianë të Komunikimeve Elektronike (BEREC).</p>	<p>Mund të jetë shumë herët të transpozohen të gjitha dispozitat e detajuara për bashkëpunimin dhe bashkëveprimin ndërmjet AKEP-it dhe Komisionit Europian.</p> <p>Por do të ishte me vend që të shtohej një dispozitë sipas të cilës AKEP duhet të marrë parasysht rekomandimet dhe vendimet e Komisionit Europian dhe të Organit të ri të Rregullatorëve Europianë për Komunikimet Elektronike (BEREC).</p>

Amendimet e propozuara në ligjin 9918 për komunikimet elektronike

Neni	Arsyeja	Teksti aktual	Teksti i propozuar	Shpjegim
				<p>Ekzistonte një lloj shqetësimi se përmendja e rekomandimeve të BEREC në këtë kontekst mund të zgjaste procedurat e AKEP. Por dispozita e hartuar nuk do të detyronte AKEP që të njoftonte Komisionin Europian dhe BEREC-in për vendimet e veta dhe të priste opinionet e tyre. E ashtuquajtura procedurë e nenit 7 do të kërkohej vetëm pas anëtarësimit në BE dhe BEREC do të japë vetëm një “opinion” dhe jo një rekomandim. Ky projektligji përmend BEREC pasi ai do të japë rekomandime që do të jenë të nevojshme për të argumentuar dhe mbështetur vendimet e AKEP-it dhe meqë AKEP do të ketë statusin e vëzhguesit në BEREC kur Shqipëria të jetë vend kandidat për në BE.</p>
8	redaksionale	<p>Neni 8 Kompetencat e AKEP-it</p> <p>Për të përmbushur qëllimin dhe objektivat rregullatorë, të përcaktuara nga ky ligj, AKEP-i ka kompetencë:</p> <p>...</p> <p>q) kryen njohjen e konformitetit për pajisjet “radio” dhe pajisjet fundore të telekomunikacioneve;</p>	<p>Neni 8 Kompetencat e AKEP-it</p> <p>Për të përmbushur qëllimin dhe objektivat rregullatorë, të përcaktuara nga ky ligj, AKEP-i ka kompetencë:</p> <p>...</p> <p>q) të fshihet</p> <p>...</p> <p>t) të rregullojë shërbimin kombëtar për radiondërlidhjen bregdetare;</p> <p>u) të mbështesë veprimtarinë radio-amatore në Republikën e Shqipërisë;</p> <p>v) të garantojë gatishmërinë e një baze qendrore të dhënash për portabilitetin e</p>	<p>Këto amendime reflektojnë gjendjen aktuale të diskutimeve dhe mund të jetë e nevojshme të rishihen sërish kur projektligji të përfundohej.</p>

Amendimet e propozuara në ligjin 9918 për komunikimet elektronike

Neni	Arsyeja	Teksti aktual	Teksti i propozuar	Shpjegim
			numrit; w) të zgjidhë mosmarrëveshjet ndërmjet konsumatorëve dhe sipërmarrësve.	
9	të tjera	<p>Neni 9</p> <p>Raportimi i AKEP</p> <p>1. AKEP-i është përgjegjës për punën e tij përpara Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.</p> <p>2. Në përfundim të çdo viti, AKEP-i paraqet në Kuvend, brenda tremujorit të parë të vitit pasardhës, raportin vjetor të veprimtarisë së vitit pararendës.</p> <p>3. Raporti vjetor, i përmendur në pikën 2 të këtij neni, duhet të përmbajë në mënyrë të veçantë:</p> <p>a) raportin e punës së AKEP-it për vitin e mëparshëm;</p> <p>b) programin vjetor të punës për vitin në vazhdim;</p> <p>c) raportin për statusin e shërbimit universal;</p> <p>ç) raportimin për realizimin e treguesve financiarë vjetorë të AKEP-it.</p> <p>4. aporti vjetor i AKEP-it duhet të jetë i disponueshëm për publikun.</p>	<p>Neni 9</p> <p>Raportimi i AKEP</p> <p>1. i pandryshuara</p> <p>2. Në përfundim të çdo viti, AKEP-i paraqet në Kuvend, brenda katër muajve të parë të vitit pasardhës, raportin vjetor të veprimtarisë së vitit pararendës.</p> <p>3 dhe 4 të pandryshuar.</p> <p>5. Kuvendi do të diskutojë raportin vjetor të AKEP dhe raportin vjetor të Ministrit të paraqitur sipas nenit 5 pika 12 e këtij ligji brenda dy muajve pasi këto raporte të jenë paraqitur.</p>	<p>Pika e re e propozuar duhet të shtojë përgjegjshmërinë e AKEP duke garantuar që raporti vjetor I AKEP të diskutohet vërtet në Parlament.</p> <p>Shihni edhe amendimet e propozuara të nenit 5 më lart, sipas të cilit Ministri duhet të paraqesë një raport vjetor mbi gjendjen e sektorit të komunikimeve elektronike dhe zbatimin e Politikave.</p> <p>Afati për raportimin e AKEP-it do të shtyhet me një muaj, pasi kjo i jep mundësi AKEP-it që të përfshijë të dhënat e përditësuara të tregut në raport. Raportet e AKEP-it përfshijnë të dhënat e tregut, ashtu sic është praktika më e mirë e BE-së, por në fund të marsit disa të dhëna, vecanërisht të kontabilitetit të operatorëve nuk janë ende të gatshme. Shtyrja e afatit me një muaj e bën raportin vjetor të AKEP-it një dokument më të hollësishtëm.</p>
14	BE 2002	<p>5. AKEP-i regjistron operatorët ose ofruesit e shërbimit brenda 15 ditëve nga data e marrjes së njoftimit, në bazën elektronike të të dhënave, si dhe duhet t'u konfirmojë atyre me shkrim kryerjen e regjistrimit.</p> <p>6. Brenda 15 ditëve nga data e marrjes së një njoftimi jo të plotë në dokumentacion, sipas</p>	<p>5. AKEP-i regjistron operatorët ose ofruesit e shërbimit në bazën elektronike të të dhënave brenda 7 ditëve nga marrja e njoftimit, si dhe duhet t'u konfirmojë atyre me shkrim kryerjen e regjistrimit.</p> <p>6. Brenda 7 ditëve nga data e marrjes së një njoftimi jo të plotë në dokumentacion, sipas</p>	<p>Afati kohor prej 15 ditësh për lëshimin e një konfirmimi në nenin 14 pika 5 e ligjit 9918 është shumë I gjatë. Sipas nenit 9 të Direktivës së Autorizimit duhet të shkurtohet në një javë.</p> <p>Afatet kohore për procedurën në nenin 14 pika 6 duhet të amendohen gjithashtu. Meqë procedura është relativisht e thjeshtë ne do të</p>

Amendimet e propozuara në ligjin 9918 për komunikimet elektronike

Neni	Arsyeja	Teksti aktual	Teksti i propozuar	Shpjegim
		<p>kërkesave në pikat 2 e 3 të këtij neni, AKEP-i informon sipërmarrësin për nevojën e plotësimit të dokumentacionit të munguar. Plotësimi i dokumentacionit të kërkuar duhet të bëhet brenda një afati jo më pak se 10 ditë, por jo më shumë se 30 ditë nga data e njoftimit.</p>	<p>kërkesave në pikat 2 e 3 të këtij neni, AKEP-i informon sipërmarrësin për nevojën e plotësimit të informacionit të munguar. Nëse sipërmarrësi nuk e kompletton informacionin e munguar brenda 15 ditëve, AKEP do të informojë sipërmarrësin se nuk do ta regjistrojë atë. Sipërmarrësi mund të kërkojë një vendim të arsyetuar nga Këshilli drejtues për këtë çështje.</p>	<p>sugjerim të specifikohet një afat fiks për paraqitjen e informacionit të munguar, dhe të sqarohet se çfarë do të bëjë AKEP në rast se nuk paraqitet informacioni I munguar.</p> <p>Procesi njoftimit dhe i regjistrimit zakonisht nuk përfundon me një vendim formal. Projekti parashikon se edhe nëse një operator paraqet informacion të paplotë, njoftimi nuk refuzohet formalisht. Sidoqoftë, në rast mosmarrëveshjeje ndërmjet një operatori dhe AKEP-it Operatori duhet të ketë të drejtën të kërkojë një vendim formal i cili mund të apelohe në gjykatë (për shembull në rast se operatori mendon se shërbimi i tij është një shërbim i komunikimeve elektronike dhe për këtë ka të drejtën të interkonektojë, kurse AKEP mendon se nuk është një shërbim i komunikimeve elektronike).</p>
15	BE 2002 Dhe 2009	<p>Në autorizimin e përgjithshëm, AKEP-i vendos kushte për:</p> <p>...</p> <p>dh) mbrojtjen e konsumatorit;</p> <p>...</p> <p>l) detyrimin për të plotësuar standardet dhe specifikimet teknike të rrjeteve dhe të pajisjeve për ndërtimin e rrjeteve dhe ofrimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike, si dhe të shërbimeve e faciliteteve shoqëruese, sipas përcaktimeve të këtij ligji.</p>	<p>1. AKEP mund të vendosë kushte në autorizimin e përgjithshëm duke miratuar rregullore në fushat si më poshtë:</p> <p>...</p> <p>dh) mbrojtja e konsumatorit dhe aksesit për përdoruesit me aftësi të kufizuara;</p> <p>...</p> <p>l) detyrimin për të plotësuar standardet dhe specifikimet teknike të rrjeteve dhe të pajisjeve për ndërtimin e rrjeteve dhe ofrimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike, si dhe të shërbimeve e faciliteteve shoqëruese, sipas përcaktimeve të këtij ligji;</p> <p>ll) kushtet për përdorimin e mediave nga autoritetet publike deri tek publiku i gjerë</p>	<p>Ligji 9918 transpozoi listat e kushteve të shtojcës së Direktivës së Autorizimit (shih nenet 15, 71 dhe 83), por nuk transpozoi konceptin se kjo listë duhet të jetë një listë maksimale dhe ndonëse kushtet janë listuar në shtojcë ato duhet të vendosen vetëm nëse justifikohen objektivisht, janë jodiskriminuese, proporcionale dhe transparente. Propozimi: të sqarohet kjo me një pikë të re 2.</p> <p>Shtesa e propozuar e pikës dh) dhe pikat e reja ll) dhe m) marrin parasysh amendimet e kuadrit të BE të vitit 2009.</p> <p>Fjalja e parë e propozuar rishtazi shpjegon se si AKEP “përfshin” kushte në autorizimin e përgjithshëm. Autorizimi i përgjithshëm është</p>

Amendimet e propozuara në ligjin 9918 për komunikimet elektronike

Neni	Arsyeja	Teksti aktual	Teksti i propozuar	Shpjegim
			<p>për të paralajmëruar atë për kërcënimet e pashmangshme dhe katastrofat e mëdha; m)detyrimet për transparencë lidhur me kufizimet e lidhjeve pike fundore-pikë fundore ose kufizimet e aksesit ose përdorimit të shërbimeve dhe aplikimeve. 2.AKEP mund të miratojë rregullore vetëm në bazë të pikës 1 të këtij neni, nëse kushtet janë realisht të justifikueshme lidhur me rrjetin ose shërbimin në fjalë, mos-diskriminuese, proporcionale dhe transparente. AKEP nuk duhet të përfshijë në autorizimin e përgjithshëm kushte të cilat nuk janë të listuara në pikën 1 të këtij neni.</p>	<p>një kuadër ligjor dhe AKEP përfshin në këtë kuadër kushte duke miratuar një rregullore, që është një akt me natyrë të përgjithshme.</p>
16	BE 2002 dhe BE 2009	<p>Neni 16 Detyrimi për të dhënë informacion 1. Sipërmarrësit e rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike detyrohen t'i japin të dhëna dhe çdo informacion tjetër, të kërkuar nga ministri dhe AKEP-i, në funksion të përmbushjes së detyrave të përcaktuara nga ky ligj. 2. Lloji i të dhënave, afatet dhe mënyra e dërgimit të tyre përcaktohen përkatësisht nga organet kompetente.</p>	<p>Neni 16 Detyrimi për të dhënë informacion 1. Sipërmarrësit që ofrojnë rrjete ose shërbime të komunikimeve elektronike janë të detyruar t'i japin AKEP, me kërkesë të tij, çdo informacion të nevojshëm për të përmbushur detyrimet funksionale të AKEP sipas këtij ligji. 2. Në veçanti, AKEP mund të kërkojë informacion, duke përfshirë informacione financiare, të cilat janë të nevojshme për: a) verifikimin sistematik ose rast-pas-rasti të pajtueshmërisë me dispozitat e këtij ligji; b) procedurat për dhe vlerësimi i kërkesave për të garantuar të drejtat individuale; c) publikimin e përmbledhjeve krahasuese të cilësisë dhe çmimeve të shërbimeve në</p>	<p>Ligji aktual nuk përmban një rregull I cili detyron AKEP që të kërkojë informacion sipas parimit të proporcionalitetit. Nuk ka ndonjë dispozitë qendrore sipas të cilës AKEP të detyrohet të respektojë sekretet e biznesit, ndonëse ky parim përmendet në një sërë dispozitash. Neni I ri 16 mbështetet në nenin 5 të Direktivës Kuadër dhe në nenin 11 të Direktivës së Autorizimit, duke përfshirë amendimet e tyre. Në vecanti, pikat e propozuara 2 d) dhe 2 dh) fjalë e dytë, mbështeten në Direktivën kuadër e cila plotëson boshllëqet që ARrK kanë vënë re gjatë punës së tyre. Teksti do të krijonte vështirësi në lexim nëse cdo pikë do të thoshte “AKEP dhe Ministri” prandaj janë hartuar pesë pikat e para vetëm për AKEP dhe është shtuar pika gjashtë që thotë se</p>

Amendimet e propozuara në ligjin 9918 për komunikimet elektronike

Neni	Arsyeja	Teksti aktual	Teksti i propozuar	Shpjegim
			<p>interes të konsumatorit;</p> <p>ç) qëllime statistikore në përputhje me legjislacionin në fuqio ose që rrjedhin nga marrëveshje midis Republikës së Shqipërisë dhe organizatave ndërkombëtare;</p> <p>d) informacion lidhur me zhvillimet e ardhshme të rrjeteve ose shërbimeve të cilat mund të kenë ndikim në shërbimet me shumicë të cilat sipërmarrësit i ofrojnë konkurrentëve; dhe</p> <p>dh) analizën e tregjeve në përputhje me kapitullin VI të këtij ligji. Sipërmarrësve me fuqi të ndjeshme në treg për tregjet me shumicë gjithashtu mund t’ju kërkohet të paraqesin të dhënat e kontabilitetit për tregjet me pakicë të cilat shoqërohen me ato të tregjeve me shumicë.</p> <p>3. Sipërmarrësit do të ofrojnë informacion në kohë, sipas kërkesës dhe në përputhje me afatet kohore si dhe nivelin e detajeve të kërkuara nga AKEP.</p> <p>4. Informacioni i kërkuar nga AKEP do të jetë proporcional me përmbushjen e detyrave funksionale për të cilat është kërkuar dhe AKEP do të japë arsyet për të cilat ky informacion është kërkuar.</p> <p>5. Nëse informacioni është vlerësuar si konfidencial, AKEP do ta sigurojë atë në përputhje me gjithë legjislacionin përkatës për konfidencialitet tregtar (i biznesit). Nëse informacioni nuk është konfidencial, AKEP do të publikojë ose do ti vërë në</p>	<p>e njëjta gjë vlen për kërkesën për informacion nga Ministri.</p> <p>Në ligjin aktual mungon një dispozitë për masat administrative për të garantuar zbatimin e këtij detyrimi. Ne propozojmë që të shtohet një dispozitë e tillë. Shih, neni 136 pika 4a/1 më poshtë.</p>

Amendimet e propozuara në ligjin 9918 për komunikimet elektronike

Neni	Arsyeja	Teksti aktual	Teksti i propozuar	Shpjegim
			<p>dispozicion të publikut sipas kërkesës së tij, nëse kjo është e nevojshme për të krijuar një treg të hapur dhe konkurrues. Nëse konfidencialiteti i informacionit është i diskutueshëm, AKEP do të vendosë për konfidencialitetin pasi të ketë dëgjuar sipërmarrësin dhe të ketë vlerësuar interesat e sipërmarrësit për të trajtuar informacionin si konfidencial dhe interesave të publikut për të krijuar një treg të hapur dhe konkurrues.</p> <p>6. Sipërmarrësit të cilët ofrojnë rrjete ose shërbime të komunikimeve elektronike janë të detyruar ti paraqesin Ministrit, me kërkesë të tij, të gjithë informacionin e nevojshëm për të përmbushur detyrat funksionale të Ministrit sipas këtij ligji. Pikat 1 deri 5 të këtij neni aplikohen përkatësisht.</p>	
24	BE 2002	<p>Neni 24</p> <p>Pagesat për mbikëqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike</p> <p>1. Sipërmarrësit, që ofrojnë rrjete dhe/ose shërbime publike të komunikimit, janë të detyruar të paguajnë një pagesë vjetore për mbikëqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike nga AKEP-i. Kjo pagesë bëhet për të mbuluar kostot administrative të AKEP-it.</p> <p>2. Pagesa vjetore, e përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, nuk duhet të jetë më shumë se 0,5 për qind e së ardhurës vjetore të vitit kalendarik të mëparshëm.</p> <p>3. Sipërmarrësi duhet të bëjë pagesën vjetore</p>	<p>Neni 24</p> <p>Pagesat për mbikëqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike</p> <p>1. Me kërkesën e AKEP-it, sipërmarrësit, që ofrojnë rrjete dhe/ose shërbime publike të komunikimit, janë të detyruar të paguajnë një pagesë vjetore për mbikëqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike nga AKEP-i. Kjo pagesë bëhet për të mbuluar kostot administrative të AKEP të cilat nuk mbulohen nga pagesat për përdorimin e radio frekuencave dhe numrave sipas neneve 78 dhe 86 të këtij ligji.</p> <p>2. Pagesa vjetore, e përcaktuar në pikën 1 të</p>	<p>Neni 12 i Direktivës së Autorizimit kërkon që pagesat (detyrimet) administrative të mbështeten vetëm në kostot administrative. Fjalja e re e propozuar e përcakton këtë me qartë.</p> <p>Shih edhe amendimet e propozuara për nenet. 78, 86, 117 dhe 119.</p> <p>Ligji mund të përfshijë një përjashtim për operatorët e vegjël (për shembull me të ardhura nën 10m Lek), pasi barra administrative për përllogaritjen e të ardhurave të tyre dhe faturimit është shpërpjestimore ndaj pagesës së tyre sipas nenit 24 të ligjit.</p>

Amendimet e propozuara në ligjin 9918 për komunikimet elektronike

Neni	Arsyeja	Teksti aktual	Teksti i propozuar	Shpjegim
		<p>për mbikëqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike pranë AKEP-it brenda datës 30 prill të çdo viti, menjëherë pas dorëzimit të bilancit vjetor dhe të raportit të ekspertit kontabël, i cili depozitohet nga sipërmarrësi pranë AKEP-it.</p> <p>4. Niveli i pagesës vjetore për mbikëqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike, brenda kufirit prej 0,5 për qind të së ardhurës vjetore, përcaktohet në rregulloren e AKEP-it, të nxjerrë në përputhje me këtë ligj.</p> <p>5. Përcaktimi i nivelit të pagesës vjetore për mbikëqyrjen e tregut nuk duhet të deformojë konkurrencën apo të krijojë pengesa për hyrjen në treg të sipërmarrësve të rinj.</p> <p>6. Para miratimit të rregullores, sipas përcaktimeve në pikën 4 të këtij neni, AKEP-i duhet të njoftojë me shkrim sipërmarrësit, për të paraqitur mendimet dhe propozimet e tyre, me shkrim, për pagesën vjetore, mënyrën e përlllogaritjes dhe të zbatimit të saj. Afati i dërgimit të propozimeve nga sipërmarrësit është 30 ditë nga data e marrjes së njoftimit. Mosdërgimi i mendimeve dhe propozimeve brenda këtij afati, nuk përbën pengesë për AKEP-in që të veprojë sipas pikës 4 të këtij neni.</p> <p>7. Pagesa vjetore për mbikëqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike duhet të bëhet në llogaritë e AKEP-it.</p>	<p>këtij neni, nuk duhet të jetë më shumë se 0,5 për qind e së ardhurave vjetore të vitit kalendarik të mëparshëm për ofrimin e shërbimeve dhe rrjeteve të komunikimeve elektronike duke mos përfshirë të ardhurat nga transmetimet.</p> <p>3. Sipërmarrësi duhet të bëjë pagesën vjetore për mbikëqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike pranë AKEP-it brenda datës 30 prill të çdo viti, menjëherë pas dorëzimit të bilancit vjetor dhe të raportit të ekspertit kontabël, i cili depozitohet nga sipërmarrësi pranë AKEP-it.</p> <p>4. Niveli i pagesës vjetore për mbikëqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike, brenda kufirit prej 0,5 për qind të së ardhurës vjetore, përcaktohet në rregulloren e AKEP-it, të nxjerrë në përputhje me këtë ligj.</p> <p>5. Përcaktimi i nivelit të pagesës vjetore për mbikëqyrjen e tregut nuk duhet të deformojë konkurrencën apo të krijojë pengesa për hyrjen në treg të sipërmarrësve të rinj.</p> <p>6. Para miratimit të rregullores, sipas përcaktimeve në pikën 4 të këtij neni, AKEP-i duhet të njoftojë me shkrim sipërmarrësit, për të paraqitur mendimet dhe propozimet e tyre, me shkrim, për pagesën vjetore, mënyrën e përlllogaritjes dhe të zbatimit të saj. Afati i dërgimit të propozimeve nga sipërmarrësit është 30 ditë nga data e marrjes së njoftimit. Mosdërgimi i mendimeve dhe propozimeve brenda këtij afati, nuk përbën pengesë për AKEP-in që të veprojë sipas pikës 4 të këtij neni.</p> <p>7. Pagesa vjetore për mbikëqyrjen e tregut të</p>	

Amendimet e propozuara në ligjin 9918 për komunikimet elektronike

Neni	Arsyeja	Teksti aktual	Teksti i propozuar	Shpjegim
			komunikimeve elektronike duhet të bëhet në llogaritë e AKEP-it.	
25	BE 2009	<p>Neni 25</p> <p>Shërbimi universal</p> <p>1. Shërbimi universal përfshin:</p> <p>a) lidhjen, me kërkesën e tij, të përdoruesit fundor në rrjetin publik telefonik, duke siguruar akses në shërbimet telefonike, të disponueshme për publikun nga një vendndodhje gjeografike e përcaktuar, duke i krijuar mundësi përdoruesit të bëjë dhe të marrë thirrje lokale, kombëtare e ndërkombëtare, komunikimin me faks dhe komunikimin e të dhënave, me një shpejtësi jo më të vogël se 32 kbit/s;</p> <p>b) publikimin e numërorit telefonik në formë të printuar (pa përjashtuar edhe atë në formë elektronike), që përmbush kërkesat e përgjithshme të përcaktuara në pikën 2 të këtij neni;</p> <p>c) sigurimin e telefonave publikë me pagesë, duke plotësuar nevojat e arsyeshme të përdoruesve fundorë në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Telefonat publikë me pagesë duhet të mundësojnë lidhjen me shërbimet e emergjencës pa pagesë dhe pa qenë nevoja e përdorimit të mjetit të pagesës, të parashikuar për to;</p> <p>ç) sigurimin e kushteve për akses të barasvlefshëm dhe përdorimin e shërbimeve telefonike të disponueshme për përdoruesit fundorë, me aftësi të kufizuara, duke përfshirë akses në shërbimet e thirrjeve të emergjencës</p>	<p>Neni 25</p> <p>Shërbimi universal</p> <p>1. Shërbimi universal përfshin:</p> <p>a) lidhjen, me kërkesën e tij, të përdoruesit fundor në rrjetin publik telefonik, duke siguruar akses në shërbimet telefonike, të disponueshme për publikun nga një vendndodhje gjeografike e përcaktuar, duke i krijuar mundësi përdoruesit të bëjë dhe të marrë thirrje lokale, kombëtare e ndërkombëtare, komunikimin me faks akses funksional në Internet, të merren parasysht teknologjitë ekzistuese të përdorura nga shumica e pajtimtarëve dhe fizibiliteti teknologjik;</p> <p>b) disponueshmëria e Numeratorit Telefonik të Përgjithshëm, i cili përfshin pajtimtarët e të gjitha shërbimeve telefonike të disponueshme për publikun dhe i përmbush të gjitha kërkesat e vendosura në pikën 2 të këtij neni;</p> <p>c) sigurimin e telefonave publikë me pagesë, duke plotësuar nevojat e arsyeshme të përdoruesve fundorë në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Telefonat publikë me pagesë duhet të mundësojnë lidhjen me shërbimet e emergjencës pa pagesë dhe pa qenë nevoja e përdorimit të mjetit të pagesës, të parashikuar për to;</p> <p>ç) sigurimin e kushteve për akses të barasvlefshëm dhe përdorimin e shërbimeve</p>	<p>Në vend të përkufizimit të aksesit funksional të Internetit si “një shpejtësi jo më të vogël se 32 kbit/s” (neni 25 pika 1 e ligjit 9918) do të ishte me mirë të përdoret fraza e re “akses funksional të internetit, duke marrë parasysht teknologjitë mbizotëruese të përdorura nga shumica e abonentëve dhe mundësia teknologjike” nga neni i amenduar 4 i Direktivës së Shërbimit Universal.</p> <p>Dispozitat e nenit 5 të Direktivës së Shërbimit Universal për të paktën një shërbim të informimit për numërorin telefonik nuk janë transpozuar.</p> <p>Formulimi i ri i pikës 1b) dhe pika 2 deri në 5 do të garantojë që një numëror telefonik dhe të paktën një shërbim i informacionit telefonik të jetë i disponueshëm. Fusha e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve nga AKEP zgjerohet.</p>

Amendimet e propozuara në ligjin 9918 për komunikimet elektronike

Neni	Arsyeja	Teksti aktual	Teksti i propozuar	Shpjegim
		<p>dhe për informimin në numërorin telefonik për të gjithë përdoruesit në Republikën e Shqipërisë.</p> <p>2. Ofruesi i shërbimit universal, i caktuar nga AKEP-i për botimin e numërorit telefonik të përgjithshëm, duhet të reflektojë, të paktën një herë në vit, ndryshimet e ndodhura. Numërori telefonik i përgjithshëm duhet të përmbajë të paktën: emrin e plotë të pajtimtarëve, adresën, numrin e telefonit përkatës, me përjashtim të pajtimtarëve, të cilët kanë kërkuar, në mënyrë të veçantë, që këto të dhëna të mos bëhen publike.</p> <p>3. Ofruesit e shërbimeve publike telefonike duhet t'u ofrojnë ofruesve të shërbimit universal informacionin e nevojshëm për pajtimtarët e tyre, për t'u përfshirë, pa përjashtim, në numërorin telefonik të përgjithshëm dhe në shërbimin e informacionit të ofruar nga ofruesi i shërbimit universal.</p> <p>4. Kur ofruesi i shërbimit nuk i dorëzon ofruesit të shërbimit universal të dhëna për pajtimtarët, AKEP-i detyron ofruesin e shërbimit telefonik t'i dorëzojë këto të dhëna brenda një periudhe të caktuar kohore. Ofruesi i shërbimit universal duhet t'i përfshijë të dhënat në numërorin telefonik të përgjithshëm dhe në shërbimet e informacionit pa diskriminim ndërmjet ofruesve të shërbimit telefonik.</p>	<p>telefonike të disponueshme për përdoruesit fundorë, me aftësi të kufizuara, duke përfshirë akses në shërbimet e thirrjeve të emergjencës dhe për informimin në numërorin telefonik për të gjithë përdoruesit në Republikën e Shqipërisë.</p> <p>2. Ofruesi i shërbimit universal i caktuar nga AKEP për të administruar Numeratorin Telefonik të Përgjithshëm do të sigurojë publikimin e Numeratorit të paktën një herë në vit në formë të prinutar dhe të jetë i disponueshëm në formë elektronike si dhe nëpërmjet shërbimit të informacionit për numrat. Ofruesi i shërbimit universal do të vërë në dispozicion të botuesve të tjerë të Numeratorëve ose ofruesve të shërbimit të informacionit për numrat, sipas kërkesës, të dhënat e Numeratorit Telefonik të Përgjithshëm, në kushte mos-diskriminuese dhe me çmime të orientuara drejt kostos.</p> <p>3. Numeratori Telefonik i Përgjithshëm duhet të përmbajë të paktën: emrin e plotë të pajtimtarëve, adresën, numrin e telefonit përkatës, me përjashtim të pajtimtarëve, të cilët kanë kërkuar, në mënyrë të veçantë, që këto të dhëna të mos bëhen publike.</p> <p>4. Ofruesit e shërbimeve telefonike të vlefshme për publikun do të ofrojnë rregullisht informacion për pajtimtarët e ofruesit të shërbimit universal. Ofruesi i shërbimit universal duhet të përfshijë të dhënat e pajtimtarëve pa diskriminim për</p>	

Amendimet e propozuara në ligjin 9918 për komunikimet elektronike

Neni	Arsyeja	Teksti aktual	Teksti i propozuar	Shpjegim
			<p>ofruesit e shërbimit telefonik.</p> <p>5. AKEP do të vendosë për mosmarrëveshjet të cilat dalin nga zbatimi i pikave 2 deri 4 të këtij neni. Në veçanti, AKEP mund të detyrojë sipërmarrësit të paraqesin të dhëna të caktuara të pajtimtarëve brenda një kornize kohore të caktuar ose në intervale të caktuara kohore. AKEP gjithashtu mund të vendosë lidhur me ndërfaqet përkatëse dhe pagesat ndërmjet sipërmarrësve.</p>	
26	BE 2009	<p>Neni 26</p> <p>Sigurimi i shërbimit universal</p> <p>1. AKEP-i cakton një ose më shumë ofrues të shërbimit universal.</p> <p>2. deri 7. ...</p> <p>Nuk ka pikë numër 8</p>	<p>Neni 26</p> <p>Sigurimi i shërbimit universal</p> <p>1. AKEP-i mbi bazën e një vlerësimi të kryer në treg, mund të caktojë një ose më shumë ofrues të shërbimit universal.</p> <p>2. deri 7. (të pandryshuar)</p> <p>8. Kur një ofrues i shërbimit universal ka për qëllim të zhvendosë një pjesë të konsiderueshme ose të gjitha asetet e rrjetit të aksesit lokal në një person juridik në pronësi tjetër, do të informojë AKEP paraprakisht, në mënyrë që ti mundësojë AKEP të vlerësojë efektet e transaksionit në ofrimin e aksesit në vendndodhje të fiksuar dhe në shërbimet e telefonit sipas nenit 25 pika 1a e këtij ligji.</p> <p>AKEP mund të vendosë, amendojë ose tërheqë detyrime të veçanta në përputhje me nenin 18 të këtij ligji.</p>	<p>Amendimi i nenit 26 pika sqaron se vendimi për të caktuar një ose më shumë ofrues, ose që disa elementë të shërbimit universal janë mjaftueshmërisht të ofruar, do të mbështeten në një vlerësim tregu.</p> <p>Propozim: të shtohet një nen I ri 26 pika 8 e ligjit 9918 për të transpozuar nenin e ri 8 paragrafi 3 I Direktivës së Shërbimit Universal.</p> <p>AKEP mund të reagojë psh duke përzgjedhur një tjetër ofrues të shërbimit universal (neni 26 në përgjithësi) duke zbatuar dispozitat nga marrëveshja me ofruesin ekzistues (neni 26 pika 6).</p>

Amendimet e propozuara në ligjin 9918 për komunikimet elektronike

Neni	Arsyeja	Teksti aktual	Teksti i propozuar	Shpjegim
27	BE 2002 dhe BE 2009	6. Ofruesit e shërbimit universal janë të detyruar të sigurojnë për pajtimtarët e tyre mundësinë e përdorimit të shërbimeve të bllokimit të thirrjeve dalëse me zgjedhje, të faturimit me hollësi të shërbimeve, të sistemit të parapagimit për aksesin dhe të përdorimit të shërbimeve.	<p>6. AKEP do të detyrojë ofruesit e shërbimit universal ti ofrojnë pajtimtarëve të tyre mundësinë për të përdorur shërbimet si vijon:</p> <p>a) të bllokimit të thirrjeve dalëse me zgjedhje në shërbimet e mesazheve të shkurtëra me vlerë të shtuar ose kur është teknikisht e mundur, shërbimeve të tjera të ngjajshme, pa pagesë;</p> <p>b) të sistemeve të parapagimit për akses në rrjetet e komunikimit elektronik publik dhe përdorimit të shërbimeve telefonike të vlefshme për publikun;</p> <p>c) pagesat e shpërndara në kohë për lidhje lidhje në rrjete të komunikimit elektronik publik;</p> <p>ç) këshilla për tarifën, ku pajtimtarët mund të kërkojnë që sipërmarrësi ti informojnë për tarifën të tjera alternative me kosto më të ulët, nëse janë të disponueshme; dhe</p> <p>d) facilitate për kontrollin e kostos, duke përfshirë njoftimin pa pagesë të konsumatorëve në rast të mostrave të parregullta dhe të tepërta të komunikacioneve.</p> <p>7. AKEP mund të abstenojë në detyrimin e ofruesve të shërbimit universal për të ofruar disa ose të gjitha shërbimet sipas pikës 6 të këtij neni nëse këto shërbime janë gjërësisht të disponueshme.</p>	<p>Neni 27 i ligjit 9918 liston shumicën e pajisjeve të Pjesës A shtojca 1 të Direktivës së Shërbimit Universal por jo në shumë detaje dhe nuk përmend pagesat me faza të tarifave të lidhjes dhe jo të amendimeve të fundit (tarifa për këshillim, kontrolli i kostove). Gjithashtu nuk e transponon ashtu sic duhet idene që rregullatori duhet të jetë i aftë të vendosë pas një konsultimi publik se cilat pajisje janë të nevojshme. Ne sugjerojmë që të amendohet neni 27 i ligjit 9918 në të njëjtën mënyrë. Faturat e detajuara dhe dispozitat për mospagesën e faturave nuk përmenden këtu, pasi ato janë parashikuar për të gjitha kontratat në nenet 106 dhe 109.</p> <p>Shih gjithashtu nenin 27 pika 3 I cili lejon ofruesin e shërbimit universal që të ofrojë tarifa opsionale, paketa tarifore të vecanta etj në përputhje me legjislacionin në fuqi. Por fokusi i neni 27 pika 3 është që ofruesi mund të ofrojë tarifa të tilla kurse sipas pikave 6 dhe 7 është detyra e AKEP që të vendosë se cilat opsione mund të ofrojë ofruesi i shërbimit universal.</p>
30	redaksional	Neni 30 Financimi i shërbimit universal	Neni 30 Financimi i shërbimit universal	Fjalja e propozuar shtesë sqaron se AKEP do ta mbajë fondin e shërbimit universal (që

Amendimet e propozuara në ligjin 9918 për komunikimet elektronike

Neni	Arsyeja	Teksti aktual	Teksti i propozuar	Shpjegim
		<p>1. Për kompensimin e kostove të shërbimit universal krijohet fondi i këtij shërbimi. Fondi i shërbimit universal menaxhohet dhe administrohet nga AKEP-i. Ky fond është i paprekshëm për qëllime të tjera dhe, nëse nuk shpenzohet, akumulohet dhe mbartet në vitin pasardhës.</p> <p>2. ...</p>	<p>1. Për kompensimin e kostove të shërbimit universal krijohet fondi i këtij shërbimi. Fondi i shërbimit universal menaxhohet dhe administrohet nga AKEP-i. Ky fond është i paprekshëm për qëllime të tjera dhe, nëse nuk shpenzohet, akumulohet dhe mbartet në vitin pasardhës. AKEP do të menaxhojë fondin e shërbimit universal veçmas nga buxheti i tij sipas nenit 117 të këtij ligji.</p> <p>2. ...</p>	<p>financohet nga pagesat e specifikuara në nenin 30) të ndarë nga buxheti I tij (që financohet në bazë të nenit 24 dhe 78).</p> <p>Shih dhe komentet për nenin 117 dhe për fshirjen e propozuar të nenit 119 më poshtë.</p>
34	BE 2002	Pika numër 5	5. Detyrimet e vendosura në përputhje me këtë nen do të bazohen në natyrën e problemit të identifikuar, do të jenë proporcionale dhe të justifikuara nga pikëpamja e objektivave të vendosura në nenin 7 të këtij ligji.	<p>Neni 8 I Direktivës së Aksesit është dispozita kryesore për vendosjen e detyrimeve rregullatore ndaj operatorëve me fuqi të ndjeshme në treg. Parimi që do të merren vetëm masa proporcionale është një prej dallimeve kryesore ndërmjet kuadrit rregullator të BE-së të vitit 1998 dhe 2003. Ky parim nuk shprehet qartësisht në ligjin 9918 dhe ne propozojmë të shtohet një nen I ri 34 pika 5 në mënyrë që kjo të jetë e qartë.</p> <p>Shih edhe nenin 17 të Direktivës së Shërbimit Universal.</p>
42	BE 2009	<p>Neni 42</p> <p>Detyrimi për akses dhe interkoneksion dhe përdorimi i përbashkët i faciliteteve të rrjetit</p> <p>1. AKEP-i vendos ndaj sipërmarrësve me fuqi të ndjeshme në treg detyrimin për të plotësuar kërkesat e arsyeshme për akses dhe interkoneksion, si dhe për përdorimin e elementeve të veçanta të rrjetit dhe faciliteteve shoqëruese, në veçanti, në ato raste kur AKEP-i vlerëson se nga refuzimi i aksesit ose nga</p>	<p>Neni 42</p> <p>Detyrimi për akses dhe interkoneksion dhe përdorimi i përbashkët i faciliteteve të rrjetit</p> <p>1. AKEP-i vendos ndaj sipërmarrësve me fuqi të ndjeshme në treg detyrimin për të plotësuar kërkesat e arsyeshme për akses dhe interkoneksion, si dhe për përdorimin e elementeve të veçanta të rrjetit dhe faciliteteve shoqëruese, në veçanti, në ato raste kur AKEP-i vlerëson se nga refuzimi i aksesit ose nga</p>	<p>Disa prej amendimeve të nenit 12 të Direktivës së Aksesit do të zgjerojë fushën e zbatimit të detyrimit për akses. Ne propozojmë të amendohet neni 42 i ligjit 9918 në këtë mënyrë.</p>

Amendimet e propozuara në ligjin 9918 për komunikimet elektronike

Neni	Arsyeja	Teksti aktual	Teksti i propozuar	Shpjegim
		<p>kushtet dhe termat e paarsyeshme, pengohet konkurrenca e qëndrueshme në tregun e pakicës, apo kur dëmtohen interesat e përdoruesve fundorë.</p> <p>2. Sipërmarrësit me fuqi të ndjeshme në treg i kërkohet njëra, disa, apo të gjitha prej masave të mëposhtme, në mënyrë të veçantë:</p> <p>a) t'u ofrojë palëve të treta akses dhe interkoneksion në rrjet dhe elementet e tij;</p> <p>b) të ofrojë shërbime të veçanta në nivel shumice, për t'u rishitur nga palët e treta;</p> <p>c) të mos anulojë aksesin në facilitetet, kur e ka dhënë atë;</p> <p>ç) të negociojë me dëshirën e mirë dhe me mirëbesim me subjektet, që kërkojnë akses;</p> <p>d) të ofrojë akses të hapur në ndërfaqet teknike, protokollat ose teknologjitë e tjera të rëndësishme, të domosdoshme për ndërveprimin e shërbimeve ose për shërbimet e rrjetit virtual;</p> <p>dh) të ofrojë bashkëvendosje ose forma të tjera të përdorimit të përbashkët, përfshirë ndërtesat, tubacionet kabllore ose shtyllat, kullat;</p> <p>e) të krijojë kushtet e nevojshme për të siguruar ndërveprimin e shërbimeve pikë fundore - pikë fundore, duke përfshirë facilitetet për shërbimet e rrjetit inteligjent dhe/ose roaming-ut në rrjetet mobile;</p> <p>ë) të ofrojë akses në sistemet mbështetëse funksionale ose sistemet e ngjashme informatike (softëare), të nevojshme, për të siguruar konkurrencë të ndershme në ofrimin e</p>	<p>kushtet dhe termat e paarsyeshme, pengohet konkurrenca e qëndrueshme në tregun e pakicës, apo kur dëmtohen interesat e përdoruesve fundorë.</p> <p>2. Sipërmarrësit me fuqi të ndjeshme në treg i kërkohet njëra, disa, apo të gjitha prej masave të mëposhtme, në mënyrë të veçantë:</p> <p>a) t'u ofrojë palëve të treta akses në elemente të veçanta të rrjetit dhe/ose faciliteteve, duke përfshirë akses në elemente të rrjetit cilat nuk janë aktive dhe/ose akses të hapur në qarkun lokal, ose ndërmjet të tjerash të mundësojë zgjedhjen/parazgjedhjen së bartësit ose oferta e rishitjes së linjës së pajtimtarit;</p> <p>b) të ofrojë shërbime të veçanta në nivel shumice, për t'u rishitur nga palët e treta;</p> <p>c) të mos anulojë aksesin në facilitetet, kur e ka dhënë atë;</p> <p>ç) të negociojë me dëshirën e mirë dhe me mirëbesim me subjektet, që kërkojnë akses;</p> <p>d) të ofrojë akses të hapur në ndërfaqet teknike, protokollat ose teknologjitë e tjera të rëndësishme, të domosdoshme për ndërveprimin e shërbimeve ose për shërbimet e rrjetit virtual;</p> <p>dh) të ofrojë bashkëvendosje ose forma të tjera të përdorimit të përbashkët, përfshirë ndërtesat, tubacionet kabllore ose shtyllat, kullat;</p> <p>e) të krijojë kushtet e nevojshme për të siguruar ndërveprimin e shërbimeve pikë fundore - pikë fundore, duke përfshirë facilitetet për shërbimet e rrjetit inteligjent dhe/ose roaming-ut në</p>	

Amendimet e propozuara në ligjin 9918 për komunikimet elektronike

Neni	Arsyeja	Teksti aktual	Teksti i propozuar	Shpjegim
		<p>shërbimeve;</p> <p>f) të interkonektojë rrjetet ose facilitetet e rrjetit.</p> <p>g) të japë akses në përdorimin e qarkut lokal.</p> <p>3. Në vendosjen e detyrimeve, sipas pikës 2 të këtij neni dhe për të vlerësuar nëse detyrimi për akses dhe interkoneksion është i justifikuar dhe proporcional, për rregullimet e parashtruara në këtë ligj, AKEP-i duhet të ketë parasysh, veçanërisht, faktorët e mëposhtëm:</p> <p>a) aftësitë teknike dhe ekonomike për përdorimin ose instalimin e faciliteteve konkurruese, në pikëpamje të shkallës së zhvillimit të tregut, duke pasur parasysh natyrën dhe tipin e interkoneksionit e të aksesit, që është në diskutim;</p> <p>b) mundësinë e ofrimit të aksesit të propozuar, në relacion me kapacitetet e disponueshme;</p> <p>c) investimin fillestar nga pronari i faciliteteve, duke mbajtur parasysh riskun e përfshirë në kryerjen e investimit;</p> <p>ç) nevojën për të garantuar konkurrencën në terma afatgjatë në rrjetet dhe shërbimet e komunikimeve elektronike publike dhe, veçanërisht, duke krijuar stimuj për investime efçente në facilitete, të cilat, në terma afatgjatë, sigurojnë më shumë konkurrencë;</p> <p>d) të gjitha të drejtat e pronësisë intelektuale.</p> <p>4. Kur një sipërmarrës dëshmon se përdorimi i facilitetit mund të rrezikojë mirëmbajtjen e tërësisë së rrjetit ose funksionet e rrjetit, AKEP-i nuk vendos detyrim për këtë facilitet ose vendos detyrimin në një formë tjetër.</p>	<p>rrjetet mobile;</p> <p>ë) të ofrojë akses në sistemet mbështetëse funksionale ose sistemet e ngjashme informatike (softëare), të nevojshme, për të siguruar konkurrencë të ndershme në ofrimin e shërbimeve;</p> <p>f) të interkonektojë rrjetet ose facilitetet e rrjetit;</p> <p>g) të japë akses në përdorimin e qarkut lokal;</p> <p>h) të ofrojë akses në shërbime shoqëruese si në shërbimet për identitetin, vendndodhjen dhe prezencën.</p> <p>3. Në vendosjen e detyrimeve, sipas pikës 2 të këtij neni dhe për të vlerësuar nëse detyrimi për akses dhe interkoneksion është i justifikuar dhe proporcional, për rregullimet e parashtruara në këtë ligj, AKEP-i duhet të ketë parasysh, veçanërisht, faktorët e mëposhtëm:</p> <p>a) realizueshmërinë teknike dhe ekonomike të përdorimit ose instalimit të faciliteteve konkurruese, në këndvështrim të shkallës së zhvillimit të tregut, duke marrë parasysh natyrën dhe llojin e interkoneksionit dhe/ose aksesit dhe duke përfshirë realizueshmërinë e produkteve të tjera upstream të aksesit siç është aksesit në tubacione;</p> <p>b) mundësinë e ofrimit të aksesit të propozuar, në relacion me kapacitetet e disponueshme;</p> <p>c) investimin fillestar nga pronari i faciliteteve, duke mbajtur parasysh riskun e përfshirë në kryerjen e investimit;</p> <p>ç) nevojën për të garantuar konkurrencën në</p>	

Amendimet e propozuara në ligjin 9918 për komunikimet elektronike

Neni	Arsyeja	Teksti aktual	Teksti i propozuar	Shpjegim
		Mirëmbajtja e tërësisë së rrjetit dhe siguria e funksioneve të rrjetit duhet të justifikohen nga sipërmarrësi, bazuar në standardet objektive.	terma afatgjatë në rrjetet dhe shërbimet e komunikimeve elektronike publike dhe, veçanërisht, duke krijuar stimuj për investime efçente në facilitete, të cilat, në terma afatgjatë, sigurojnë më shumë konkurrencë; d) të gjitha të drejtat e pronësisë intelektuale. 4. Kur një sipërmarrës dëshmon se përdorimi i facilitetit mund të rrezikojë mirëmbajtjen e tërësisë së rrjetit ose funksionet e rrjetit, AKEP-i nuk vendos detyrim për këtë facilitet ose vendos detyrimin në një formë tjetër. Mirëmbajtja e tërësisë së rrjetit dhe siguria e funksioneve të rrjetit duhet të justifikohen nga sipërmarrësi, bazuar në standardet objektive.	
47	të tjera	Neni 47 Detyrimi për interkoneksion dhe marrëveshjet e interkoneksionit 1. Çdo sipërmarrës i rrjeteve të komunikimeve elektronike publike, kundrejt pagesës, duhet që, brenda 30 ditëve nga data e marrjes së saj, t'u japë një ofertë interkoneksioni sipërmarrësve të tjerë të rrjeteve të komunikimeve elektronike publike, që të sigurojë komunikimin e përdoruesve, ofrimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike dhe bashkëveprimin e shërbimeve në të gjithë komunitetin. Të gjithë sipërmarrësit do të përpiqen të realizojnë objektivin, për të mundësuar dhe përmirësuar komunikimin ndërmjet përdoruesve të rrjeteve të komunikimeve elektronike publike.	Neni 47 Detyrimi për interkoneksion dhe marrëveshjet e interkoneksionit 1. Çdo sipërmarrës i rrjeteve të komunikimeve elektronike publike, kundrejt pagesës, duhet që, brenda 30 ditëve nga data e marrjes së saj, t'u japë një ofertë interkoneksioni sipërmarrësve të tjerë të rrjeteve të komunikimeve elektronike publike, që të sigurojë komunikimin e përdoruesve, ofrimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike dhe bashkëveprimin e shërbimeve në të gjithë komunitetin. Të gjithë sipërmarrësit do të përpiqen të realizojnë objektivin, për të mundësuar dhe përmirësuar komunikimin ndërmjet përdoruesve të rrjeteve të komunikimeve elektronike publike.	Fjalët “kundrejt pagesës”do të fshihen. Operatorët nuk duhet ta paguajnë njëri-tjetrin për të negociuar interkoneksionin.
49	BE 2009	Neni 49	Neni 49	Neni 5 i Direktivës së Aksesit është më I

Amendimet e propozuara në ligjin 9918 për komunikimet elektronike

Neni	Arsyeja	Teksti aktual	Teksti i propozuar	Shpjegim
		<p>Roli i AKEP-it për sigurimin e aksesit dhe interkoneksionit</p> <p>1. AKEP-i, në përputhje me objektivat rregullatorë të përcaktuar në nenin 7 të këtij ligji, nxit dhe, nëse është e nevojshme, detyron realizimin e aksesit dhe të interkoneksionit, si edhe bashkëveprimin e shërbimeve, duke synuar nxitjen e konkurrencës së qëndrueshme dhe efçente, për përfitimin maksimal të përdoruesve fundorë.</p> <p>2. AKEP-i:</p> <p>a) vendos detyrime për aksesin dhe interkoneksionin ndaj sipërmarrësve, që ofrojnë rrjete dhe shërbime të komunikimeve elektronike publike;</p> <p>b) ndërhy, me nismën e saj, kur është e justifikuar ose, në mungesë të një marrëveshjeje ndërmjet palëve, me kërkesë të cilësdo palë, sipas parashikimeve të këtij ligji.</p>	<p>Roli i AKEP-it për sigurimin e aksesit dhe interkoneksionit</p> <p>1. AKEP-i, në përputhje me objektivat rregullatorë të përcaktuar në nenin 7 të këtij ligji, nxit dhe, nëse është e nevojshme, detyron realizimin e aksesit dhe të interkoneksionit, si edhe bashkëveprimin e shërbimeve, duke synuar nxitjen e konkurrencës së qëndrueshme dhe efçente, për përfitimin maksimal të përdoruesve fundorë.</p> <p>2. Pa paragjykim ndaj masave të cilat mund të merren ndaj sipërmarrësve me fuqi të ndjeshme në treg në përputhje me nenin 34, AKEP do të vendosë:</p> <p>a) Masën e nevojshme për të siguruar lidhjen pikë fundore – pikë fundore, detyrimet ndaj sipërmarrësve të cilët kontrollojnë aksesin tek përdoruesit fundorë, duke përfshirë në rastet e justifikuara detyrimin për të interkonektuar rrjetet e tyre në mungesë të këtij interkoneksioni;</p> <p>b) Në rastet e justifikuara dhe në masën e nevojshme, detyrimi ndaj sipërmarrësve të cilët kontrollojnë aksesin tek përdoruesit fundorë për të bërë këto shërbime të ndërveprueshme.</p> <p>3. Detyrimet dhe kushtet e vendosura në përputhje me pikat 1 dhe 2 do të jenë objektive, transparente, proporcionale dhe mos diskriminuese si dhe të vendosura pas konsultimit publik në përputhje me nenin</p>	<p>detajuar se neni 49 I ligjit 9918 dhe amendimet e nenit 5 do të shtojnë dispozita më të detajuara. Ne do të sugjeronim të rihartohej neni 49 për të qenë në përputhje me formulimin e ri. Në vecanti lidhja ndërmjet kompetencave të AKEP dhe objektivave të ligjit duhet të shprehet dhe të qartësohet që AKEP duhet të ndërhyjë vetëm nëse është e nevojshme dhe në përpjestim me objektivat e ligjit.</p>

Amendimet e propozuara në ligjin 9918 për komunikimet elektronike

Neni	Arsyeja	Teksti aktual	Teksti i propozuar	Shpjegim
			<p>110.</p> <p>4. AKEP mund të ndërhyjë me iniciativën e tij, nëse është e justifikuar, në përputhje me objektivat e nenit 7 ose me kërkesë të cilësdo palë, në përputhje me nenet 50 dhe 60.</p>	
52	BE 2009	<p>...</p> <p>7. Kur një sipërmarrës ka detyrimin për të ofruar akses të hapur në qarkun lokal, në ofertën referencë që duhet të publikojë, sipas përcaktimeve të këtij neni, është i detyruar të përfshijë, të paktën, elementet e mëposhtme:</p> <p>I. Kushtet për aksesin e hapur në rrjetin lokal:</p> <p>a) elementet e rrjetit, për të cilat ofrohet akses i që mbulon, në veçanti elementet e mëposhtme:</p> <p>i. aksesin në linjat e rrjetit lokal (<i>local loop</i>);</p> <p>ii. aksesin në brezin e frekuencave jozanore të rrjetit lokal (<i>local loop</i>), në rastin e aksesit të përbashkët.</p> <p>b) informacionin për vendndodhjen e pikave të aksesit fizik dhe disponibilitetin e linjave në pjesët përkatëse të rrjetit të aksesit;</p> <p>c) kushtet teknike të lidhura me aksesin dhe përdorimin e linjave të rrjetit lokal, përfshirë karakteristikat teknike të linjave metalike dypërcjellëse;</p> <p>ç) procedurat për porositjen, dhënien, kufizimet e përdorimit.</p> <p>II. Shërbimet e bashkëvendosjes:</p> <p>a) informacion për vendet përkatëse të sipërmarrësit, që ofron shërbimet e aksesit të</p>	<p>...</p> <p>7. Kur një sipërmarrës ka detyrimin për të ofruar akses të hapur në qarkun lokal, në ofertën referencë që duhet të publikojë, sipas përcaktimeve të këtij neni, është i detyruar të përfshijë, të paktën, elementet e mëposhtme:</p> <p>I. Kushtet për aksesin e hapur në rrjetin lokal:</p> <p>a) elementet e rrjetit, për të cilat ofrohet akses i që mbulon, në veçanti elementet e mëposhtme së bashku me facilitetet e nevojshme shoqëruese:</p> <p>i. aksesin e hapur në linjat e rrjetit lokal (<i>local loop</i>);</p> <p>ii. aksesin e hapur në rrjetin lokal (i plotë dhe i përbashkët), duke përfshirë, kur kjo është e rëndësishme, aksesin në elemente të rrjetit të cilat nuk janë aktive për qëllime të shtrirjes së rrjeteve backhaul (mbështetëse);</p> <p>iii. nëse është e rëndësishme, akses nëpërmjet tubacioneve për të mundësuar shtrirjen e aksesit në rrjete shtrirjen e rrjeteve të aksesit.</p> <p>b) Informacioni për vendndodhjet e aksesit fizik duke përfshirë kabinetet dhe përmutatorët, disponueshmërinë qarqeve</p>	<p>Amendimet në Shtojcën II të Direktivës së Aksesit do të zgjerojnë fushën e zbatimit të ofertave për referencat e aksesit të hapur. PSH, detyrimet për akses përfshijnë akses edhe në elementet që nuk janë aktive (kanalizimet, fibrat e errëta). Ne propozojmë që të amendohet neni 52 I ligjit 9918 në këtë mënyrë.</p>

Amendimet e propozuara në ligjin 9918 për komunikimet elektronike

Neni	Arsyeja	Teksti aktual	Teksti i propozuar	Shpjegim
		<p>hapur në rrjetin lokal;</p> <p>b) opsionet e bashkëvendosjes në vendet e përcaktuara, sipas pikës 1 të këtij neni (përfshirë bashkëvendosjen fizike dhe, sipas përshtatshmërisë, edhe bashkëvendosjen në distancë dhe bashkëvendosjen virtuale);</p> <p>c) karakteristikat e pajisjeve: kufizimet (nëse ekzistojnë) për pajisjet, që mund të bashkëvendosen;</p> <p>ç) çështjet e sigurisë: masat e përcaktuara nga sipërmarrësi ofrues i shërbimeve të aksesit të hapur në rrjetin lokal, për të garantuar sigurinë e këtyre vendeve;</p> <p>d) kushtet e hyrjes për punonjësit e sipërmarrësve përfitues të mundshëm;</p> <p>dh) standardet për sigurinë;</p> <p>e) rregullat për alokimin e vendit, kur hapësirat e bashkëvendosjes janë të kufizuara;</p> <p>ë) kushtet, sipas të cilave përfituesit e aksesit të shpërndarë mund të inspektojnë vendet, në të cilat bashkëvendosja është e mundur, apo vendet ku bashkëvendosja është refuzuar, me argumentin e mungesës së hapësirës.</p> <p>III. Sistemet e informacionit:</p> <p>Kushtet për akses në sistemet mbështetëse operacionale të sipërmarrësit ofrues të aksesit të shpërndarë të sistemeve të informacionit apo bazave të të dhënave për porositjen paraprake, dhënien, porositjen, mirëmbajtjen dhe kërkesat për riparime dhe faturimet.</p> <p>IV. Kushtet e ofrimit:</p> <p>a) koha që mund të kalojë deri në përgjigjen</p>	<p>lokale, nën lokale dhe rrjeteve mbështetëse në pjesë të veçanta të aksesit në rrjet dhe kur është e nevojshme, informacion lidhur me vendndodhjet e tubacioneve dhe disponueshmërinë brenda tubacioneve;</p> <p>c) kushtet teknike lidhur me aksesin dhe përdorimin e qarqeve lokale dhe nën-lokale, duke përfshirë karakteristikat teknike të linjave dypërcjellëse dhe/ose fibrave optike dhe/ose të ngjajshme, shpërndarësve të kabllove dhe faciliteteve shoqëruese dhe kur është e nevojshme, kushtet teknike lidhur me aksesin në tubacione;</p> <p>ç) procedurat për porositjen, dhënien, kufizimet e përdorimit;</p> <p>II) Shërbimet e bashkëvendosjes:</p> <p>a) informacion për vendet përkatëse ekzistuese të sipërmarrësit me fuqi të ndjeshme në treg ose vendndodhjen e pajisjeve dhe planet për përditësimin e tyre; disponueshmëria e këtij informacioni mund të jetë e kufizuar vetëm për palët e interesuara;</p> <p>b) opsionet e bashkëvendosjes në vendet e përcaktuara, sipas pikës 1 të këtij neni (përfshirë bashkëvendosjen fizike dhe, sipas përshtatshmërisë, edhe bashkëvendosjen në distancë dhe bashkëvendosjen virtuale);</p> <p>c) karakteristikat e pajisjeve: kufizimet (nëse ekzistojnë) për pajisjet, që mund të bashkëvendosen;</p> <p>ç) çështjet e sigurisë: masat e përcaktuara nga sipërmarrësi ofrues i shërbimeve të aksesit të</p>	

Amendimet e propozuara në ligjin 9918 për komunikimet elektronike

Neni	Arsyeja	Teksti aktual	Teksti i propozuar	Shpjegim
		<p>ndaj kërkesave për ofrimin e shërbimeve dhe faciliteteve; marrëveshjet për nivelin e shërbimit, eliminimin e dështimeve, procedurat për t'u kthyer shërbimin në një nivel normal dhe parametrat e cilësisë së shërbimit;</p> <p>b) kushtet standarde të kontratave, përfshirë, nëse është e përshtatshme, zhdëmtimin që paguhet kur nuk realizohet përgjigja brenda kohës;</p> <p>c) çmimet apo formulat e përcaktimit të çmimeve për secilin prej shërbimeve, funksioneve dhe faciliteteve të përmendura më sipër.</p>	<p>hapur në rrjetin lokal, për të garantuar sigurinë e këtyre vendeve;</p> <p>d) kushtet e hyrjes për punonjësit e sipërmarrësve përfitues të mundshëm;</p> <p>dh) standardet për sigurinë;</p> <p>e) rregullat për alokimin e vendit, kur hapësirat e bashkëvendosjes janë të kufizuara;</p> <p>ë) kushtet, sipas të cilave përfituesit e aksesit të shpërndarë mund të inspektojnë vendet, në të cilat bashkëvendosja është e mundur, apo vendet ku bashkëvendosja është refuzuar, me argumentin e mungesës së hapësirës.</p> <p>III. Sistemet e informacionit:</p> <p>Kushtet për akses në sistemet mbështetëse operationale të sipërmarrësit ofruar të aksesit të shpërndarë të sistemeve të informacionit apo bazave të të dhënave për porositjen paraprake, dhënie, porositjen, mirëmbajtjen dhe kërkesat për riparime dhe faturimet.</p> <p>IV. Kushtet e ofrimit:</p> <p>a) koha që mund të kalojë deri në përgjigjen ndaj kërkesave për ofrimin e shërbimeve dhe faciliteteve; marrëveshjet për nivelin e shërbimit, eliminimin e dështimeve, procedurat për t'u kthyer shërbimin në një nivel normal dhe parametrat e cilësisë së shërbimit;</p> <p>b) kushtet standarde të kontratave, përfshirë, nëse është e përshtatshme, zhdëmtimin që paguhet kur nuk realizohet përgjigja brenda kohës;</p> <p>c) çmimet apo formulat e përcaktimit të çmimeve për secilin prej shërbimeve,</p>	

Amendimet e propozuara në ligjin 9918 për komunikimet elektronike

Neni	Arsyeja	Teksti aktual	Teksti i propozuar	Shpjegim
			funsioneve dhe faciliteteve të përmendura më sipër.	
60	redaksionale	<p>Neni 60</p> <p>Urdhri i AKEP</p> <p>1. Në rastet kur një marrëveshje aksesi dhe interkoneksioni, sipas neneve 46 dhe 47 të këtij ligji, nuk është arritur tërësisht ose pjesërisht dhe kur janë plotësuar kushtet e përcaktuara në këtë ligj për vendosjen e një detyrimi për të dhënë akses, AKEP-i, pasi shqyrton pretendimet e palëve, sipas nenit 50 të këtij ligji urdhëron lidhjen e marrëveshjes për akses dhe interkoneksionin. Në urdhrin e këshillit drejtues të AKEP-it përcaktohet edhe afati për zbatimin e tij, i cili nuk mund të jetë më shumë se 30 ditë nga data e hyrjes në fuqi të urdhrin.</p> <p>2. Urdhri i këshillit drejtues të AKEP-it për lidhjen e marrëveshjes për akses dhe interkoneksion është i lejuar vetëm nëse dhe për sa kohë që palët përkatëse dështojnë në arritjen e një marrëveshjeje aksesi ose interkoneksioni.</p> <p>3. Parashtrimi i pretendimeve të palëve, sipas pikës 1 të këtij neni, përpara AKEP-it duhet të bëhet me shkrim. Ato duhet të jenë të provuara. Në veçanti ato duhet të përfshijnë:</p> <p>a) kohën kur është kërkuar aksesi dhe/ose interkoneksioni dhe, konkretisht, për cilat shërbime dhe/ose facilitete;</p> <p>b) argumentet e plota për të dëshmuar se janë zhvilluar negociata serioze, ose se pala tjetër ka kundërshtuar të hyjë në negociata;</p>	<p>Neni 60</p> <p>Vendimi i AKEP për aksesin dhe interkoneksionin</p> <p>1. Në rastet kur një marrëveshje aksesi dhe interkoneksioni, sipas neneve 46 dhe 47 të këtij ligji, nuk është arritur tërësisht ose pjesërisht dhe kur janë plotësuar kushtet e përcaktuara në këtë ligj për vendosjen e një detyrimi për të dhënë akses, AKEP-i, pasi shqyrton pretendimet e palëve, sipas nenit 50 të këtij ligji urdhëron lidhjen e marrëveshjes për akses dhe interkoneksionin. Në vendimin e këshillit drejtues të AKEP-it përcaktohet edhe afati për zbatimin e tij, i cili nuk mund të jetë më shumë se 30 ditë nga data e hyrjes në fuqi të vendimit.</p> <p>2. Vendimi i këshillit drejtues të AKEP-it për lidhjen e marrëveshjes për akses dhe interkoneksion është i lejuar vetëm nëse dhe për sa kohë që palët përkatëse dështojnë në arritjen e një marrëveshjeje aksesi ose interkoneksioni.</p> <p>3. Parashtrimi i pretendimeve të palëve, sipas pikës 1 të këtij neni, përpara AKEP-it duhet të bëhet me shkrim. Ato duhet të jenë të provuara. Në veçanti ato duhet të përfshijnë:</p> <p>a) kohën kur është kërkuar aksesi dhe/ose interkoneksioni dhe, konkretisht, për cilat shërbime dhe/ose facilitete;</p> <p>b) argumentet e plota për të dëshmuar se janë zhvilluar negociata serioze, ose se pala tjetër ka</p>	<p>Termi “urdhër” nuk është i saktë pasi në sistemin ligjor shqiptar një “urdhër” është një akt që nuk lëshohet nga një organ kolegjal. Duhet të jetë “vendim” si kudo tjetër në ligj. Meqë vendimet për aksesin dhe interkoneksionin janë vendime të rëndësishme rregullatore, ato duhet të miratohen nga Këshilli Drejtues.</p> <p>Ndryshimi ka vetëm karakter editorial për të korrigjuar terminologjinë ligjore. Nuk e ndryshon kuptimin dhe përmbajtjen e mundshme të vendimit.</p>

Amendimet e propozuara në ligjin 9918 për komunikimet elektronike

Neni	Arsyeja	Teksti aktual	Teksti i propozuar	Shpjegim
		<p>c) pikat, për të cilat nuk është arritur marrëveshje;</p> <p>ç) shënime sqaruese për mundësinë e realizimit teknik të çdo mase të veçantë teknike, që kërkohet.</p> <p>4. Pretendimet mund të tërhiqen për sa kohë që urdhri nuk është nxjerrë nga AKEP-i.</p> <p>5. Pavarësisht sa parashikohet në pikën 2 të këtij neni, për të arritur synimet e vendosura në nenin 7 të këtij ligji, AKEP-i mundet, gjithashtu, që ta trajtojë rastin me nismën e vet.</p> <p>6. Objekt i një urdhri të tillë mund jetë secili prej termave dhe kushteve të një marrëveshjeje aksesi dhe/ose interkoneksioni, përfshirë edhe tarifën. AKEP-i mund t'i bashkëlidhë këtij urdhri kushte për ndershmërinë, transparencën, mosdiskriminimin, arsyeshmërinë dhe grafikun kohor. Në lidhje me përcaktimin e tarifave, zbatohen nenet 53, 55, 56, 57, 58 dhe 59 të këtij ligji.</p> <p>7. Kur pjesë e pretendimeve të parashtruara dhe e shqyrtimit përkatës janë termat dhe kushtet e një marrëveshjeje aksesi dhe interkoneksioni, si edhe tarifën e pagueshme për shërbimet dhe/ose facilitetet e kërkuara, AKEP-i mund të marrë vendime për termat, kushtet dhe tarifën. Afati i zbatimit të këtyre vendimeve është një muaj nga data e hyrjes në fuqi të tyre.</p> <p>8. Sipërmarrësit duhet të zbatojnë urdhrin e këshillit drejtues të AKEP-it brenda afateve të përcaktuara në të. Në rast të moszbatimit të urdhrin, AKEP-i vendos gjobë, sipas parashikimeve të nenit 137 të këtij ligji.</p>	<p>kundërshtuar të hyjë në negociatë;</p> <p>c) pikat, për të cilat nuk është arritur marrëveshje;</p> <p>ç) shënime sqaruese për mundësinë e realizimit teknik të çdo mase të veçantë teknike, që kërkohet.</p> <p>4. Pretendimet mund të tërhiqen për sa kohë që vendimi nuk është nxjerrë nga AKEP-i.</p> <p>5. Pavarësisht sa parashikohet në pikën 2 të këtij neni, për të arritur synimet e vendosura në nenin 7 të këtij ligji, AKEP-i mundet, gjithashtu, që ta trajtojë rastin me nismën e vet.</p> <p>6. Objekt i një vendimi të tillë mund jetë secili prej termave dhe kushteve të një marrëveshjeje aksesi dhe/ose interkoneksioni, përfshirë edhe tarifën. AKEP-i mund t'i bashkëlidhë këtij vendimi kushte për ndershmërinë, transparencën, mosdiskriminimin, arsyeshmërinë dhe grafikun kohor. Në lidhje me përcaktimin e tarifave, zbatohen nenet 53, 55, 56, 57, 58 dhe 59 të këtij ligji.</p> <p>7. Kur pjesë e pretendimeve të parashtruara dhe e shqyrtimit përkatës janë termat dhe kushtet e një marrëveshjeje aksesi dhe interkoneksioni, si edhe tarifën e pagueshme për shërbimet dhe/ose facilitetet e kërkuara, AKEP-i mund të marrë vendime për termat, kushtet dhe tarifën. Afati i zbatimit të këtyre vendimeve është një muaj nga data e hyrjes në fuqi të tyre.</p> <p>8. Sipërmarrësit duhet të zbatojnë vendimin e këshillit drejtues të AKEP-it brenda afateve të përcaktuara në të. Në rast të moszbatimit të urdhrin, AKEP-i vendos gjobë, sipas</p>	

Amendimet e propozuara në ligjin 9918 për komunikimet elektronike

Neni	Arsyeja	Teksti aktual	Teksti i propozuar	Shpjegim
			parashikimeve të nenit 137 të këtij ligji.	
62	BE 2009	<p>Neni 62</p> <p>Administrimi i spektrit të frekuencave</p> <p>1. Spektri i frekuencave është burim natyror i fundmë. Administrimi i spektrit duhet të sigurojë përdorimin e frytshëm dhe efektiv të tij, në përputhje edhe me vendimet përkatëse të organizmave ndërkombëtarë dhe detyrimet, që rrjedhin nga konventat ose nga marrëveshjet, ku Republika e Shqipërisë është palë.</p> <p>2. Për sigurimin e përdorimit të frytshëm dhe pa interferenca të frekuencave hartohet Plani Kombëtar i Frekuencave dhe Plani i Përdorimit të Frekuencave.</p> <p>3. Spektri i frekuencave administrohet nga:</p> <p>a) Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) për spektrin e frekuencave të caktuara për përdorim për qëllime civile, përveç frekuencave të caktuara për transmetimet radio dhe televizive;</p> <p>b) Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit (KKRT) për brezat e frekuencave, të caktuara për përdorim për transmetimet radiodifuzive (radio dhe televizive), për aq kohë sa nuk është parashikuar ndryshe nga legjislacioni në fuqi;</p> <p>c) Ministria e Mbrojtjes, Ministria Brendshme dhe Shërbimi Informativ i Shtetit për spektrin e frekuencave të caktuara për përdorim për qëllime qeveritare, të mbrojtjes kombëtare dhe sigurisë së rendit publik.</p> <p>4. Për përdorimin e frekuencave përdoruesit</p>	<p>Neni 62</p> <p>Administrimi i spektrit të frekuencave</p> <p>1. dhe 2. (të pandryshuara)</p> <p>3. Plani Kombëtar i Frekuencave vendos cili brez i Spektrit të Frekuencave administrohet nga:</p> <p>a) Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) për spektrin e frekuencave të vendosura për përdorim për qëllime civile, përveç frekuencave të vendosura për transmetimet radio dhe televizive;</p> <p>b) Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit (KKRT) për brezat e frekuencave, të vendosura për përdorim për transmetimet radiodifuzive (radio dhe televizive), për aq kohë sa nuk është parashikuar ndryshe nga legjislacioni në fuqi;</p> <p>c) Ministria e Mbrojtjes, Ministria Brendshme dhe Shërbimi Informativ i Shtetit për spektrin e frekuencave të vendosura për përdorim për qëllime qeveritare, të mbrojtjes kombëtare dhe sigurisë së rendit publik.</p> <p>4. Nenet 65 deri 78 të këtij ligji zbatohen vetëm për ato breza frekuencash të cilat administrohen nga AKEP.</p> <p>5. Menaxhimi i spektrit do të sigurojë që të gjitha llojet e teknologjisë së përdorur për shërbimet e komunikimeve elektronike mund të përdoren në brezat e radio frekuencave. Plani Kombëtar i Radio</p>	<p>Amendimet në pikën 3 sqarojnë se kush vendos nëse spektri do të administrohet nga AKEP, KKRT apo nga Ministria: kjo përcaktohet nga Plani Kombëtar i frekuencave I cili miratohet nga Këshilli I Ministrave. Pika e re 4 sqaron se nenet e mëposhtëm zbatohen vetëm ndaj atyre bandave të frekuencave të administruara nga AKEP.</p> <p>Neni I mëparshëm 62 pika 4 në të ardhmen do të zëvendësohet nga neni 78 pika 5 e ligjit, I cili vendos taksa mbi radiofrekuencat në lidhje me tarifën, përcakton objektivat për taksat dhe sqaron se vetëm ata që kanë autorizime individuale I nënshtrohen pagimit të tarifave ose taksave.</p> <p>Pikat e reja 5 dhe 6 transpozojnë parimet e neutralitetit të teknologjisë dhe neutralitetit të shërbimit që do të prezantohen nga nenet e rinj 9 (3) dhe (4) të Direktivës Kuadër.</p> <p>Terminologjia në pikën 3 duhet të jetë vendosje “allocation” kurse termi aktual “caktuar” është më i përshtatshëm për caktimin (autorizimi i përgjithshëm ose individual).</p>

Amendimet e propozuara në ligjin 9918 për komunikimet elektronike

Neni	Arsyeja	Teksti aktual	Teksti i propozuar	Shpjegim
		civilë paguajnë një taksë, e cila përcaktohet me ligj të veçantë.	<p>Frekuencave dhe Plani për Përdorimin e Frekuencave mund të parashikojë kufizime proporcionale dhe jo-diskriminuese për llojet e rrjeteve radio ose teknologjisë së aksesit pa tela të përdorur për shërbimet e komunikimeve elektronike, ku kjo është e nevojshme për të:</p> <p>a) parandaluar interferencat e dëmshme;</p> <p>b) për të mbrojtur shëndetin publik nga fushat elektromagnetike;</p> <p>c) për të siguruar cilësinë teknike të shërbimit;</p> <p>ç) për të siguruar maksimizimin e përdorimit të frekuencave që ndahen;</p> <p>d) ruajtjen dhe përdorimin efikas të spektrit, ose</p> <p>dh) të sigurohet përmbushja e objektivave me interes të përgjithshëm në përputhje me pikën 6 të këtij neni;</p> <p>6. Menaxhimi i spektrit do të sigurojë që të gjitha llojet e shërbimeve të komunikimeve elektronike mund të ofrohen në brezat e radio frekuencave. Plani Kombëtar i Frekuencave dhe Plani për Përdorimin e Frekuencave mund të parashikojnë kufizime proporcionale dhe jo diskriminuese për llojet e shërbimeve të komunikimeve elektronike të cilat do të ofrohen. Këto kufizime do të justifikohen në mënyrë që të sigurohet përmbushja e objektivave me interes të përgjithshëm, siç janë:</p> <p>a) përmbushja e kërkesave të Radio</p>	

Amendimet e propozuara në ligjin 9918 për komunikimet elektronike

Neni	Arsyeja	Teksti aktual	Teksti i propozuar	Shpjegim
			<p>Rregullores së ITU b) siguria për jetën; c) promovimi i një kohezioni social, rajonal ose territorial; ç) parandalimi i përdorimit jo efikas të radio frekuencave, ose d) promovimi i diversitetit kulturor, lingustik dhe pluralizmit të mediave, për shembull nëpërmjet ofrimit të shërbimeve të transmetimeve radio televizive.</p>	
65	BE 2009	<p>Neni 65 Përdorimi i frekuencave</p> <p>1. Personat fizikë apo juridikë mund të përdorin frekuenca vetëm pasi të jenë pajisur, paraprakisht, me autorizim nga AKEP-i, sipas përcaktimeve të këtij ligji.</p> <p>2. E drejta e përdorimit të frekuencave kufizohet vetëm në rast se kjo kushtëzohet nga pamjaftueshmëria e frekuencave dhe nga detyrimi për të siguruar përdorimin eficient të tyre.</p> <p>3. Kur frekuencat përdoren në kundërshtim me këtë ligj e rregulloret përkatëse dhe pa autorizimin përkatës, të lëshuar sipas këtij ligji, AKEP-i ndërmerret të gjitha masat e nevojshme, në përputhje me këtë ligj.</p> <p>4. Për përdorimin e frekuencave të caktuara në PKRF, për qëllime të sigurisë kombëtare dhe mbrojtjes së vendit, nuk do të kërkohet autorizim nga AKEP-i.</p>	<p>Neni 65 Përdorimi i frekuencave</p> <p>1. AKEP do të saktësojë me rregullore të gjitha brezat e frekuencave të cilat mund të përdoren sipas autorizimit të përgjithshëm, gjithahstu dhe kushtet e përdorimit të këtyre radio frekuencave, duke pasur parasysh harmonizimin e menaxhimit të radio frekuencave sipas rregullave dhe detyrimeve ndërkombëtare të pranura nga Republika e Shqipërisë. AKEP do të përfshijë në këtë rregullore të gjitha format e përdorimit të radio frekuencave përveç atyre ku autorizimet individuale janë të nevojshme në mënyrë që të:</p> <p>a) parandalohen interferencat e dëmshme; b) për të siguruar cilësinë teknike të shërbimit; c) garantuar përdorimin efikas të spektrit; ose</p>	<p>Sipas nenit 5 të Direktivës së Autorizimit , autorizimi I përgjithshëm duhet të jetë rregull, dhe autorizimi individual duhet të jetë përjashtim.</p> <p>Autorizimi I përgjithshëm në kontekstin e menaxhimit të spektrit nënkupton që një akt ligjor I një natyre të përgjithshme lejon këdo që të përdorë një bandë të caktuar në kushte të caktuara (për shembull kufizime të energjisë elektrike). Sipas ligjit aktual AKEP lëshon autorizime të përgjithshme duke miratuar një rregullore sipas nenit 67 pika 2. Formulimi I ri I nenit 65 nuk kërkon amendim të menjëhershëm të kësaj rregulloreje. Sidoqoftë në të ardhmen AKEP duhet të preferojë një teknologji të caktuar ose një bandë frekuence në këtë rregullore të autorizimit të përgjithshëm, pasa se të lëshojë autorizimet individuale.</p> <p>Formulimi I propozuar i pikës së re 3 kombinon nenin aktual 65 pika 2 dhe nenin 66 pika 2.</p>

Amendimet e propozuara në ligjin 9918 për komunikimet elektronike

Neni	Arsyeja	Teksti aktual	Teksti i propozuar	Shpjegim
		<p>5. Disa frekuenca mund të përdoren pa autorizim, në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe me rregullat e detyrimet ndërkombëtare, të pranuar nga Republika e Shqipërisë.</p>	<p>ç) përmbushjen e objektivave të tjera me interes të përgjithshëm;</p> <p>2. Ku përdorimi i radio frekuencave nuk është subjekt i autorizimit të përgjithshëm sipas pikës 1 të këtij neni, personat fizikë ose juridikë mund të përdorin radio frekuencat vetëm me autorizim individual nga AKEP në përputhje me nenet 67 deri 77 të këtij ligji.</p> <p>3. Në përgjithësi, AKEP do të lëshojë autorizime individuale sipas rradhës së marrjes së aplikimeve në përputhje me nenin 68 të këtij ligji. Vetëm ku interesi për një brez të caktuar frekuencash tejkalon spektrin e disponueshëm të frekuencave, AKEP do të zhvillojë një procedurë konkurimi publik në përputhje me nenet 68 deri 69 të këtij ligji.</p> <p>4. Kur frekuencat përdoren në kundërshtim me këtë ligj e rregulloret përkatëse dhe pa autorizimin përkatës, të lëshuar sipas këtij ligji, AKEP-i ndërmerr të gjitha masat e nevojshme, në përputhje me këtë ligj.</p>	<p>Pika 4 mund të fshihet, pasi amendimet në nenin 62 sqarojnë se nenet 65 deri në 78 zbatohen vetëm ndaj frekuencave që janë administruar nga AKEP. Nëse Plani Kombëtar I Frekuencave përcakton se një bandë e caktuar administrohet nga Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Brendshme dhe Shërbimi Informativ Shtetëror, nuk ka detyrim që këto institucione ta marrin një autorizim të tillë nga AKEP.</p> <p>Pika aktuale 5 mund të zëvendësohet nga pika e re 1.</p>
66	redaksionale	<p>Neni 66</p> <p>Dhënia e autorizimit individual</p> <p>1. AKEP-i lëshon një autorizim individual për përdorimin e frekuencave, në përputhje me PKRF-në dhe Planin e Përdorimit të Frekuencave, për caktimin dhe përdorimin e frekuencave sipas neneve 62, 63, 64, 65, 66, 67, 68, 69, 70 dhe 71 të këtij ligji.</p> <p>2. Në rastet e kufizimit, sipas pikës 2 të nenit 65</p>	<p>Neni 67</p> <p>hiqet</p>	<p>Ky nen përmban vetëm referenca dhe rregullin që Ministri miraton një tender.</p> <p>Referencat mund të fshihen, pasi ato janë përcaktuar në nenet 65 dhe 67.</p> <p>Dispozita për miratimin e Ministrisë është përfshirë dhe në nenin 69. Është më mirë të përmendet miratimi i Ministrisë vetëm në nenin</p>

Amendimet e propozuara në ligjin 9918 për komunikimet elektronike

Neni	Arsyeja	Teksti aktual	Teksti i propozuar	Shpjegim
		të këtij ligji, AKEP-i përdor procedurën e tenderit publik për dhënien e së drejtës së përdorimit të frekuencave, pas miratimit paraprak nga ministri.		69 në mënyrë që të jetë e qartë se në cilat hapa të procedurës është I nevojshëm miratimi.
67	BE 2009 dhe redaksionale	Neni 67 Procedura e dhënies së autorizimit individual 1. Frekuencat mund të përdoren vetëm në bazë të një autorizimi individual për përdorimin e frekuencave, përveç rasteve të përcaktuara ndryshe në këtë ligj. 2. AKEP-i përcakton kushtet për përdorimin e frekuencave në autorizimin e përgjithshëm, kur nuk është e nevojshme të jepet autorizim individual për përdorimin e frekuencave, sipas pikës 5 të nenit 65 të këtij ligji. ...	Neni 67 Procedura e dhënies së autorizimit individual 1. Ku përdorimi i radio frekuencave nuk është as subjekt i autorizimit të përgjithshëm sipas nenit 65 pika 1 të këtij ligji, as subjekt i një konkurimi publik sipas nenit 69 të këtij ligji, AKEP do të lëshojë autorizime individuale pas zbatimit të procedurave të vendosura në këtë nen. 2. Nëse AKEP merr aplikime të ndryshme për autorizime individuale në të njëjtin brez frekuencash, aplikimi i cili është paraqitur më herët ka përparësi ndaj aplikimit të paraqitur më vonë. 3. deri 7. (të pandryshuar)	Sipas Nenit 5 të Direktivës së Autorizimit, autorizimi I përgjithshëm duhet të jetë rregull dhe autorizimi individual duhet të jetë përjashtim. Ky parim shprehet nga neni I ri 65. Pika e propozuar 1 e përsërit këtë parim, dhe pika 2 e propozuar shpjegon se autorizimet individuale u jepen atyre që aplikojnë të parët. Shih edhe komentet për nenin 65 më lart.
68	BE 2002	Neni 68 Marrja e mendimeve të palëve të interesuara 1. Kur AKEP-i mendon që interesi në një brez të caktuar frekuencash është më i madh se frekuencat e mundshme për caktim në këtë brez dhe për të siguruar përdorimin eficient të tyre, kryen një proces këshillimi publik me palët e interesuara për kushtet e përdorimit të këtij brezi. Njoftimi për këtë këshillim, në çdo rast, përmban:	Neni 68 Frekuencat e fundme 1. Nëse AKEP në bazë të vlerësimit të tregut, konsideron se interesi për brezin e kërkuar të frekuencave mund të tejkalojë disponueshmërinë e frekuencave në këtë brez dhe efikasitetin e përdorimit të tyre, AKEP do të zhvillojë një proces të konsultimit publik me palët e interesuara lidhur me kushtet e përdorimit të këtij brezi	Neni 7(4) I Direktivës së Autorizimit parashikon një afat kohor maksimal prej 8 muajsh për procedura konkurruese ose krahasuese për të dhënë të drejtat e përdorimit të radiofrekuencave. Ky afat kohor nuk është transpozuar në ligjin 9918. Shtesat e propozuara synojnë të garantojnë se e gjithë procedura e neneve 68 dhe 69 plotësohet brenda këtij afati kohor.

Amendimet e propozuara në ligjin 9918 për komunikimet elektronike

Neni	Arsyeja	Teksti aktual	Teksti i propozuar	Shpjegim
		<p>a) të dhëna për frekuencat ose brezat e frekuencave, për të cilat mbahet parasysh që të zbatohet kufizimi;</p> <p>b) numrin e pritshëm të të drejtave të përdorimit që do të jepen;</p> <p>c) kushtet që AKEP-i mendon të vendosë për të dhënë të drejtat për të përdorur frekuencat;</p> <p>ç) arsyet, që çojnë në kufizimin e numrit të të drejtave, për të përdorur frekuencat;</p> <p>d) kërkesën, që palët e interesuara të shprehin mendimin e tyre për vlerën e tregut të frekuencës ose brezit të frekuencave.</p> <p>2. AKEP-i publikon një njoftim për paraqitjen e mendimeve të palëve të interesuara për vlerën e tregut të frekuencave, brenda një periudhe jo më të shkurtër se 30 ditë.</p> <p>3. AKEP-i është i detyruar të respektojë konfidencialitetin e propozimeve të mundshme të bëra nga palët e interesuara për vlerën e tregut për këto frekuenca.</p> <p>4. Njëherazi me publikimin e përfundimeve të konsultimit, sipas këtij neni, AKEP-i publikon njoftimin për kufizimin e numrit të të drejtave për të përdorur frekuenca, nëse një kufizim i tillë është i nevojshëm, për të siguruar plotësimin e qëllimit të përdorimit të frekuencave dhe nëse kjo nuk është në kundërshtim me interesin e përdoruesve ose me interesin e zhvillimit të konkurrencës ekonomike.</p> <p>5. Nëse AKEP-i, bazuar në këshillimin e kryer me palët e interesuara, sipas këtij neni, arrin në përfundimin se kërkesat për caktim të</p>	<p>frekuencash në mënyrë që të garantojë përdorimin e tij efikas.</p> <p>2. AKEP mund të fillojë konsultimin publik ex officio. Nëse AKEP merr një aplikim për autorizim individual dhe nuk zbaton procedurën e autorizimit individual të nenit 67 të këtij ligji, AKEP do të fillojë konsultimin publik jo më vonë se 30 ditë pas pranimit të aplikimit.</p> <p>3. Njoftimi publik për konsultimin e referuar në pikën 1 dhe 2 të këtij neni, në çdo rast do të përmbajë:</p> <p>a) të dhëna për frekuencat ose brezat e frekuencave, për të cilat mbahet parasysh që të zbatohet kufizimi;</p> <p>b) numrin e pritshëm të autorizimeve që mendohet të jepen;</p> <p>c) kushtet që AKEP-i mendon të vendosë për të dhënë të drejtat për të përdorur frekuencat;</p> <p>ç) arsyet, që çojnë në kufizimin e numrit të të drejtave, për të përdorur frekuencat;</p> <p>d) kërkesën, që palët e interesuara të shprehin mendimin e tyre për vlerën e tregut të frekuencës ose brezit të frekuencave.</p> <p>e) afatin kohor për paraqitjen e përgjigjeve të konsultimit publik, që do të jetë 30 ditë pas publikimit të njoftimit.</p> <p>4. AKEP informon palët e interesuara nëpërmjet një njoftimi publik në të paktën dy media të shkruara kombëtare me numrin më të lartë të tirazhit dhe një gazetë ndërkombëtare, për të zhvilluar</p>	<p>Linja kohore e propozuar është (në muaj):</p> <p>0: AKEP merr një aplikim, ose inicion procesin me iniciativën e vet.</p> <p>1: AKEP publikon dokumentin e këshillimit</p> <p>2: fundi I këshillimit</p> <p>3: AKEP publikon konkluzionet dhe ia paraqet ato Ministrit.</p> <p>3.5 Urdhri i Ministrit për fillimin e procedurës së konkurrimit publik</p> <p>5. AKEP-I publikon dokumentat e konkurrimit</p> <p>7. Afati për paraqitjen e ofertave</p> <p>8. Vendimi i AKEP</p> <p>Projekti mbështetet në objektivat e mëposhtme:</p> <p>a) Një ndarje e qartë e kompetencave ndërmjet Ministrit dhe AKEP-it, ku Ministri vendos për numrin e autorizimeve dhe cmimin rezervë dhe AKEP-I vendos për të gjitha detajet procedurale.</p> <p>b) Secili hap I procedurës ka një afat të caktuar në mënyrë që të garantojë se procedura e përgjithshme do të përfundojë brenda 8 muajve.</p> <p>c) Nëse procedura iniciohet nga kërkesa e një operatori, nuk mund të përfundojë pa dhënie të një autorizimi. Nëse procedura e konkurrimit publik nuk do të përdoret, AKEP duhet të procedojë sipas nenit 67 dhe të japë autorizimin individual sipas parimit “kush vjen I pari”. Dallimi I vetëm është që një operator në fillim interesohet në brezin e frekuencave dhe më pas, kur është vendosur që t’i jepet autorizimi atij</p>

Amendimet e propozuara në ligjin 9918 për komunikimet elektronike

Neni	Arsyeja	Teksti aktual	Teksti i propozuar	Shpjegim
		<p>frekuencave në një brez të caktuar janë më të mëdha se frekuencat disponibël për t'u caktuar në këtë brez, ajo zbaton procedurën e tenderit publik për caktimin e këtyre frekuencave, brenda 30 ditëve kalendarike nga publikimi i njoftimit të kufizimit të numrit të drejtave, për të përdorur frekuenca dhe pas miratimit nga ministri.</p>	<p>konsultimin publik sipas këtij neni. 5. AKEP do të publikojë përfundimet e përgjigjeve të marra brenda 30 ditëve pas afatit përfundimtar për paraqitjen e përgjigjeve, por është i detyruar të respektojë konfidencialitetin e propozimeve të mundshme të bëra nga palët e interesuara për vlerën e tregut për këto frekuenca. 6. Njëherazi me publikimin e përfundimeve të konsultimit, sipas këtij neni, AKEP-i njofton Ministrin për rezultatet e këshillimit. Gjithashtu AKEP informon Ministrin gjithashtu nëse konsideron se kërkesa tejkalon frekuencat e disponueshme, si dhe i propozon sa autorizime duhet të jepen dhe se si e vlerëson AKEP vlerën e tregut të këtyre frekuencave 7. Brenda 15 ditëve që nga marrja e informacionit dhe propozimit nga AKEP, sipas pikës 6, Ministri nxjerr një urdhër sipas të cilit vendos: a. nëse AKEP duhet të kryejë një konkurrim publik sipas nenit 69 ose të procedojë me autorizimet individuale sipas nenit 67 të këtij ligji. b. në rast të një konkurrimi publik, cilat blloqe frekuencash dhe sa autorizime duhen dhënë; dhe c. në rast të një konkurrimi publik, cmimin minimal që duhet paguar nga fituesit e konkurrimit për çdo autorizim të dhënë. 8. Urdhri i ministrit do të arsyetohet dhe publikohet. Ministri nuk është i detyruar të</p>	<p>që vjen I pari, e humbet interesin dhe nuk aplikon. d) Një dispozitë tranzitore nën nenin 138 sqaron se mund të përdoren rezultatet e këshillimit publik të kryer para hyrjes në fuqi të amendimeve. Kjo do të thotë se këshillimi dhe përgatitja e dokumentacionit të konkurrimit mund të fillojnë menjëherë dhe se urdhri I Ministrit dhe Vendimi I AKEP-it për dokumentat e konkurrimit mund të miratohen menjëherë pasi amendimet e këtij ligji të hyjnë në fuqi.</p>

Amendimet e propozuara në ligjin 9918 për komunikimet elektronike

Neni	Arsyeja	Teksti aktual	Teksti i propozuar	Shpjegim
			<p>ndjekë propozimet e AKEP-it për të marrë vendimin për urdhrin.</p> <p>9. Në varësi të urdhrit të Ministrit, AKEP ose do të vazhdojë me procedurën e konkurrimit publik sipas nenit 69 ose me procedurën e autorizimit individual sipas nenit 67 të këtij ligji.</p>	
69	BE 2002	<p>Neni 69</p> <p>Zbatimi i procedurës</p> <p>1. Pas miratimit të ministrit, AKEP-i zhvillon procedurën e tenderit, sipas legjislacionit në fuqi, për caktimin dhe përdorimin e frekuencave. Procedura duhet të jetë objektive, transparente, jodiskriminuese dhe proporcionale për të përmbushur objektivat e nenit 7 të këtij ligji.</p> <p>2. Koha e fillimit të shërbimit, periudha e autorizimit dhe numri i sipërmarrësve përcaktohen nga ministri, ndërsa veprimtaritë e tjera kryhen nga AKEP-i.</p>	<p>Neni 69</p> <p>Konkurrimi Publik</p> <p>1. Procedura e konkurrimit publik për të dhënë autorizime individuale për një numër të kufizuar të drejtash për të përdorur radio frekuencat do të jetë objektive, transparente, jodiskriminuese dhe proporcionale në mënyrë që të përmbushen objektivat e nenit 7 të këtij ligji. Dokumentacioni për konkurrim do të bazohet në parimin e asnjësisë teknologjike dhe të shërbimit sipas nenit 62 pika 5 dhe 6 e këtij ligji.</p> <p>2. AKEP do të hartojë dokumentin për konkurrim në bazë të parimeve të vendosura në pikën 1 të këtij neni dhe duke marrë parasysh përgjigjet e konsultimit publik dhe Urdhrit të Ministrit sipas nenit 68 të këtij ligji.</p> <p>3. Dokumenti për konkurrim publik duhet të përmbajë:</p> <p>a) Informacion për radio frekuencat të cilat janë subjekt i konkurrimit publik , zonat ose vendndodhjet ku këto radio frekuenca</p>	<p>Shih komentet e nenit 68 më lart.</p> <p>Do të ishte më mirë nëse neni 69 I ligjit 9918 të përshkruante procedurën më në detaje në vend që t'i referohet “legjislacionit në fuqi”.</p> <p>Pika e re 3 bazohet në dispozitat përkatëse të ligjit Maqedonas, pasi pjesët e tjera të kapitullit të menaxhimit të spektrit janë gjithashtu fort të mbështetura në ligjin Maqedonas.</p> <p>Pika 3a sqaron se kufizimet në lidhje me shërbimet ose teknologjitë janë një përjashtim. Sidoqoftë pa prekur parimin e neutralitetit të teknologjisë, do të ketë gjithmonë disa kufizime në lidhje me fuqinë e përdorur ose për mbrojtjen e brezave fqinjë (psh me maska mbrojtëse të anëve).</p> <p>Pika 3ë parashikon se ofertuesit mund të drejtojnë pyetje deri në një afat të caktuar. Sipas parimeve të transparencës dhe mosdiskriminimit, AKEP do t'ia paraqesë përgjigjet e veta të gjithë ofertuesve të interesuar.</p> <p>Pika 4 sqaron se rregullorja do të përfshijë të gjitha hollësitë procedurale të nevojshme. Kjo</p>

Amendimet e propozuara në ligjin 9918 për komunikimet elektronike

Neni	Arsyeja	Teksti aktual	Teksti i propozuar	Shpjegim
			<p>do të përdoren, dhe kufizimeve eventuale për shërbimet e ofruara ose teknologjitë e radio-komunikimeve;</p> <p>b) kushtet, kërkesat dhe kualifikimet të cilat duhet të përmbushen nga konkurrentët në konkurrim, të cilët duhet ti plotësojnë detyrimet e legjislacionit në fuqi dhe rregulloreve përkatëse për planifikimin hapësinor;</p> <p>c) kriteret për zgjedhjen e ofertës më të mirë, mënyra për aplikim dhe kufizime të tjera të mundshme do të merren parasysh në vlerësimin e konkurruesve;</p> <p>ç) shuma fillestare e vlerës së tregut të radio frekuencave si një pagesë e vetme për marrjen e autorizimit për përdorimin e radio frekuencave si burim i kufizuar natyror;</p> <p>d) afatin kohor dhe mënyrën e paraqitjes së ofertave;</p> <p>dh) adresën, vendin, datën dhe kohën e hapjes publike të ofertave;</p> <p>e) vendi, koha dhe personi i kontaktit nga i cili palët e interesuara mund të marrin dokumentin e konkurrimin dhe mënyra e pagesës për këtë dokument;</p> <p>ë) afati dhe adresa e kontaktit për pyetjet mbi dokumentacionin e konkurrimin ose kërkesat për informacion shtesë; dhe</p> <p>f) afati kohor brenda të cilit ofertuesit do të informohen për vendimin e marrë.</p> <p>4. Këshilli drejtues i AKEP do të vendosë për dokumentacionin e konkurrimin publik</p>	<p>mund të përfshijë rregulla për krijimin e një komisioni të brendshëm ose grupi pune që përgatit vlerësimin e ofertave për Këshillin Drejtues të AKEP-it.</p>

Amendimet e propozuara në ligjin 9918 për komunikimet elektronike

Neni	Arsyeja	Teksti aktual	Teksti i propozuar	Shpjegim
			<p>dhe procedurën me një rregullore, e cila do të përmbajë të gjitha rregullat e nevojshme të procedurës dhe vlerësimin e ofertave. Kjo rregullore nuk ka nevojë për këshillim të mëtejshëm sipas nenit 110 të këtij ligji. AKEP do të publikojë rregulloren jo më vonë se 45 ditë pas marrjes së urdhrit të Ministrit sipas nenit 68 të këtij ligji.</p> <p>5. Afati për paraqitjen e ofertave do të vendoset jo më herët se 45 ditë dhe jo më vonë se 75 ditë pas publikimit të rregullores për fillimin e konkurrimit publik.</p> <p>6. AKEP do të vendosë për të gjithë ofertat brenda 30 ditëve pas hapjes së ofertave. AKEP do të refuzojë me vendim aplikimet e ofertuesve të cilët nuk i përmbushin kriteret e vendosura në dokumentacionin e konkurrimit. Nëse numri i ofertuesve të mbetur është më lartë se numri i autorizimeve individuale në dispozicion, AKEP do të vendosë midis ofertuesve të mbetur duke u bazuar në kriteret për përzgjedhje të vendosura në dokumentin e konkurrimit. Nëse numri i ofertuesve të mbetur është më i vogël i barabartë se numri i autorizimeve individuale në dispozicion, AKEP do të lëshojë autorizime individuale të gjithë ofertuesve të cilët i përmbushin kriteret.</p> <p>7. Cmimet e ofruara dhe të paguara nga ofertuesit në procedurën e konkurrimit publik sipas këtij neni shkojnë në buxhetin e shtetit.</p>	

Amendimet e propozuara në ligjin 9918 për komunikimet elektronike

Neni	Arsyeja	Teksti aktual	Teksti i propozuar	Shpjegim
72	BE 2009	Neni 72 Kohëzgjatja e vlefshmërisë së autorizimit individual të frekuencave 1. AKEP-i lëshon autorizim individual për një interval kohe jo më të madh se 15 vjet. ...	Neni 72 Kohëzgjatja e vlefshmërisë së autorizimit individual të frekuencave 1. AKEP-i lëshon autorizim individual për një interval kohe jo më të madh se 15 vjet. Kohëzgjatja do jetë e përshtatshme për shërbimin e ofruar në këndvështrim të objektivit të caktuar duke marrë parasysh nevojën për të lejuar një periudhë të përshtatshme për amortizimin e investimit. 2. deri 4 të pandryshuar	Fjalja shtesë që propozohet për nenin 72 pika 1 transponon nenin e ri pika 5 paragrafi 2 të Direktivës së Autorizimit.
78	BE 2002	Neni 78 Pagesat për përdorimin e frekuencave Për caktimin dhe përdorimin e frekuencave bëhet pagesa, sipas përcaktimeve të nenit 119 të këtij ligji.	Neni 78 Pagesat për përdorimin e frekuencave 1. Personat të cilët mbajnë autorizim individual të lëshuar nga AKEP për përdorimin e radio frekuencave janë të detyruar të paguajnë pranë AKEP një herë dhe / pagesa vjetore. 2. AKEP cakton pagesat e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni dhe cakton mënyrën e faturimit të tyre me rregullore. Pagesat do të bazohen në kostot administrative të AKEP për menaxhimin e frekuencave. Në veçanti, a) të ardhurat totale vjetore nga pagesat e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni duhet të përputhen me koston administrative vjetore për menaxhimin e radio frekuencave; dhe b) ndryshimi i paesave për breza të	Shih edhe komentet për nenet 24, 117 dhe 119. Dispozita e re e propozuar sqaron se ka dy tipe pagesash për përdorimin e frekuencave: 1) Pagesat administrative (pika 1 deri në 4). Këto pagesa shkojnë në buxhetin e AKEP. Ato duhet të mbështeten në kostot administrative të AKEP. AKEP-I duhet të përcaktojë këto pagesa. Meqë ato kanë lidhje me kostot e AKEP-it dhe buxheti I AKEP ka nevojë për miratimin e Këshillit të Ministrave, nuk ka nevojë që detajet e pagesave administrative të kenë miratimin e KM (shih komentet për propozimin e fshirjes së nenit 119 më poshtë). Formulimi I ri sqaron se vetëm ata që kanë licence individuale duhet të paguajnë (jo përdoruesit e autorizimit të përgjithshëm, psh WLAN). Gjithashtu, vetëm personat e autorizuar nga AKEP duhet të paguajnë (për

Amendimet e propozuara në ligjin 9918 për komunikimet elektronike

Neni	Arsyeja	Teksti aktual	Teksti i propozuar	Shpjegim
			<p>ndryshëm të frekuencave duhet të përputhet me nryshimin në koston administrative për menaxhimin e këtyre brezave.</p> <p>3. Kur AKEP përgatit buxhetin vjetor sipas nenit 117 pika 2 e këtij ligji, AKEP do të rishikojë nëse një amendim i rregullores së referuar në pikën 2 të këtij neni do të jetë i nevojshëm në mënyrë që të ruhet parimi që pagesat administrative bazohen në kostot administrative. AKEP do të publikojë një përmbledhje të llogarive të përdorura dhe të përfundimeve.</p> <p>4. Para se AKEP të miratojë rregulloren përcaktuar në pikën 2 të këtij neni ose amendimin, AKEP do të zhvillojë një konsultim publik sipas nenit 110 të këtij ligji.</p> <p>5. Një ligj i veçantë mund të parashikojë që personat të cilët mbajnë autorizim të përgjithshëm për të përdorur radio frekuencat i paguajnë një taksë buxhetit të shtetit mbi pagesat për buxhetin e AKEP sipas pikave 1 deri 4 të këtij neni. Këto taksa do të reflektojnë nevojën për të garantuar një përdorim optimal të radio frekuencave si një burim i rrallë dhe duhet justifikuar në mënyrë objektive, transparente, mos diskriminuese dhe proporcionale në raport me qëllimin e tyre.</p>	<p>frekuencat e administruara nga KKRT, pagesat parashikohen në një ligj tjetër).</p> <p>Dispozitat e propozuara transpozojnë nenin 12 të direktivës së autorizimit. Në vecanti, pagesat duhet të rishikohen rregullisht në një process transparent.</p> <p>2) Taksat (pika 5). Këto duhet të paguhet mbi pagesat administrative. Taksat shkojnë për buxhetin e shtetit. Formulimi I propozuar transponon vetëm parimet e nenit 13 të Direktivës së Autorizimit, por hollësitë ia lë legjislacionit të taksave.</p> <p>Formulimi I propozuar I pikës 5 do të sqarojë që vetëm mbajtësit e autorizimeve individuale do t'u nënshtrohen taksave, kurse personat që përdorin spektrin pa autorizim individual (psh ELAN në brezin 2.4 GHz ose telefonat celulare të përdoruesve fundorë) nuk janë të detyruar të paguajnë taksat për spektrin. Kjo çështje ishte e paqartë në nenin actual 62, pika 4 e ligjit.</p>
79	BE 2002	Neni 79 Përdorimi i pajisjeve fundore 1. Sipërmarrësit nuk mund të refuzojnë, për	Neni 79 Përdorimi i pajisjeve fundore	Shih komentet për transpozimin e Direktivës R&TTE 1999/5/EC dhe direktivën EMC 2004/108/EC në fund të këtij dokumenti. Do

Amendimet e propozuara në ligjin 9918 për komunikimet elektronike

Neni	Arsyeja	Teksti aktual	Teksti i propozuar	Shpjegim
		<p>arsye teknike, një kërkesë të arsyeshme për lidhjen e një pajisjeje radio ose të një pajisjeje fundore telekomunikacioni, që është në përputhje me kërkesat e rregulloreve për pajisjet radio dhe pajisjet fundore të telekomunikacioneve.</p> <p>2. Përdoruesit nuk mund të lidhin në rrjetin publik të komunikacioneve pajisje radioje ose pajisje fundore telekomunikacioni, që nuk janë në përputhje me kërkesat e rregulloreve për këto pajisje.</p> <p>3. AKEP-i përcakton rregullat për lëshimin e dëshmimeve për pajisjet radio dhe pajisjet fundore të telekomunikacioneve, në përputhje me Direktivën 99/5/EC, të datës 9 mars 1999 (Direktiva R&TTE).</p>	<p>1. (i pandryshuar)</p> <p>2. (i pandryshuar)</p> <p>3. (hiqet)</p>	<p>të ishte më mirë të transpozoheshin këto direktiva si ligj I vecantë, por duhet të diskutohet se cila ministri duhet të jetë përgjegjëse për transpozimin dhe zbatimin.</p> <p>Në cdo rast, neni 79 pika 3 nuk është bazë e mjaftueshme për transpozimin pasi Direktiva R&TTE nuk ka të bëjë me lëshimin e certifikatave për pajisje. Ne sugjerojmë që të fshihet.</p>
80	të tjera	<p>Neni 80</p> <p>Plani i numeracionit</p> <p>1. Plani i numeracionit përcakton strukturën, gjatësinë dhe caktimin e numrave për akses në rrjetet dhe shërbimet e komunikimeve publike.</p> <p>2. AKEP-i administron planin e numeracionit në mënyre që:</p> <p>a) të sigurojë strukturimin dhe përdorimin eficient të numrave dhe serive numerike;</p> <p>b) të kënaqë nevojat e arsyeshme të operatorëve dhe ofruesve të shërbimeve të komunikimeve elektronike publike për caktim të numrave, sipas këtij ligji;</p> <p>c) të sigurojë që caktimi dhe përdorimi i numrave bëhet në mënyrë të ndershme, transparente dhe jodiskriminuese.</p>	<p>Neni 80</p> <p>Plani i numeracionit</p> <p>1. Plani i numeracionit përcakton strukturën, gjatësinë dhe caktimin e numrave për akses në rrjetet dhe shërbimet e komunikimeve publike.</p> <p>Plani i Numeracionit mund të përmbajë parime të përcaktimit të tarifave dhe çmime maksimale të cilat aplikohen në një seri të caktuar të numrave për qëllim të mbrojtjes së konsumatorëve.</p> <p>2. deri 4. (të pandryshuar)</p>	<p>Ne propozojmë që të përfshihet në nenin 80 të ligjit 9918 shprehimisht që Plani i Numeracionit mund të përmbajë parime të tarifave dhe çmime maksimale që gjejnë zbatim në seri specifike numrash për hir të mbrojtjes së konsumatorit (shih dispozitat e reja në Pjesën C, pika 1 Shtojca 1 e Direktivës së Autorizimit).</p> <p>Shembujt janë rregulla si thirrjet ndaj numrave 0800 duhet të jenë gjithnjë pa pagesë dhe thirrjet ndaj numrave 0900 kanë, ndonëse ato mund të jenë të shtrenjta një çmim tavan. Kjo është një dispozitë për të rregulluar hapësirën e numeracionit, dhe jo për rregullimin e tarifave në përgjithësi.</p>

Amendimet e propozuara në ligjin 9918 për komunikimet elektronike

Neni	Arsyeja	Teksti aktual	Teksti i propozuar	Shpjegim
		<p>3. AKEP-i ruan të gjitha të dhënat, që lidhen me administrimin e planit të numeracionit.</p> <p>4. AKEP-i publikon caktimin e numrave dhe të serive numerike, si dhe përdoruesit e tyre në faqen e vet të internetit.</p>		
82	BE 2002	<p>Neni 82</p> <p>Caktimi i numrave</p> <p>1. Sipërmarrësit e rrjeteve të komunikimeve elektronike publike dhe të shërbimeve të komunikimeve elektronike publike aplikojnë për caktimin e numrave dhe serive numerike.</p> <p>...</p>	<p>Neni 82</p> <p>Caktimi i numrave</p> <p>1. Sipërmarrësit e rrjeteve të komunikimeve elektronike publike dhe të shërbimeve të komunikimeve elektronike publike aplikojnë për caktimin e numrave dhe serive numerike.</p> <p>AKEP do të vendosë për këto aplikime brenda jo më shumë se tri javëve.</p> <p>...</p>	<p>Neni 5 i Direktivës së Autorizimit (në variantin e tij aktual dhe të ri) parashikon një afat kohor prej tri javësh për vendime mbi numrat. Kjo duhet të transpozohet në nenin 82 të ligjit 9918.</p> <p>Direktiva do të lejonte zgjatjen e afatit kohor për tri javë të tjera nëse numrat me vlerë të vecantë ekonomike caktohen nëpërmjet procedurave konkurruese ose krahasuese perzgjedhjeje. Meqë kjo nuk është pjesë e praktikës aktuale shqiptare ne sugjerojmë që të mos transpozohet ky opsion.</p>
86	BE 2002	<p>Neni 86</p> <p>Pagesat për përdorimin e numrave dhe të serive numerike</p> <p>1. Mbajtësit e të drejtave për përdorimin e numrave dhe të serive numerike paguajnë pranë AKEP-it një pagesë për përdorimin e numrave dhe të serive numerike të caktuara.</p> <p>2. Kriteret për llogaritjen e pagesave bazohen në llojin, përdorimin dhe gjatësinë e numrave.</p> <p>3. Pagesa për përdorimin e numrave dhe të serive të numrave të caktuara bëhet për çdo vit në formë paradhënieje, duke filluar nga data e marrjes së vendimit për caktimin e numrave dhe serive numerike.</p>	<p>Neni 86</p> <p>Pagesa për përdorimin e numrave</p> <p>1. Mbajtësit e të drejtave për përdorimin e numrave dhe serive të numrave detyrohen t'i paguajnë AKEP-it tarifa një herë dhe/ose vjetore.</p> <p>2. AKEP-i do të specifikojë tarifat sipas pikës 1 të këtij neni dhe mënyrën e faturimit të tyre në një rregullore. Tarifat do të bazohen në kostot administrative të AKEP-it për menaxhimin e numrave. Në vecanti:</p> <p>a) të ardhurat e përgjithshme vjetore nga tarifat sipas pikës 1 të këtij neni duhet të</p>	<p>Neni I ri transponon më qartë Direktivën e Autorizimit sipas të cilit këto pagesa do të bazohen në kostot administrative të AKEP-it. Shih gjithashtu projektin e ngjashëm për tarifat e spektrit (neni 78 më lart).</p>

Amendimet e propozuara në ligjin 9918 për komunikimet elektronike

Neni	Arsyeja	Teksti aktual	Teksti i propozuar	Shpjegim
		4. Pagesat për përdorimin e numrave dhe serive numerike bëhen sipas përcaktimeve të nenit 119 të këtij ligji.	<p>korrespondojnë me kostot e përgjithshme administrative vjetore për menaxhimin e numrave; dhe</p> <p>b) diferencat e tarifave për kategoritë e ndryshme të numrave duhet të korrespondojnë me diferencat në kostot administrative për menaxhimin e këtyre kategorive.</p> <p>3. Kur AKEP përgatit buxhetin e tij vjetor sipas nenit 117 pika 2 e këtij ligji, do të rishikojë nëse është I nevojshëm një amendim I rregullores sipas pikës 2 të këtij neni në mënyrë që të zbatohet parimi se tarifat administrative bazohen tek kostot administrative. AKEP-I do të publikojë një përmbledhje të përlllogaritjeje dhe përfundimet.</p> <p>4. Para se AKEP të miratojë rregulloren sipas pikës 2 të këtij neni, ose ndonjë amendim, AKEP do të kryejë një këshillim publik sipas nenit 110 të këtij ligji.</p>	
87	BE 2009	<p>Neni 87</p> <p>Portabiliteti i numrave</p> <p>1. Sipërmarrësit e rrjeteve telefonike publike krijojnë në rrjetet e tyre mundësinë që pajtimtarët të mbartin numrin e tyre të telefonit, pavarësisht nga sipërmarrësi që u ofron shërbimin telefonik, si më poshtë:</p> <p>a) në rastin e numrave gjeografikë – në një rajon të caktuar;</p> <p>b) në rastin e numrave jogjeografikë – në çdo rajon.</p>	<p>Neni 87</p> <p>Portabiliteti i numrave</p> <p>1. Sipërmarrësit e rrjeteve telefonike publike krijojnë në rrjetet e tyre mundësinë që pajtimtarët të mbartin numrin e tyre të telefonit, pavarësisht nga sipërmarrësi që u ofron shërbimin telefonik, si më poshtë:</p> <p>a) në rastin e numrave gjeografikë – në një rajon të caktuar;</p> <p>b) në rastin e numrave jogjeografikë – në çdo rajon.</p>	<p>Amendimet e nenit 30 të Direktivës së Shërbimit Universal do të ndryshojnë në mënyrë domethënëse dispozitat për portabilitetin e numrave. Duhet të jetë e mundur që të barten të gjithë numrat nga plani kombëtar I numeracionit dhe bartja nuk duhet të zgjatet me shumë se një ditë pune.</p> <p>AKEP I ka marrë këto amendime parasysht në përgatitjet për të prezantuar portabilitetin e numrit.</p> <p>Ne propozojmë që të amendohet neni 87 dhe</p>

Amendimet e propozuara në ligjin 9918 për komunikimet elektronike

Neni	Arsyeja	Teksti aktual	Teksti i propozuar	Shpjegim
		<p>2. Parashikimi i pikës 1 të këtij neni zbatohet vetëm brenda diapazoneve numerike të përcaktuara për shërbimin telefonik.</p> <p>3. Numrat telefonikë nuk mbarten nga rrjetet publike telefonike fikse në rrjetet publike telefonike të lëvizshme dhe anasjelltas.</p> <p>4. Të gjithë sipërmarrësit e rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike publike fikse janë të detyruar të mundësojnë portabilitetin e numrit gjeografik portabiliteti i numrave gjeografike për të gjithë pajtimtarët e tyre, kur ata ndryshojnë sipërmarrësin, që u ofron shërbimin publik telefonik fikse.</p> <p>5. Të gjithë sipërmarrësit e rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike publike të lëvizshme janë të detyruar të mundësojnë portabilitetin e numrit gjeografik portabiliteti i numrave gjeografike për të gjithë pajtimtarët e tyre, kur ata ndryshojnë sipërmarrësin, që u ofron shërbimin publik telefonik të lëvizshëm.</p> <p>6. Sipërmarrësit mund të ngarkojnë pajtimtarët e tyre ose sipërmarrësit e tjerë me një tarifë për portabilitetin e numrit. Tarifat duhet të jenë të orientuara në kosto dhe të mos shërbejnë si faktorë frenues për përdorimin nga pajtimtarët të shërbimit të portabilitetit të numrit.</p> <p>1. Kostot e përshtatjes dhe të mirëmbajtjes së rrjeteve, në mënyrë që të mundësohet portabiliteti i numrit, përballohen nga sipërmarrësit përkatës.</p>	<p>2. Përcaktimet në pikën 1 zbatohen për të gjithë numrat të Planit të Numeracionit. AKEP mund të përcaktojë seri numrash të cilat nuk janë subjekt i portabilitetit të numrit.</p> <p>3. Numrat telefonikë nuk mbarten nga rrjetet publike telefonike fikse në rrjetet publike telefonike të lëvizshme dhe anasjelltas.</p> <p>4. Të gjithë sipërmarrësit e rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike publike fikse janë të detyruar të mundësojnë portabilitetin e numrit gjeografik për të gjithë pajtimtarët e tyre, kur ata ndryshojnë sipërmarrësin, që u ofron shërbimin publik telefonik fikse.</p> <p>5. Të gjithë sipërmarrësit e rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike publike të lëvizshme janë të detyruar të mundësojnë portabilitetin e numrave të lëvizshëm për të gjithë pajtimtarët e tyre, kur ata ndryshojnë sipërmarrësin, që u ofron shërbimin publik telefonik të lëvizshëm.</p> <p>6. Sipërmarrësit mund të ngarkojnë pajtimtarët e tyre ose sipërmarrësit e tjerë me një tarifë për portabilitetin e numrit. Tarifat duhet të jenë të orientuara në kosto dhe të mos shërbejnë si faktorë frenues për përdorimin nga pajtimtarët të shërbimit të portabilitetit të numrit.</p> <p>7. Kostot e përshtatjes dhe të mirëmbajtjes së rrjeteve, në mënyrë që të mundësohet portabiliteti i numrit, përballohen nga sipërmarrësit përkatës.</p> <p>8. AKEP nuk vendos tarifa me pakicë për</p>	<p>88 I ligjit 9918.</p> <p>Portabiliteti i numrit duhet të jetë në dispozicion të të gjithë numrave të Planit të Numeracionit, për shembull jo vetëm për numrat gjeografikë ose të lëvizshëm, por edhe për numrat personalë (0700), numrat e gjelbër (0800), numrat blu (0808) ose numrat për shërbimet me vlerë të shtuar. AKEP do të caktojë seritë e numrave të cilat përjashtohen nga portabiliteti I numrave. Për shembull, portabiliteti I numrave nuk ka kuptim për numrat e urgjencës, për kodet e shkurtër për shërbimet e operatorëve (123, 13y, 14y).</p> <p>Amendimi në pikën 5 korrigjon një gabim editorial.</p> <p>Për dispozitat e reja për kohëzgjatjen e kontratës në Nenin 30 paragrafi 5 dhe 6 të Direktivës së Shërbimit Universal shih nenin 99 më poshtë.</p> <p>Pika 9 transponon kërkesat e reja në lidhje me kohëzgjatjen e bartjes. Afati një ditë rrjedh nga Direktiva e Shërbimit Universal. AKEP-i ka propozuar tashmë se bartja do të mbështetet nga nga një bazë qendrore të dhënash. Për shumicën e pajtimtarëve kjo do të lejonte që të plotësohej procesi i bartjes ndërkohë që pajtimtari pret në dyqanin e ofruesit të ri.</p> <p>Pika 10 lejon AKEP-in të bëjë përjashtime ku kjo është e nevojshme, psh periudha periudha më të gjata tranziti për operatorët e vegjël, përjashtime për përdoruesit me teknologji jo të zakonshme “bartjen bulk” të shumë numrave të pajtimtarëve në të njëjtën kohë. Në lidhje me bartjen e numrave fikse, pajtimtarët do të</p>

Amendimet e propozuara në ligjin 9918 për komunikimet elektronike

Neni	Arsyeja	Teksti aktual	Teksti i propozuar	Shpjegim
			<p>portabilitetin e numrave në mënyrë që deformon konkurrencën duke vendosur tarifa të caktuara ose të zakonshme me pakicë.</p> <p>9. Mbartja e numrave dhe aktivizimi i tyre do të bëhet brenda afatit më të shkurtër kohor të mundshëm. Në parim, pajtimtarët të cilët kanë lidhur kontratë për mbartjen e numrit tek një sipërmarrës i ri do ta kenë numrin e ri të aktivizuar brenda një dite pune dhe humbja e shërbimit gjatë procesit të mbartjes nuk do të jetë më e gjatë se një ditë.</p> <p>10. AKEP mund të parashikojë në rregullore përjashtime nga parimi i përcaktuar në pikën 9 të këtij neni, ku është e nevojshme në lidhje:</p> <p>a) sipërmarrësit me një numër të vogël pajtimtarësh;</p> <p>b) grupet e pajtimtarëve me kontrata të vecanta ose që përdorin teknologji jo të zakonshme;</p> <p>c) procese të vecanta për bartjen e shumë numrave në të njëjtën kohë, ose</p> <p>ç) përputhjen e procesit të bartjes me procese të tjera si hapja e qarkut lokal.</p>	<p>kërkojnë shpesh bartjen e tyre dhe për hapjen e rrjetit lokal. Në raste të tilla pajtimtarët nuk kanë nevojë për bartje të shpejtë, por një përputhje të ngushtë të kohës së bartjes me atë të hapjes së rrjetit.</p>
90	BE 2009	<p>Neni 90</p> <p>Numrat jogeografikë</p> <p>1. Sipërmarrësit e rrjeteve publike telefonike ose të shërbimeve telefonike të disponueshme për publikun janë të detyruar që, kur është e</p>	<p>Neni 90</p> <p>Aksesi në numra dhe shërbime</p> <p>1. Nëse teknikisht dhe ekonomikisht është e mundur dhe përveç kur pajtimtari i thirrur zgjedh për arsye komerciale të kufizojë</p>	<p>Amendimet ndaj nenit 28 të Direktivës së Shërbimit Universal do të sqarojnë kuptimin e saj, dhe vecanërisht do të theksojnë parimin e neutralitetit të teknologjisë. Do të ishte me vend të amendohej neni 90 I ligjit 9918 në këtë mënyrë.</p>

Amendimet e propozuara në ligjin 9918 për komunikimet elektronike

Neni	Arsyeja	Teksti aktual	Teksti i propozuar	Shpjegim
		<p>mundur teknikisht dhe ekonomikisht, t'u sigurojnë përdoruesve jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, mundësinë të bëjnë thirrje drejt numrave jogjeografikë të caktuar në Republikën e Shqipërisë, sipas planit kombëtar të numeracionit.</p> <p>2. Sipërmarrësit e rrjeteve publike telefonike ose shërbimeve telefonike të disponueshme për publikun nuk janë të detyruar të plotësojnë detyrimin e pikës 1 të këtij neni, në rastet kur pajtimtari i thirrur ka vendosur, për arsye biznesi, të kufizojë thirrjet e origjinuara nga zona të veçanta.</p> <p>3. Sipërmarrësit e rrjeteve të komunikimeve elektronike dhe të rrjeteve të komunikimeve publike duhet të lejojnë përdorimin e shërbimit publik telefonik nomadik nga përdoruesit e tyre.</p>	<p>aksesin duke thirrur palë që ndodhen në zona të veçanta gjeografike, AKEP do të garantojë që përdoruesit fundorë mund të:</p> <p>a) kenë akses dhe përdorin shërbime duke përdorur numra jogjeografikë brenda Europës; dhe</p> <p>b) kenë akses në numra të ofruar në Europë, pavarësisht nga teknologjia dhe pajisjet e përdorura nga operatorët, duke përfshirë ato të planit kombëtar të numeracionit, ato të ETNS dhe të Numrave Ndërkombëtarë Universalë pa Pagesë (UIFN).</p> <p>2. AKEP mund të kërkojë nga sipërmarrësit të cilët ofrojnë rrjete të komunikimit publik dhe / ose shërbime të komunikimeve elektronike të vlefshme për publikun të bllokojnë, bazuar rast-pas-rasti, aksesin në numra ose shërbime ku kjo justifikohet në raste të mashtrimit ose keqpërdorimit dhe të kërkojë që në këto raste ofruesit e shërbimeve të komunikimeve elektronike të ndërpresin interkoneksionin përkatës ose të ardhurat nga shërbimet.</p> <p>3. Të gjithë sipërmarrësit të cilët ofrojnë shërbime telefonike të vlefshme për publikun të cilët lejojnë thirrje ndërkombëtare do të pranojnë lidhje drejt dhe nga ETNS me tarifa të ngjashme me ato të aplikuara për thirrjet drejt vendeve anëtare të Bashkimit European.</p>	<p>Pika e re e propozuar 3 mbështetet në nenin e ri 27 paragrafi 2 I Direktivës së Shërbimit Universal.</p>
98	BE 2009	Neni 98	Neni 98	Dispozita në nenin 21 të Direktivës së Shërbimit Universal për transparencën dhe

Amendimet e propozuara në ligjin 9918 për komunikimet elektronike

Neni	Arsyeja	Teksti aktual	Teksti i propozuar	Shpjegim
		<p>Transparenca dhe publikimi i informacionit</p> <p>1. Sipërmarrësit e rrjeteve dhe të shërbimeve të komunikimeve elektronike publike janë të detyruar të publikojnë informacion të saktë dhe të hollësishëm për tarifatat dhe kushtet e përgjithshme për aksesin dhe përdorimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike publike. Ky informacion publikohet me anë të mjeteve të informimit publik.</p> <p>2. AKEP-i përcakton, me anë të një dokumenti rregullator, llojin dhe përmbajtjen e informacionit, që sipërmarrësit e rrjeteve dhe të shërbimeve të komunikimeve elektronike publike janë të detyruar të publikojnë.</p> <p>3. AKEP-i publikon të dhëna për të informuar përdoruesit për shërbimet e komunikimeve, bazuar në cilësinë e shërbimit dhe tarifatat e tyre, për të mundësuar zgjedhjen e tyre në buletin dhe në faqen elektronike të saj.</p>	<p>Transparenca dhe publikimi i informacionit</p> <p>1. Sipërmarrësit e rrjeteve dhe të shërbimeve të komunikimeve elektronike publike dhe / ose shërbime të komunikimeve elektronike të vlefshme për publikun do të publikojnë informacion transparent, të krahasueshëm, të përshtatshëm dhe të përditësuar për tarifatat dhe çmimet e aplikuar, çdo modifikim në përfundimin e kontratës dhe kushtet e përgjithshme për aksesin në dhe përdorimin e shërbimeve të ofruara nga ata për përdoruesit fundorë në përputhje me pikën 2 të këtij neni. Ky informacion do të publikohet në mënyrë të qartë, gjithëpërfshirëse dhe lehtësisht të aksesueshme. AKEP mund të përcaktojë me rregullore kërkesat shtesë lidhur me formën në të cilën këto informacione do të publikohen.</p> <p>2. AKEP mund të vendosë nëpërmjet një rregulloreje se çfarë informacioni publikohet nga sipërmarrësi i cili ofron rrjete të komunikimit publik dhe / ose shërbime telefonike të vlefshme për publikun dhe çfarë informacioni publikohet nga vetë AKEP për të garantuar që konsumatorët mund të marrin vendime të mirë informuar. AKEP do të garantojë që informacioni i mëposhtëm do të publikohet.</p> <p>a) Emrat dhe adresat e sipërmarrësve të cilët ofrojnë rrjete të komunikimeve publike</p>	<p>publikimin e informacionit duhet të amendohen në mënyrë domethënëse. Ne sugjerojmë që të amendohet neni 98 I ligjit 9918 në këtë mënyrë.</p>

Amendimet e propozuara në ligjin 9918 për komunikimet elektronike

Neni	Arsyeja	Teksti aktual	Teksti i propozuar	Shpjegim
			<p>dhe / ose shërbime telefonike të vlefshme për publikun;</p> <p>b) Fushëveprimi i shërbimit të ofruar dhe gatishmëria gjeografike e shërbimeve;</p> <p>c) Tarifat standarde të cilat tregojnë shërbimet e ofruara dhe përmbajtjen e secilit element të tarifave (p.sh. detyrimet për akses, të gjitha llojet e detyrimeve për përdorimin, detyrimet për mirëmbajtje) dhe duke përfshirë detajet e zbritjeve standarde të aplikuara, planet tarifore speciale dhe të orientuara, çdo detyrim shtesë si dhe kostot lidhur me pajisjet fundore.</p> <p>ç) Politika e kompenzimit / rimbursimit, duke përfshirë detajet specifike të çdo plani për kompenzimim / rimbursim të ofruar.</p> <p>d) Llojet shërbimit të mirëmbajtjes të ofruara.</p> <p>dh) Kushtet e përgjithshme, duke përfshirë periudhën minimale kontraktuale, përfundimin e kontratës dhe procedurat dhe detyrimet e drejtpërdrejta të lidhura me portabilitetin e numrit dhe tregues të tjerë nëse janë me rëndësi.</p> <p>e) Mekanizmat për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, duke përfshirë ato të zhvilluara nga sipërmarrësit.</p> <p>ë) Informacion për të drejtat lidhur me shërbimin universal, duke përfshirë nëse është e përshtatshme facilitetet dhe shërbimet e përmendura në nenin 27 pika 6 e këtij ligji.</p> <p>3. AKEP do të inkurajojë ofrimin e</p>	

Amendimet e propozuara në ligjin 9918 për komunikimet elektronike

Neni	Arsyeja	Teksti aktual	Teksti i propozuar	Shpjegim
			<p>informacioneve krahasuese për ti mundësuar përdoruesve fundorë dhe konsumatorëve të bëjnë një vlerësim të pavarur të kostos së përdorimit të modeleve alternative, për shembull duke përdorur një guidë interaktive ose teknika të ngjashme. Kur këto facilitate nuk janë të disponueshme pa pagesë ose me çmim të arsyeshëm në treg, AKEP do ti vërë vetë në dispozicion këto guida ose teknika. Palët e treta mund të përdorin, pa pagesë, informacionin e publikuar nga sipërmarrësit të cilët ofrojnë rrjete të komunikimeve elektronike dhe / ose shërbime të komunikimeve elektronike të vlefshme për publikun me qëllim të shitjes ose venies në dispozicion të këtyre guidave ose teknikave të ngjashme.</p> <p>4. AKEP mund të detyrojë sipërmarrësit të cilët ofrojnë rrjete të komunikimeve elektronike dhe / ose shërbime të komunikimeve elektronike të vlefshme për publikun ndërmjet të tjerash:</p> <p>a) ti ofrojë pajtimtarëve informacion mbi tarifatat e aplikueshme për çdo numër ose shërbim subjekt i kushteve të veçanta të tarifimit; lidhur me kategoritë individuale të shërbimeve, AKEP mund të kërkojë që ky informacion të ofrohet menjëherë para lidhjes së thirrjes;</p> <p>b) të informojë pajtimtarët për çdo ndryshim të aksesit në shërbime të emergjencës ose të informacionit për vendndodhjen e numrit thirrës në</p>	

Amendimet e propozuara në ligjin 9918 për komunikimet elektronike

Neni	Arsyeja	Teksti aktual	Teksti i propozuar	Shpjegim
			<p>shërbimin që janë pajtuar;</p> <p>c) të informojë pajtimatrët për çdo ndryshim të kushteve të cilat kufizojnë aksesin në dhe / ose përodrimin e shërbime dhe aplikimeve dhe ku këto shërbime janë të lejueshme me ligjet në fuqi;</p> <p>ç) të ofrojë informacion për çdo procedurë të vendosur nga ofruesi në mënyrë që të masë dhe drejtojë trafikun për të evituar ngarkesën ose mbingarkesën e lidhjeve të rrjetit dhe si këto procedura mund të ndikojnë në cilësinë e shërbimit;</p> <p>d) të informojë pajtimtarët për të drejtën e tyre për të vendosur për të përfshirë ose jo të dhënat e tyre personale në numerator si dhe mbi llojin e të dhënave në përputhje me nenin 104; dhe</p> <p>dh) të informojnë rregullisht pajtimtarët me aftësi të kufizuara për detajet e produkteve dhe shërbimeve të dizajnuara për ata.</p> <p>5. Sipërmarrësit e shërbimeve publike të komunikimeve duhet të publikojnë në faqen e tyre të internetit kushtet e përgjithshme të kontratave tip dhe t'ia paraqesin ato AKEP-it për inspektim të paktën shtatë ditë para publikimit.</p> <p>6. AKEP mund, para ose pas publikimit të kushteve të përgjithshme, miratojë një vendim që amendon ose shfuqizon disa dispozita të atyre kushteve të përgjithshme në rast se vendos se ato janë në kundërshtim me këtë ligj, aktet nënligjore</p>	

Amendimet e propozuara në ligjin 9918 për komunikimet elektronike

Neni	Arsyeja	Teksti aktual	Teksti i propozuar	Shpjegim
			në bazë të këtij ligji ose ligje të vecanta që rregullojnë mbrojtjen e konsumatorit.	
99	BE 2009	<p>Neni 99</p> <p>Kontrata e pajtimit</p> <p>1. Sipërmarrësit sigurojnë lidhjen ose aksesin në rrjetin publik të komunikimeve elektronike, në bazë të kontratës që lidhet me pajtimtarët në zbatim të legjislacionit në fuqi. Kontrata e pajtimit, në veçanti, duhet të përmbajë:</p> <p>a) emrin dhe adresën e sipërmarrësit;</p> <p>b) identitetin e plotë të pajtimtarit dhe adresën e tij;</p> <p>c) shërbimet e ofruara, cilësinë e shërbimit të ofruar, si dhe kohën për lidhjen fillestare;</p> <p>ç) llojin dhe mënyrën e mirëmbajtjes së shërbimeve të ofruara;</p> <p>d) një informacion të hollësishëm për tarifën, si dhe periudhën kohore për njoftimin e çdo ndryshimi të tyre;</p> <p>dh) një informacion për hyrjen në fuqi, kohëzgjatjen e kontratës së pajtimtarit, kushtet për shtyrjen dhe përfundimin e kontratës dhe të ofrimit të shërbimeve;</p> <p>e) mënyrat e kompensimit dhe të rimbursimit në rastet kur shërbimi i kontraktuar nuk plotëson nivelin e cilësisë së parashikuar në kontratë;</p> <p>ë) udhëzime për procedurat e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve;</p> <p>f) detyrimin për njoftim të përdoruesve për ndryshimet e parashikuara në kushtet e</p>	<p>Article 99</p> <p>Kontrata e pajtimit</p> <p>1. Kontrata midis pajtimtarit dhe sipërmarrësit që ofrojnë lidhjen në rrjetin publik të komunikimeve dhe / ose shërbime të komunikimeve elektronike të vlefshme për publikun do të përcaktojë në mënyrë të qartë, gjithëpërfshirëse dhe lehtë të aksesueshme të paktën:</p> <p>a) identitetin dhe adresën e sipërmarrësit;</p> <p>b) shërbimet e ofruara, duke përfshirë në veçanti,</p> <p>i. nëse aksesin në shërbimet e emergjencës dhe informacionin për vendndodhjen e numrit thirrës ofrohet dhe / ose çdo kufizim në ofrimin e shërbimeve të emergjencës;</p> <p>ii. informacion për çdo kusht tjetër që kufizon aksesin në dhe / ose përdorimin e shërbimeve dhe aplikimeve, ku këto kushte lejohen sipas këtij ligji;</p> <p>iii. minimumin e nivelit të cilësisë së ofruar, që do të thotë koha për lidhjen fillestare dhe, ku është e përshtatshme, parametra të tjerë të cilësisë së shërbimit;</p> <p>iv. informacion për çdo procedurë të vendosur nga sipërmarrësi për të matur dhe drejtuar trafikun në mënyrë që të evitohet ngarkesa ose mbingarkesa e lidhjeve të</p>	<p>Dispozita në nenin 20 të Direktivës së Shërbimit për kontrata ndërmjet operatorëve dhe pajtimtarëve do të amendohet në mënyrë domethënëse. Ne sugjerojmë që të amendohet neni 99 I ligjit 9918 në këtë mënyrë.</p> <p>Pika e re e propozuar 3 dhe 4 janë mbështetur në nenin 30 paragrafi 5 dhe 6 të Direktivës së Shërbimit Universal.</p>

Amendimet e propozuara në ligjin 9918 për komunikimet elektronike

Neni	Arsyeja	Teksti aktual	Teksti i propozuar	Shpjegim
		<p>kontratës së pajtimtarit dhe udhëzimet për mënyrën e veprimit për pranimin e kushteve të reja, shtyrjen ose përfundimin e kontratës;</p> <p>g) mundësinë që të dhënat e përdoruesit të mos publikohen në numërorin telefonik;</p> <p>gj) procedurat në rast të moskryerjes së pagesës apo të kryerjes me vonesë të pagesave për shërbimet.</p> <p>2. Në rast se ofruesit e shërbimeve publike të komunikimeve lidhin kontratë pajtimi me përdoruesit fundorë, këto kontrata duhet të përmbajnë elementet e përshkruara në pikën 1 të këtij neni.</p> <p>3. Pajtimtarët duhet të informohen për të gjitha modifikimet e propozuara në kushtet e kontratës së pajtimtarit, brenda një periudhe kohore jo më vonë se 30 ditë përpara datës së propozuar për hyrjen në fuqi të këtyre modifikimeve. Pajtimtari ka të drejtë ta anulojë kontratën pa njoftim dhe pa asnjë detyrim, në rast se nuk është dakord me modifikimin e kushteve.</p> <p>4. Shkelja e pikës 3 të këtij neni nga çdo sipërmarrës nuk do të heqë detyrimet që pajtimtarët kanë në bazë të kontratës së vjetër.</p> <p>5. Kontrata tip e pajtimtarit, që lidhet ndërmjet sipërmarrësit dhe pajtimtarit, mbështetet në parimin e barazisë së palëve. Ajo hartohet nga sipërmarrësi dhe miratohet nga AKEP-i.</p>	<p>rrjetit dhe si këto procedura mund të ndikojnë në cilësinë e shërbimit;</p> <p>v. çdo kufizim të vendosur nga ofruesi për përdorimin e pajisjeve fundore të ofruara;</p> <p>c) mundësitë e pajtimtarit për të përfshirë ose jo të dhënat e tij personale në numëror si dhe të dhënat në fjalë;</p> <p>ç) detaje për çmimet dhe tarifat, mënyrat me të cilat detajet të përditësuara për çmimet dhe tarifat dhe detyrimet për mirëmbajtje mund të përlogariten, metodat e ofruara të pagesës dhe çdo ndryshim në kosto për shkak të metodës së pagesës;</p> <p>d) kohëzgjatja e kontratës dhe kushteve për rinovimin dhe përfundimin e kontratës, duke përfshirë:</p> <p>i. çdo minimum i përdorimit ose kohëzgjatje e nevojshme për të përfituar nga kushtet e ofruara promovionale;</p> <p>ii. çdo detyrim lidhur me portabilitetin e numrit dhe tregues të tjerë;</p> <p>iii. çdo detyrim i papaguar me përfundimin e kontratës, duke përfshirë çdo rimbursim të kostonë në lidhje me pajisjet fundore;</p> <p>dh) çdo kompensim dhe marrëveshje për rimbursim që aplikohet nëse nuk është arritur niveli i cilësisë së shërbimit të kontraktuar;</p> <p>e) mënyra për fillimin e procedurave për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve;</p> <p>ë) lloji i kundërveprimit të ndërmarrë nga sipërmarrësi për shkak të incidenteve ndaj</p>	

Amendimet e propozuara në ligjin 9918 për komunikimet elektronike

Neni	Arsyeja	Teksti aktual	Teksti i propozuar	Shpjegim
			<p>sigurisë ose integritetit ose për shkak të kërcënimeve dhe cënimeve.</p> <p>2. Pajtimtarët kanë të drejtë të tërhiqen nga kontrata pa u gjobitur përkundrejt njoftimit ose modifikimit të kushteve kontraktore të propozuara nga sipërmarrësi që ofron rrjete të komunikimit elektronik dhe / ose shërbime. Pajtimtarët do të njoftohen me kohë, jo më pak se 30 ditë, për çdo modifikim dhe do të informohen në të njëjtën kohë për të drejtën e tyre për tu tërhequr pa u gjobitur nga kontrata, nëse ata nuk i pranjojnë kushtet e reja. AKEP mund të përcaktojë nëpërmjet një rregulloreje formatin e këtyre njoftimeve.</p> <p>3. Kontratat e lidhura midis konsumatorëve dhe sipërmarrësve që ofrojnë shërbime të komunikimeve elektronike nuk duhet të vendosin një periudhë fillestare të detyrueshme që tejkalon 24 muaj. Sipërmarrësit i ofrojnë përdoruesve mundësinë për lidhur kontratë me kohëzgjatje maksimale prej 12 muajve.</p> <p>4. Pa paragjykuar kohëzgjatjen minimale të kontratës, kushtet dhe procedurat për përfundimin e kontratës nuk do të veprojnë në mënyrë shkurajuese kundër ndryshimit të ofrusit të shërbimit.</p>	
102	BE 2009	<p>Neni 102</p> <p>Cilësia e shërbimit publik të komunikimeve</p> <p>1. Sipërmarrësit e rrjeteve dhe shërbimeve të</p>	<p>Neni 102</p> <p>Cilësia e shërbimit publik të komunikimeve</p> <p>1. Sipërmarrësit e rrjeteve dhe shërbimeve të</p>	<p>Amendimet e propozuara transpozojnë amendimet e nenit 22 të Direktivës së Shërbimit Universal.</p> <p>Vini re, se sipas <i>acquis</i> së BE operatorët do të</p>

Amendimet e propozuara në ligjin 9918 për komunikimet elektronike

Neni	Arsyeja	Teksti aktual	Teksti i propozuar	Shpjegim
		<p>komunikimeve elektronike publike janë të detyruar të publikojnë informacionin e duhur, të krahasueshëm dhe të përditësuar për cilësinë e shërbimeve të ofruara prej tyre.</p> <p>2. AKEP-i, në bazë të një rregulloreje të veçantë, përcakton treguesit e cilësisë së shërbimit.</p>	<p>komunikimeve elektronike publike janë të detyruar të publikojnë informacionin e duhur, të krahasueshëm dhe të përditësuar për cilësinë e shërbimeve të ofruara prej tyre dhe për masat e marra për të garantuar akses të barabartë për përdoruesit fundorë me aftësi të kufizuara.</p> <p>2. AKEP mund të përcaktojë me anë të një rregulloreje parametrat e cilësisë së shërbimit që do të maten si dhe përmbajtjen, formën dhe mënyrën e informacionit që do të publikohet, duke përfshirë mekanizma të mundshëm të çertifikimit në mënyrë që të garantohet se përdoruesit fundorë, duke përfshirë përdoruesit me aftësi të kufizuara, kanë akses në informacion gjithëpërfshirës, të krahasueshëm, të sigurt dhe lehtësisht të përdorshëm.</p>	<p>detyrohen vetëm të publikojnë informacion për cilësinë e shërbimit. Vetëm për ofruesit e caktuar të shërbimit universal rregullatori do të caktojë një minimum kërkesash.</p> <p>Shtojca III e Direktivës së Shërbimit Universal përmban një listë me parametra për cilësinë e shërbimit që mund të përdoret si bazë për rregulloren e referuar në pikën 2.</p>
102/1	BE 2009	(nuk ka nen. 102/1)	<p>Neni 102/1</p> <p>Garantimi i aksesit dhe zgjedhjeve të barabarta për përdoruesit me aftësi të kufizuara</p> <p>1. AKEP mund të përcaktojë nëpërmjet një rregulloreje kërkesat që duhet të plotësohen nga sipërmarrësit që ofrojnë shërbime të komunikimeve elektronike të vlefshme për publikun për të garantuar që përdoruesit me aftësi të kufizuara:</p> <p>a) kanë akses në shërbime të komunikimeve elektronike të barabartë me atë të përdorur nga shumica e përdoruesve</p>	<p>Neni I ri I propozuar 102/1 transpozon nenin 23a të Direktivës së Shërbimit Universal.</p>

Amendimet e propozuara në ligjin 9918 për komunikimet elektronike

Neni	Arsyeja	Teksti aktual	Teksti i propozuar	Shpjegim
			<p>fundorë; dhe</p> <p>b) përfitojnë nga zgjedhja e sipërmarrësve dhe shërbimeve në dispozicion të shumicës së përdoruesve fundorë.</p> <p>2. Në mënyrë që të miratojnë dhe implementojnë masat e veçanta për përdoruesit fundorë me aftësi të kufizuara, AKEP do të inkurajojë disponueshmërinë e pajisjeve fundore të cilat ofrojnë shërbimet dhe funksionet e nevojshme për këta përdorues.</p>	
103	redaksionale	<p>Neni 103</p> <p>Paraqitja e identifikimit të linjës thirrëse (CLI)</p> <p>1. Në rrjetet e komunikimeve elektronike publike, përdoruesit thirrës do t'i ofrohet, kur është, teknikisht dhe ekonomikisht, e mundshme dhe e justifikuar, që me kërkesën e tij dhe pa pagesë, të parandalojë shfaqjen e identifikimit të linjës thirrëse (CLI), sipas parimit thirrje-për-thirrje, duke përjashtuar, në çdo rast, thirrjet drejt numrave të emergjencës.</p> <p>2. Në rrjetet e komunikimeve elektronike publike, përdoruesit të thirrur, do t'i ofrohet, kur është teknikisht dhe ekonomikisht e mundshme dhe e justifikuar, që me kërkesën e tij dhe pa pagesë, të parandalojë shfaqjen e CLI-së të thirrjeve hyrëse. Kur identifikimi i thirrjes CLI është paraqitur përpara realizimit të thirrjes, pajtimtarit të thirrur do t'i ofrohet mundësia që, me kërkesën e tij dhe pa pagesë, të refuzojë thirrjet hyrëse, kur prezantimi i CLI-</p>	(hiqet)	<p>Nenet 103 dhe 125 të ligjit 9918 rregullojnë identifikimin e linjës thirrëse (CLI) dhe të dyja dispozitat transpozojnë nenin 8 të Direktivës së Privatësisë, por përmbajtja e ndryshme normative mund të çojë në keqkuptime. Neni 125 është më në përputhje me acquis dhe është e pozicionuar në kapitullin për mbrojtjen e të dhënave që është më e përshtatshme për rregullimin e kësaj çështjeje se sa kapitulli për mbrojtjen e konsumatorit. Prandaj propozohet të fshihet neni 103 dhe të mbahet neni 125.</p> <p>Trajtimi i CLI ndërmjet operatorëve ishte një çështje e kontestuar, por në të njëjtën kohë është rregulluar nga legjislacioni dytësor i AKEP. Nëse do të kishte nevojë të rregullohej kjo çështje në legjislacionin kryesor do të ishte më mirë që ai të rregullohej në nenin 47 (interkoneksioni) dhe jo në nenet 103 ose 125.</p>

Amendimet e propozuara në ligjin 9918 për komunikimet elektronike

Neni	Arsyeja	Teksti aktual	Teksti i propozuar	Shpjegim
		<p>së është parandaluar.</p> <p>3. Në rrjetet e komunikimeve elektronike publike, përdoruesit thirrës do t'i ofrohet mundësia që, me nismën e tij dhe pa pagesë, të parandalojë paraqitjen e numrit të përdoruesi i thirrur.</p> <p>4. Sipërmarrësi detyrohet të informojë për termat dhe kushtet për mundësinë e paraqitjes së identifikimit të linjës thirrëse, si edhe mundësitë e ndryshme, për të parandaluar paraqitjen e identifikimit të linjës thirrëse.</p> <p>5. Sipërmarrësit, që kanë vendosur marrëdhënie të drejtpërdrejta me sipërmarrës ndërkombëtarë, në marrëveshje me ata, janë të detyruar të përcaktojnë nëse do të zbatohen parashikimet e pikave 1, 2 e 3 të këtij neni, edhe për thirrjet e origjinuara jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, duke informuar, për këtë, edhe palët e tjera të interesuara.</p>		
104	BE 2002 dhe redaksionale	<p>Neni 104</p> <p>Numërori telefonik dhe informacioni për numrat</p> <p>1. Të gjithë pajtimtarët e shërbimeve telefonike publike kanë të drejtën të përfshihen në numërorin telefonik të përgjithshëm.</p> <p>2. Sipërmarrësit e rrjeteve dhe të shërbimeve të komunikimeve elektronike publike, që caktojnë numra për pajtimtarët e tyre, janë të detyruar të miratojnë të gjitha kërkesat e arsyeshme për ofrimin e numërorit dhe të rubrikës së shërbimeve të informacionit për numrat, duke</p>	<p>Neni 104</p> <p>Numërori telefonik dhe informacioni për numrat</p> <p>1. Të gjithë pajtimtarët e shërbimeve telefonike të vlefshme për publikun kanë të drejtën të përfshihen në Numërorin Telefonik të Përgjithshëm (të referuar në nenin 25 pika 1b).</p> <p>2. Sipërmarrësit që ofrojnë shërbime telefonike të vlefshme për publikun janë të detyruar:</p> <p>a) të informojnë të gjithë pajtimtarët, pa</p>	<p>Neni I propozuar 104 përmban dispozita, të cilat janë shpërndarë në nenet 104 deri në 130 në mënyrë që rregullat të jenë më të thjeshta për t'u kuptuar.</p> <p>Dispozitat e hartuara rishtazi parashikojnë, në përputhje me nenin 12 të Direktivës së Privatësisë, se pajtimtarët duhet të informohen për qëllimin e numërorit (pa pagesë), të kenë të drejtën të përfshihen (pa pagesë) dhe të kenë të drejtën të mos përfshihen (pa pagesë). Kjo korrigjon dispozitat në nenin aktual 130 sipas të cilit operatorët kanë të drejtën që të kërkojnë pagesa për “kostot reale” për t'i hequr të</p>

Amendimet e propozuara në ligjin 9918 për komunikimet elektronike

Neni	Arsyeja	Teksti aktual	Teksti i propozuar	Shpjegim
		<p>përfshirë të dhënat përkatëse për to, me tarifa të arsyeshme për publikun.</p> <p>3. Të gjithë përdoruesit fundorë të shërbimeve telefonike publike duhet të kenë akses në numërorin telefonik dhe në rubrikën e shërbimeve të informacionit.</p> <p>4. Pajtimtari ka të drejtë, që, me kërkesë paraprake, të paraqitur te sipërmarrësi, të përzgjedhë të dhënat që nuk dëshiron të përfshihen në numërorin telefonik ose në rubrikën e shërbimeve të informacionit.</p> <p>5. Sipërmarrësit janë të detyruar të sigurojnë konfidencialitetin e të dhënave të pajtimtarit, përfshirë ruajtjen, përdorimin dhe paraqitjen e të dhënave, në përputhje me këtë ligj dhe aktet e tjera ligjore në fuqi.</p>	<p>pagesë dhe para se ata të përfshihen në një numëror publik, për qëllimin e numërorit dhe funksionet disponueshme të kërkimit të informacionit.</p> <p>b) ti ofrojë të gjithë pajtimtarëve, pa pagesë, mundësinë për të vendosur nëse të dhënat e tyre personale mund të përfshihen në një numëror publik, për të përzgjedhur të dhënat që nuk dëshirojnë të përfshihen dhe mundësinë për të verifikuar dhe korrigjuar këto të dhëna;</p> <p>c) ti ofrojë të gjithë pajtimtarëve, pa pagesë, mundësinë e mospërfshirjes së të dhënave të tyre personale ose heqjes së të dhënave nga një numëror telefonik;</p> <p>3. Të gjithë përdoruesit fundorë të shërbimeve telefonike të vlefshme për publikun duhet të kenë akses në cilëndo rubrikë të shërbimeve të informacionit për numërorin telefonik.</p> <p>4. Sipërmarrësit janë të detyruar të sigurojnë konfidencialitetin e të dhënave të pajtimtarit, përfshirë ruajtjen, përdorimin dhe paraqitjen e të dhënave, në përputhje me këtë ligj dhe aktet e tjera ligjore në fuqi.</p>	<p>dhënat e pajtimtarëve nga numratori.</p> <p>Formulimi I ri ndryshon ndërmjet “numratorit publik” pasi mund të ketë numratorë të ndryshëm dhe “Numratori telefonik I detajuar” sipas nenit 25 pika 1b (shih më lart) I cili është gjithashtu “numerator publik”.</p> <p>Formulimi I ri I pikës 3 sqaron se të gjithë përdoruesit fundorë kanë të drejtën që të kenë akses në të gjitha shërbimet për rubrikën e marrjes së informacionit. Që do të thotë, një operator nuk ka të drejtën që të bllokojë thirrjet ndaj shërbimeve të tjera telefonike të marrjes së informacionit.</p>
106	BE 2002 dhe të tjera	<p>Neni 106</p> <p>Faturimi</p> <p>1. Sipërmarrësit janë të detyruar t’u ofrojnë pajtimtarëve të tyre, për shërbimet telefonike të vlefshme për publikun, faturë të detajuar, me qëllim që t’u mundësojë kontrollin mbi shumën</p>	<p>Neni 106</p> <p>Faturimi</p> <p>1. Sipërmarrësit janë të detyruar t’u ofrojnë pa pagesë pajtimtarëve të tyre, për shërbimet telefonike të vlefshme për publikun, faturë të detajuar, me qëllim që t’u mundësojë kontrollin</p>	<p>Amendimet e propozuara në nenin 106 do të transpozojnë nenin 7 në Direktivën e Privatësisë.</p> <p>Sipas Shtojcës I të Direktivës së Shërbimit Universal pajtimtarët kanë të drejtën të marrin fatura të detajuara (nëse pajtimtarët duan të kontrollojnë shpenzimet e tyre), dhe sipas nenit 7 të Direktivës të Privatësisë pajtimtarët</p>

Amendimet e propozuara në ligjin 9918 për komunikimet elektronike

Neni	Arsyeja	Teksti aktual	Teksti i propozuar	Shpjegim
		<p>e faturuar.</p> <p>2. Në faturën e përmendur në pikën 1 të këtij neni mund të mos përfshihen thirrjet drejt numrave pa pagesë dhe thirrjet drejt numrave të emergjencës.</p> <p>3. Fatura e detajuar për shërbimet telefonike publike duhet të përfshijë, minimalisht, elementet e mëposhtme:</p> <p>a) periudhën e faturimit;</p> <p>b) pagesën fikse mujore për shërbimin;</p> <p>c) llojin dhe shumën e të gjitha pagesave të tjera të mundshme për periudhën e faturimit;</p> <p>ç) numrat e thirrur, datën, orën, si dhe kohëzgjatjen e bisedave të kryera;</p> <p>d) pagesën përkatëse për çdo komunikim të kryer.</p>	<p>mbi shumën e faturuar. Pajtimtarët gjithashtu kanë të drejtë të marrin fatura jo të detajuara pa pagesë. Në të dy rastet, sipërmarrësi duhet të sigurojë dërgimin pa pagesë, të faturës së detajuar ose jo të detajuar, në adresën e pajtimtarit, kur ky opsion zgjidhet nga pajtimtari.</p> <p>2. (i pandryshuar)</p> <p>3. (i pandryshuar)</p>	<p>abonentët kanë të drejtën të mo smarrin fatura të detajuara (nëse pajtimtarët favorizojnë privatësinë ndaj kontrollimit të shpenzimeve. Amendimet e propozuara sqarojnë se të dyja janë pa pagesë.</p> <p>Nëse është e nevojshme, AKEP mund ta rregullojë këtë çështje në më shumë detaje në bazë të dispozitave të përgjithshme në nenin 15.</p>
107	të tjera	<p>Neni 107</p> <p>E drejta e kundërshtimit dhe ankimit</p> <p>1. Mënyra dhe procedura për ankesat e pajtimtarëve përcaktohen në kushtet e kontratës të pajtimtarit.</p> <p>2. Pajtimtarët kanë të drejtë të kundërshtojnë vendimet apo veprimet e sipërmarrësve për aksesin apo ofrimin e shërbimeve, kur ato bien ndesh me kushtet e kontratës.</p> <p>3. Kundërshtimet, sipas pikës 2 të këtij neni, duhet të bëhen me shkrim brenda 15 ditëve nga marrja e njoftimit të vendimit apo veprimit të kryer nga sipërmarrësi.</p> <p>4. Sipërmarrësi vendos për ankimin brenda 15</p>	<p>Neni 107</p> <p>Trajtimi i ankesave</p> <p>1. Mënyra dhe procedura për ankesat e pajtimtarëve përcaktohen në kushtet e kontratës të pajtimtarit.</p> <p>2. Pajtimtarët kanë të drejtë të drejtë të ankohen tek operatori që ofron shërbime të komunikimeve elektronike për shumën e faturuar dhe për cilësinë e shërbimit të ofruar.</p> <p>3. Aneksa e referuar në pikën 2 të këtij neni paraqitet me shkrim dhe duhet të përmbajë fakte dhe dëshmi mbi të cilat bazohet. Ankesa duhet të paraqitet:</p>	<p>Amendimet e propozuara do të përshkruajnë mekanizmin e shqyrtimit të ankesave të operatorëve më në detaje dhe të përcaktohet lidhja ndërmjet dispozitave të reja për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve në nenin 120/1 (shih më poshtë).</p> <p>Terminologjia e bën të qartë që ky nen përshkruan shqyrtimin e ankesave në një marrëdhënie kontraktore. Operatori nuk është një autoritet administrativ I cili lëshon “vendime” që mund të “apelohen”. Operatori i dërgon një faturë homologut të vet në një marrëdhënie kontraktore, pajtimtarit. Pajtimtari mund “të ankohet” dhe operatori do</p>

Amendimet e propozuara në ligjin 9918 për komunikimet elektronike

Neni	Arsyeja	Teksti aktual	Teksti i propozuar	Shpjegim
		<p>ditëve nga marrja e tij dhe njofton me shkrim pajtimtarin.</p> <p>5. Pajtimtarët kanë të drejtë që, në përputhje me përcaktimet në kontratë për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, të ankohen në gjykatë për vendimin e marrë nga sipërmarrësi, sipas pikës 4 të këtij neni. Ankimi bëhet sipas këtij ligji dhe akteve të tjera ligjore në fuqi.</p>	<p>a) brenda 30 ditëve pas datës së faturës për shërbimin e ofruar nëse ankesa i referohet shumës së faturuar për shërbimin e ofruar; ose</p> <p>b) brenda 30 ditëve nga ofrimi i shërbimit nëse ankesa i referohet cilësisë së shërbimit të ofruar.</p> <p>4. Pas marrjes së ankesës së referuar në pikën 2 të këtij neni, sipërmarrësi duhet të verifikojë shumën e faturuar për shërbimet e ofruara ose për cilësinë e shërbimeve të ofruara dhe pas verifikimit, të konfirmojë shumën e faturuar ose të korrigojë shumën. Sipërmarrësi i dorëzon pajtimtarit përgjigjen me shkrim jo më vonë se 30 ditë pas marrjes së ankesës nga pajtimtari.</p> <p>5. Nëse pajtimtari, i cili është një konsumator, nuk është dakord me përgjigjen me shkrim të sipërmarrësit, pajtimtari mund të fillojë një procedurë për zgjidhjen e mosmarrëveshjes sipas nenit 121/1.</p> <p>6. Çdo pajtimtar që nuk është dakord me përgjigjen me shkrim të sipërmarrësit mund të paraqesë rastin para gjykatës sipas Kodit të Procedurës Civile.</p>	<p>të merret me këtë ankesë.</p> <p>Dispozita përcakton afate kohore për abonentin dhe operatorin. Dispozita përcakton afate kohore për pajtimtarin dhe operatorin. Shih edhe dispozitën në nenin 109 pika 5, sipas së cilës operatori nuk mund të shkëputë një pajtimtar ndërsa trajtimi I ankesës është ende pezull.</p> <p>Pika 1: Është pajtimtari që mund të ankohet, dhe jo përdoruesi fundor. Pajtimtari përcaktohet si ai që ka një kontratë për shërbimin, ndërsa përdoruesi përcaktohet si ai që e përdor shërbimin.</p> <p>Pikat 2 dhe 3 përcaktojnë çështjet që mund të jenë objekt I një ankese dhe afate për paraqitjen e një ankese. Sigurisht që operatorët mund të parashikojnë procedura për shqyrtimin e ankesave që të jenë më favorizuese për konsumatorët.</p> <p>Pikat 5 dhe 6 përshkruajnë mundësitë pas marrjes së përgjigjes së operatorit. Pajtimtari mund të pranojë përgjigjen, të fillojë një procedurë për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve tek AKEP (vetëm nëse pajtimtari është një konsumator) ose të shkojë para gjykatës. Sigurisht, abonentin mund të zgjedhë të mos paguajë faturën e kontestuar dhe të presë nëse operatori ndërmerri hapa për të kryer pagesën. Operatori mund të shkëpusë shërbimin (neni</p>

Amendimet e propozuara në ligjin 9918 për komunikimet elektronike

Neni	Arsyeja	Teksti aktual	Teksti i propozuar	Shpjegim
				109) dhe/ose të shkojë në gjykatë.
109	të tjera	<p>Neni 109</p> <p>Ndërprerjet e shërbimit për pajtimtarin</p> <p>1. Sipërmarrësit që ofrojnë akses në rrjetet e komunikimeve elektronike publike mund ta kufizojnë aksesin në shërbimet e tyre dhe/ose mund ta ndërpresin lidhjen e pajtimtarit, apo mund të ndërpresin kontratën me pajtimtarin vetëm në rast se pajtimtari nuk përmbush kushtet e kontratës, apo nuk kryen pagesat, sipas kushteve të përcaktuara në kontratë.</p> <p>2. Sipërmarrësit duhet të përcaktojnë qartë dhe me detaje në kushtet e kontratës rastet kur bëhet kufizimi, ndërprerja e shërbimit apo ndërprerja e kontratës.</p> <p>3. Në rastet e mospërmbushjes së detyrimeve kontraktore nga pajtimtari, sipërmarrësit janë të detyruar t'i dërgojnë një njoftim, me shkrim, brenda një intervali të arsyeshëm kohor, me qëllim që pajtimtari të mund të plotësojë detyrimet kontraktore.</p> <p>4. Sipërmarrësit nuk janë të detyruar të njoftojnë paraprakisht pajtimtarët për masat e marra, në rast se shkelja e evidentuar e kontratës:</p> <p>a) shkakton një kërcënim serioz të rendit e sigurisë publike, shëndetit dhe mjedisit;</p> <p>b) shkakton një dëmtim serioz fizik, material ose funksional të rrjetit.</p> <p>5. Nëse pajtimtari kundërshton shumë e faturuar, sipërmarrësi mund të mos veprojë</p>	<p>Neni 109</p> <p>Ndërprerjet e shërbimit për pajtimtarin</p> <p>1. (i pandryshuar)</p> <p>2. (i pandryshuar)</p> <p>3. Për kontratat post-paid sipërmarrësi është i detyruar ti dërgojë pajtimtarit faturën. Nëse pajtimtari nuk përmbush detyrimet kontraktore brenda afatit kohor të përcaktuar në faturë, sipërmarrësi është i detyruar t'i dërgojë pajtimtarit një njoftim me shkrim që vendos afatin kohor prej jo më pak se 15 ditëve për të përmbushur detyrimet kontraktore. Ky njoftim me shkrim duhet të informojë pajtimtarin për kushtet përkatëse kontraktore, në veçanti për kufizimin, ndërprerjen e shërbimit apo ndërprerjen e kontratës dhe procedurat për zgjidhjen e mosmarrëveshjes. Sipërmarrësit mund të mos veprojnë në përputhje me pikën 1 të këtij neni para afatit kohor të përcaktuar në njoftimin me shkrim.</p> <p>4. (i pandryshuar)</p> <p>5. Nëse një pajtimtar paraqet një ankesë sipas nenit 107 të këtij ligji, por i ka përmbushur të gjitha detyrimet kontraktore të cialt nuk janë subjekt i ankesës, sipërmarrësi mund të mos veprojë në përputhje me pikën 1 të këtij neni deri sa procedura për trajtimin e ankesave e përshkruar në nenin 107 të jetë kompletuar.</p>	<p>Amendimi I propozuar në pikën 3 sqaron se në një kontratë sipërmarrësi duhet të dërgojë fatura dhe se detyrimi kontraktor për të paguar nuk mund të fillojë para se sipërmarrësi të ketë dërguar faturën.</p> <p>Dispozita nuk e detyron sipërmarrësin që të dërgojë faturat me postë të regjistruar. Prandaj është e mundur që faturat të humbasin gjatë rrugës për te pajtimtari.</p> <p>Në mënyrë që të mbrohen pajtimtarët në situata të tilla, dispozita parashikon (në përputhje me rregullin në fuqi në variantin aktual të nenit 109) se sipërmarrësi duhet të dërgojë një njoftim në formë të shkruar. Teksti I ri I propozuar sqaron se njoftimi duhet ta informojë pajtimtarin ashtu sic duhet, në veçanti për pasojat e mundshme të shkeputjes ose të përfundimit të kontratës.</p> <p>Formulimi I ri I propozuar I pikës 5 përshkruan lidhjen ndërmjet procedurës së trajtimit të ankesave dhe procedurës në nenin 7. Nëse një pajtimtar ankohet për një faturë të caktuar, por paguan të gjitha faturat e tjera (ose: nëse një pajtimtar ankohet për një pjesë të faturës por paguan për pjesën e pakontestuar) operatori nuk duhet të bëjë shkeputjen e pajtimtarit deri sa të jetë zgjidhur ankesa.</p>

Amendimet e propozuara në ligjin 9918 për komunikimet elektronike

Neni	Arsyeja	Teksti aktual	Teksti i propozuar	Shpjegim
		<p>sipas pikës 1 të këtij neni, deri në arritjen e një vendimi përfundimtar, kur pajtimtari do të jetë i detyruar të paguajë brenda një afati të caktuar kohor.</p> <p>6. Nëse është teknikisht e mundur, operatorët janë të detyruar të kufizojnë aksesin vetëm për ato shërbime që pajtimtari ka shkëlur kushtet e kontratës, përveç rasteve kur pajtimtari abuzon, ose, në mënyrë të përsëritur, kryen me vonesë ose nuk paguan faturat.</p> <p>7. Sipërmarrësve u ndalohet të kufizojnë aksesin për përdorimin e numrave të emergjencës.</p>	<p>6. (i pandryshuar)</p> <p>7. (i pandryshuar)</p>	
110	BE 2002 dhe BE 2009	<p>Neni 110 Këshillimi publik</p> <p>1. AKEP-i, në procesin e përgatitjes së dokumenteve rregullatore për tregun e komunikimeve elektronike dhe përpara marrjes së vendimeve, të cilat kanë një ndikim të ndjeshëm në tregun e komunikimeve elektronike, është i detyruar të marrë dhe të vlerësojë mendimin e palëve të interesuara nëpërmjet këshillimit publik.</p> <p>2. Në procesin e këshillimit publik, AKEP-i publikon dokumentet rregullatore të propozuara dhe kërkon paraqitjen me shkrim të mendimit të palëve të interesuara, brenda një afati kohor të publikuar, i cili nuk duhet të jetë më pak se 30 ditë.</p> <p>3. Në rast se AKEP-i e gjykon të nevojshme, kryen edhe seancë dëgjimore, ku ftohen palët e</p>	<p>Neni 110 Këshillimi publik</p> <p>1. AKEP-i, në procesin e përgatitjes së dokumenteve rregullatore për tregun e komunikimeve elektronike dhe përpara marrjes së vendimeve, të cilat kanë një ndikim të ndjeshëm në tregun e komunikimeve elektronike ose që kanë lidhje me të drejtat e përdoruesve fundorë, në veçanti konsumatorët me aftësi të kufizuara, është i detyruar të marrë dhe të vlerësojë mendimin e palëve të interesuara nëpërmjet këshillimit publik.</p> <p>2. Në procesin e këshillimit publik, AKEP-i publikon dokumentet rregullatore të propozuara në faqen e tij të internetit dhe kërkon paraqitjen me postë elektronike (e-mail) të mendimit të palëve të interesuara,</p>	<p>Ndonëse dispozitat për këshillimet publike janë në përgjithësi të transpozuar në nenin 110 të ligjit 9918, ne propozojmë të diskutohet që të përfshihet interesi I përdoruesve fundorë, në veçanti interesat e përdoruesve me aftësi të kufizuara në mënyrë më të qartë. Neni 110 është hartuar në bazë të Direktivës Kuadër dhe mund të reflektojë dispozitat e nenit 33 të Direktivës së Shërbimit Universal më me forcë.</p> <p>Amendimet në pikën 2 lejojnë që këshillimi publik të kryhet pa komunikim të shkruar. AKEP do të publikojë dokumentin e këshillimit në faqen e tij të internetit, do të njoftojë palët e mundshme të interesuara me e-mail dhe do të marrë përgjigjet me e-mail.</p>

Amendimet e propozuara në ligjin 9918 për komunikimet elektronike

Neni	Arsyeja	Teksti aktual	Teksti i propozuar	Shpjegim
		<p>interesuara për të parashtruar mendimin për dokumentet rregullatore të propozuara.</p> <p>4. Pas përfundimit të afatit të përcaktuar në pikën 2 të këtij neni dhe para miratimit të dokumenteve rregullatore, AKEP-i duhet të publikojë mendimet dhe komentet e palëve të interesuara, duke respektuar konfidencialitetin e informacionit.</p>	<p>brenda një afati kohor të publikuar, i cili nuk duhet të jetë më pak se 30 ditë.</p> <p>3. (i pandryshuar)</p> <p>4. (i pandryshuar)</p>	
114	të tjera	<p>Neni 114</p> <p>Statusi dhe Këshilli Drejtues i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare</p> <p>...</p> <p>3. Këshilli Drejtues përbëhet nga 5 anëtarë, të cilët zgjidhen nga Kuvendi, me propozimin e Këshillit të Ministrave, për një periudhë 5-vjeçare, me të drejtë rizgjedhjeje jo më shumë se 1 herë. Kuvendi cakton kryetarin, ndërmjet anëtarëve të Këshillit Drejtues. Kryetari i Këshillit Drejtues është drejtuesi ekzekutiv i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare.</p> <p>...</p>	<p>Neni 114</p> <p>Statusi dhe Këshilli Drejtues i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare</p> <p>1. dhe 2. të pandryshuara</p> <p>3. Këshilli Drejtues përbëhet nga 5 anëtarë, të cilët zgjidhen nga Kuvendi, me propozimin e Këshillit të Ministrave, për një periudhë 5-vjeçare dhe për jo më shumë se dy mandate të njëpasnjëshme. Kuvendi cakton kryetarin, ndërmjet anëtarëve të Këshillit Drejtues. (hiqet fjalia e fundit e pikës tre)</p> <p>3a. Pavarësisht nga parimi i përcaktuar në pikën 3 të këtij neni, Kuvendi në vendimin për emërimin tjetër të anëtarëve të Këshillit Drejtues emron Kryetarin për një periudhë 5-vjeçare, dy prej anëtarëve për një periudhë 4-vjeçare dhe dy anëtarët e tjerë për një periudhë tre vjeçare.</p> <p>4. deri 6. të pandryshuara</p>	<p>Ne sugjerojmë të fshihet fjalia e fundit e pikës 3, sipas së cilës Kryetari i Këshillit Drejtues automatikisht merr pozicionin e Drejtorit Ekzekutiv. Zgjidhja aktuale nuk është optimale, pasi kërkon që I njëjti person të funksionojë në dy role të ndryshme, në njërin rol është në krye të këshillit dhe në tjetrin është në varësi të këshillit.</p> <p>Amendimet në pikën 3 dhe pikën 3a parashikojnë prezantimin e mandateve të anëtarëve të Këshillit Drejtues që mbivendosen, në bazë të ligjit Maqedonas. Kjo con në një ruajtje më të mirë të njohurive institucionale, anëtarët e Këshillit drejtues nuk do të ndërrohen të gjithë në të njëjtën kohë. Për të njëjtën arsye amendimet lejojnë dhe mandate të njëpasnjëshme.</p> <p>Sidoqoftë, meqë anëtarët aktualë të Këshillit Drejtues janë emëruar në 26 Nëntor 2009 për një periudhë 5-vjeçare, kjo mund të bëhet vetëm pasi të kenë përfunduar mandatet aktuale.</p>
115	të tjera	<p>Neni 115</p> <p>Marrja e vendimeve dhe struktura e Këshillit</p>	<p>Neni 115</p> <p>Marrja e vendimve dhe Struktura e Këshillit</p>	<p>Sipas ligjit aktual AKEP ka nevojën e miratimit të parlamentit për cdo ndryshim të strukturës së</p>

Amendimet e propozuara në ligjin 9918 për komunikimet elektronike

Neni	Arsyeja	Teksti aktual	Teksti i propozuar	Shpjegim
		<p>Drejtues</p> <p>1. Këshilli Drejtues merr vendimet me shumicë votash, kur janë të pranishëm të paktën tre anëtarë. Secili anëtar, duke përfshirë edhe kryetarin, ka të drejtën e një vote. Asnjë vend bosh në Këshillin Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare nuk cenon të drejtën e anëtarëve që mbeten, për të ushtruar të gjitha të drejtat e Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare.</p> <p>2. Në procesin e votimit nuk marrin pjesë anëtarët e Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare, kur vërtetohet njëri nga rastet e parashikuara në nenin 37 të Kodit të Procedurës Administrative.</p> <p>3. Pagat e anëtarëve të Këshillit Drejtues caktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.</p> <p>4. Struktura organizative, numri dhe pagat e punonjësve të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare përcaktohen, sipas legjisllacionit në fuqi.</p> <p>5. Këshilli Drejtues vendos rregullat dhe kriteret e punësimit, sipas ligjeve në fuqi.</p>	<p>Drejtues</p> <p>1. deri në 3. (të pandryshuara)</p> <p>4. Struktura organizative, numri, paga dhe shpërblimet e personelit të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare propozohen nga Drejtori Ekzekutiv dhe miratohen nga Këshilli Drejtues i AKEP-it.</p> <p>5. (i pandryshuar)</p> <p>6. Kundër vendimeve të AKEP-it mund të bëhet ankim pranë gjykatës kompetente brenda 30 ditëve që nga shpallja ose njoftimi I vendimit të AKEP-it.</p>	<p>tij organizative ose të numrit të personelit, si krijimin e një drejtorie të mbrojtjes së konsumatorit (që do të kërkohet nga neni i ri 120/1) ose punësimi i specialistëve të rinj.</p> <p>Në ndryshim nga institucione të tjera të rregulluara nga ligji 9584, i cili e kërkon një kontroll të tillë direkt nga parlamenti, AKEP ka buxhetin e vet. Nenet 24, 78, 86 dhe 117 të këtij ligji e detyrojnë AKEP-in që të paraqesë buxhetin si dhe tarifat e strukturës në këshillim publik për ata që paguajnë për të, dhe të raportojë në parlament. Këto mekanizma garantojnë që AKEP të përdorë burimet buxhetore me përpikmërinë e nevojshme.</p> <p>Propozohet që Këshillit Drejtues të AKEP-it t'i jepet kompetenca për të vendosur për strukturën organizative, numrin dhe shpërblimin e personelit, me propozim të Drejtorit Ekzekutiv, sic parashikohet në nenin 85 të ligjit 8618 për telekomunikacionet.</p> <p>Pika 6 sqaron se të gjitha vendimet e AKEP-it mund të apelojnë tek gjykata kompetente. Pjesërisht ky zëvendëson nenin e mëparshëm 136.</p>
116	BE 2009	<p>Neni 116</p> <p>Lirimi dhe shkarkimi i anëtarëve të Këshillit Drejtues</p> <p>1. Anëtari i Këshillit Drejtues lirohet ose shkarkohet nga organi që e ka zgjedhur kur:</p> <p>a) është në pamundësi fizike dhe mendore, për</p>	<p>Neni 116</p> <p>Lirimi dhe shkarkimi i anëtarëve të Këshillit Drejtues</p> <p>1. deri 2. të pandryshuara</p> <p>3. Çdo anëtar i shkarkuar nga detyra nuk ka të</p>	<p>Ne propozojmë të sqarohet në nenin 116 pika 3 se vetëm anëtarët e shkarkuar të Këshillit Drejtues nuk mund të emërohen sërish, kurse anëtarët e tjerë të cilët janë liruar (për shembull me kërkesën e tyre ose për shkak të paftësisë fizike të përkohshme) mund të riemërohen.</p> <p>Pika e propozuar 4 transpozon nenin 3</p>

Amendimet e propozuara në ligjin 9918 për komunikimet elektronike

Neni	Arsyeja	Teksti aktual	Teksti i propozuar	Shpjegim
		<p>të kryer funksionet e ngarkuara;</p> <p>b) gjatë ushtrimit të detyrës, është dënuar nga gjykata, për kryerjen e një vepre penale me vendim të formës së prerë;</p> <p>c) zgjidhet ose kandidon si deputet i Kuvendit ose në organet e pushtetit vendor, me përjashtim të rastit kur është anëtar i shoqatave profesionale dhe mban funksione në to;</p> <p>ç) pa shkak të arsyeshëm, nuk ka pranuar të kryejë ose nuk kryen detyrën ose është i paaftë për të ushtruar detyrën për një periudhë 6-mujore ose më shumë;</p> <p>d) përfshihet në ndonjërin nga dispozitat e nenit 114 pika 6 të këtij ligji;</p> <p>dh) vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji.</p> <p>2. Kur një anëtar lirohet ose shkarkohet nga detyra, sipas pikës 1 të këtij neni, anëtari i ri emërohet nga organi përkatës, sipas nenit 114 të këtij ligji.</p> <p>3. Çdo anëtar i liruar ose i shkarkuar nga detyra nuk ka të drejtë të rizgjidhet në Këshillin Drejtues.</p>	<p>drejtë të rizgjidhet në Këshillin Drejtues.</p> <p>4. Para se të lirohet ose shkarkohet një anëtar i Këshillit Drejtues, atij i jepet mundësia për të mbrojtur veten. Vendimi për të liruar ose shkarkuar një anëtar duhet të përmbajë një deklaratë për arësyet e lirimit ose shkarkimit dhe duhet të publikohet kur bëhet lirimi ose shkarkimi.</p>	<p>paragrafi 3a të Direktivës Kuadër, që kërkon që vendimi të publikohet dhe të përmbajë një deklaram të arsyeve. Pika e re sqaron se personi I larguar nga puna duhet të dëgjohet para largimit.</p>
116/1	të tjera		<p>Neni 116/1</p> <p>Drejtori Ekzekutiv</p> <p>1. Drejtori Ekzekutiv drejton të gjithë veprimtarinë administrative të AKEP-it. Ai përfaqëson agjensinë në marrëdhëniet me të tretet dhe homologet jashtë vendit.</p> <p>Ai ka të drejtë të marrë pjesë në të gjitha mbledhjet e Këshillit Drejtues por nuk ka të</p>	<p>Shih shpjegimet në hyrjen e këtij dokumenti.</p> <p>Nevoja për një forcim të kapaciteteve ekzekutive të AKEP, ka qenë tepër e evidentë në të gjithë. Mungesa e pozicionit të Drejtorit ekzekutiv, ka sjelle krizë në funksionimin e organizatës dhe bllokim të shpeshtë të vendimmarrjes së Këshillit Drejtues. Vendosija e Drejtorit Ekzekutiv me kompetencat e detyra të qarta synon të bëjë organizatën efiçente dhe të</p>

Amendimet e propozuara në ligjin 9918 për komunikimet elektronike

Neni	Arsyeja	Teksti aktual	Teksti i propozuar	Shpjegim
			<p>drejten e votes. Drejtori Ekzekutiv 1/1. Vendos për strukturat drejtuese dhe bën emërimet kyce si dhe ato te inspektoreve 1/2 Zbaton kontrata në emër të Agjencisë; 1/3 Nxjerr vendime mbi çështjet për të cilat nuk jane kompetence e Keshillit Drejtues 1/4. Pergatit te gjitha aktet qe aprovohen nga Keshilli Drejtues. 1/5. Nxjerr akte per zbatimin e ketij ligji 1/6. Deleton detyra brenda fushes se juridiksionit te tij 1/7. Kryen aktivitete te tjera te parashikuara ne kete ligj dhe ne statutin e AKEP</p> <p>1/8. Në lidhje me menaxhimin e punës se AKEP-it Drejtori Ekzekutiv :</p> <p>a. menaxhon punën e AKEP-it; u cakton punën drejtorive të ndryshme dhe e koordinon atë; motivon stafin dhe është përgjegjës para Këshillit Drejtues të për zbatimin e planit të punës së AKEP-it;</p> <p>b. garanton se buxheti I AKEP-it, strategjia e burimeve njerëzore (duke përfshirë strukturën, personelin dhe kategorizimin e punonjësve)programet e veprimtarive tremujore dhe vjetore,planet mujore të punës, programet e trajnimit, rregullat e etikës, rregulloret e brendshme, raportet</p>	<p>afte ti pergjigjet realizimit te nevojave qe paraqet tregu nga njera ane dhe objektivave e strategjive politike te qeverise nga ana tjeter.</p>

Amendimet e propozuara në ligjin 9918 për komunikimet elektronike

Neni	Arsyeja	Teksti aktual	Teksti i propozuar	Shpjegim
			<p>vjetore dhe llogaritë e përgatitura, të zbatuara dhe të raportuara sipas vendimeve të Këshillit Drejtues;</p> <p>c. me marrëveshjen e Këshillit Drejtues, emëron një prej drejtorëve të drejtorive dhe një tjetër të veprorë si Drejtor Ekzekutiv në mungesë të tij;</p> <p>d. në lidhje me mbështetjen për Këshillin Drejtues:</p> <p>e. garanton që kushtet e nevojshme (duke përfshirë përgatitjen në kohë të materialit në lidhje me elementët e axhendës dhe transkriptimin në kohë të vendimeve për këshillim public) për këshillin drejtues për kryerjen e veprimtarive kolegjiale dhe individuale;</p> <p>f. emëron dhe shkarkon stafin mbështetës të kabinetit në përputhje me legjislacionin në fuqi;</p> <p>g. plotëson detyra të tjera administrative të vendosura nga Këshilli Drejtues dhe është përgjegjës për zbatimin e tyre;</p> <p>II. Në lidhje me kontratat, prokurimet dhe korrespondencën:</p> <p>a. Nese e gjykon te nevojshme I paraqet propozime Këshillit Drejtues në lidhje me delegimin e veprimeve administrative dhe shpenzimeve individëve të ndryshëm (duke përfshirë edhe veten e tij/saj) kontrollet e përshtatshme për të garantuar mbarëvajtjen;</p> <p>b. I paraqet propozime Këshillit Drejtues për procedurat e regjistrimit/arkivimit dhe</p>	

Amendimet e propozuara në ligjin 9918 për komunikimet elektronike

Neni	Arsyeja	Teksti aktual	Teksti i propozuar	Shpjegim
			<p>përpunimit të dokumenteve dhe ofrimin e informacionit zyrtar.</p>	
116/ 1.1			<p>2. Drejtori Ekzekutiv emërohet nga Ministri i linjes me anë të një konkurrimi publik, për një periudhë prej pesë vjetësh me mundësi riemërimi. Ai / ajo duhet të jetë shtetas i Republikës së Shqipërisë dhe një mbajtës i diplomë universitare në fushën e shkencës, të ligjit apo ekonomi, me përvojë profesionale e më shumë se 5 vjet dhe me përvojë e aftësi organizative dhe drejtuese. Ai/ajo emërohet për një periudhë 4 vjeçare me mundësi riemërimi.</p> <p>4. Drejtori Ekzekutiv heq dorë nga cdo pozicion ose funksion zyrtar, veprimtari fitimprurëse, shet dhe likuidon cdo interes financiar që mund të ketë në shoqëritë që ushtrojnë veprimtari tregtare në juridiksionin e Autoritetit të Komunikimeve elektronike dhe Postare. Dispozitat e nenit 114 pika 6 do të gjejnë zbatim mutatis mutandis për Sekretarin e Përgjithshëm.</p> <p>5. Drejtori Ekzekutiv përgjigjet për punën e tij para AKEP-it.</p> <p>6. Drejtori Ekzekutiv kryen detyrat e tij/saj në mënyrë profesionale si nëpunës I AKEP-it, me kohe të plote. Shpërblimi i Drejtorit Ekzekutiv caktohet me vendim të Këshillit Drejtues. Drejtori Ekzekutiv lidh një kontratë punësimi me Kryetarin e Këshillit Drejtues.</p> <p>7. Këshilli I AKEP-it i propozon Ministrit të linjes shkarkimin ose lirimin nga detyra</p>	

Amendimet e propozuara në ligjin 9918 për komunikimet elektronike

Neni	Arsyeja	Teksti aktual	Teksti i propozuar	Shpjegim
			<p>Drejtorin Ekzekutiv nëse ai/ajo:</p> <p>a) është fizikisht ose mendërisht i/e paaftë për të kryer detyrat e caktuara;</p> <p>b) është shpallur fajtor për një krim me një vendim gjyqësor të formës së prerë gjatë ushtrimit të detyrave;</p> <p>c) caktohet ose kandidon për anëtar të Kuvendit në Republikën e Shqipërisë ose në organet e pushtetit vendor, përjashtuar rastet kur ai/ajo është anëtar i organizatave profesionale dhe ka detyra në to;</p> <p>ç) ka refuzuar ose nuk I kryen detyrat pa shkak, ose nuk është I aftë të ushtrojë detyrat e tij/saj për 6 muaj ose më shumë;</p> <p>d) përfshihet në ndonjë prej dispozitave të nenit 114 pika 6 e këtij ligji;</p> <p>dh) vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji.</p> <p>8. Drejtori kundër të cilit ka filluar procedura për shkarkim do të informohet paraprakisht dhe do të kenë të drejtën e mbrojtjes para Këshillit Drejtues.</p>	
116/2	të tjera		<p>Neni 116/2</p> <p>Kompetencat e Këshillit Drejtues</p> <p>Për ushtrimin e funksioneve të tij ligjore dhe përgjegjësive si një organ kolegjal drejtues, Këshilli Drejtues ka kompetencat e mëposhtme:</p> <p>1. Në lidhje me planifikimin strategjik:</p> <p>a. miraton deklaratën e misionit të organizatës;</p>	Shih shpjegimet në hyrjen e dokumentit

Amendimet e propozuara në ligjin 9918 për komunikimet elektronike

Neni	Arsyeja	Teksti aktual	Teksti i propozuar	Shpjegim
			<p>b. garanton që të hartohen objektiva rregullatore, strategji dhe politika për AKEP-in, në përputhje me këtë ligj dhe me Politikën e Këshillit të Ministrave për zhvillimin e sektorit;</p> <p>c. garanton që të hartohen plane dhe të arrihen objektivat në përputhje me strategjitë dhe politikat;</p> <p>d. garanton që të zbatohen në kohë dhe sipas kostos planet (duke përfshirë ato që kanë të bëjnë me personelin dhe trajnimet);</p> <p>e. miraton Buxhetin, Raportin vjetor dhe Planet Vjetore.</p> <p>II. Në lidhje me kontrollin e organizatës</p> <p>a. vendos për objektivat, strategjitë dhe politikat afatgjata, duke përfshirë bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar;</p> <p>c. vendos për rregulloren e brendshme të funksionimit të AKEP-it dhe e rishikon rregullisht atë;</p> <p>d. vlerëson veprimet dhe progresin e bërë sipas planeve dhe garanton që të kryhen veprimet e duhura sipas nevojës.</p>	
116/3	të tjera		<p>Neni 116/3</p> <p>Kompetencat e kryetari të Këshillit Drejtues</p> <p>Kompetencat e kryetarit të Këshillit Drejtues janë:</p> <p>I. Në lidhje me drejtimin e përgjithshëm të AKEP-it:</p>	Shih shpjegimet në hyrjen e dokumentit

Amendimet e propozuara në ligjin 9918 për komunikimet elektronike

Neni	Arsyeja	Teksti aktual	Teksti i propozuar	Shpjegim
			<p>a. garanton që Këshilli drejtues të kryejë planifikimin strategjik, kontrollin e organizatës dhe delegimin e funksioneve në mënyrë të efektshme;</p> <p>b.garanton që Këshilli Drejtues të marrë vendimet ligjore që I përkasin brenda afateve kohore të parashikuara në legjislacionin përkatës;</p> <p>c. I raporton kuvendit veprimtaritë vjetore të AKEP-it.</p> <p>II. Në lidhje me menaxhimin e biznesit të Këshillit Drejtues:</p> <p>a. koordinon dhe monitoron zbatimin e detyrave të caktuara anëtarëve individualë të Këshillit Drejtues;</p> <p>b. garanton që AKEP të të prezantohet ashtu sic duhet në marrëdhëniet me institucionet e tjera, kombëtare dhe ndërkombëtare, nga ai/ajo vetë ose nëpërmjet delegimit tek një anëtar tjetër I Këshillit Drejtues, nënshkruan marrëveshje të miratuara nga Këshillit Drejtues;</p> <p>c. emëron kryetarin e seancës në rast shqyrtimi të mosmarrëveshjeve ndërmjet sipërmarrësve sipas këtij ligji dhe seancat dëgjimore sipas ligjit nr. 8485;</p> <p>d. miraton pushimet vjetore të anëtarëve të Këshillit Drejtues;</p> <p>III. Në lidhje me mbledhjet e Këshillit Drejtues;</p> <p>a. Planifikon, thërret dhe drejton mbledhjet; shtyn ose anulon takimet kur është e nevojshme , nënshkruan procesverbalet e</p>	

Amendimet e propozuara në ligjin 9918 për komunikimet elektronike

Neni	Arsyeja	Teksti aktual	Teksti i propozuar	Shpjegim
			mbledhjeve dhe ekstraktet e vendimeve të marra nga Këshilli Drejtues; b. I propozon Këshillit Drejtues emërimet dhe shkarkimet e sekretarit të Këshillit Drejtues, me kërkesë të jo më pak se tre anëtarëve të Këshillit Drejtues.	
			Kjo nen bie, se kompetencat e paraqitura ketu kalojne ne 116/1, nenpika1/8	
117	BE 2002	Neni 117 Financimi dhe buxheti i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare 1. Burimet e financimit të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare janë pagesat, sipas përcaktimeve në nenet 24 dhe 119 të këtij ligji dhe akteve të tjera ligjore në fuqi. 2. Jo më vonë se gjashtë muaj para fillimit të çdo viti financiar, Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare cakton një fond të shpenzimeve administrative, të parashikuara, të cilin e paraqet për miratim në Këshillin e Ministrave. 3. Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare mban llogari të plota dhe të sakta të shpenzimeve faktike, në përputhje me legjislacionin shqiptar të kontabilitetit. 4. Të gjitha të ardhurat e tepërta shpenzimet e Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare kalojnë në Buxhetin e Shtetit.	Neni 117 Financimi dhe buxheti i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare 1. Burimet e financimit të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare janë pagesat, sipas përcaktimeve në nenet 24 dhe 78 të këtij ligji. 2. Jo më vonë se gjashtë muaj para fillimit të çdo viti financiar, Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare cakton një fond të shpenzimeve administrative, të parashikuara, të cilin e paraqet për miratim në Këshillin e Ministrave. 3. Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare mban llogari të plota dhe të sakta të shpenzimeve faktike, në përputhje me legjislacionin shqiptar të kontabilitetit. 4. Të gjitha të ardhurat e tepërta që tejkalojnë shpenzimet e Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare, kalojnë në buxhetin e autoritetit në vitin pasardhës.	Neni 12 I direktivës së autorizimit kërkon që pagesat administrative të bazohen vetëm në kostot administrative. Amendimet e propozuara për nenet 24 dhe 78 parashikojnë që të dy tipet e pagesave të AKEP-it do të bazohen në kostot administrative. Një amendim I nenit 30 sqaron se shërbimi universal mbahet I vecuar nga buxheti I AKEP. Nëse pagesat e bazuara në nenet 24 dhe 78 mbështeten në kostot administrative, nuk duhet të ketë ndonjë shtesë apo deficit të madh në fund të vitit. Sidoqoftë shtesa apo deficit nuk duhet të paguhet për apo nga buxheti I shtetit, por duhet të kalohen te buxheti I AKEP për vitin tjetër.

Amendimet e propozuara në ligjin 9918 për komunikimet elektronike

Neni	Arsyeja	Teksti aktual	Teksti i propozuar	Shpjegim
119	BE 2002	<p>Neni 119</p> <p>Pagesat</p> <p>1. Pagesat, që kryhen në AKEP, janë:</p> <p>a) pagesa për mbikëqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike, sipas përcaktimeve në nenin 24 të këtij ligji;</p> <p>b) pagesa për financimin e shërbimit universal, sipas përcaktimeve në nenin 30 të këtij ligji;</p> <p>c) pagesa për caktimin dhe përdorimin e frekuencave, sipas përcaktimeve në nenin 78 të këtij ligji;</p> <p>ç) pagesa për caktimin dhe përdorimin e numrave dhe të serive numerike, sipas përcaktimeve në nenin 86 të këtij ligji.</p> <p>2. Përcaktimi i pagesave për caktimin dhe përdorimin e frekuencave dhe numrave, të përcaktuara në shkronjat “c” dhe “ç” të pikës 1 të këtij neni, miratohen nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e AKEP-it.</p>	(hiqet)	<p>Pas amendimeve në nenet 24, 78, 86 dhe 117 më lart, neni 119 nuk është më I nevojshëm.</p> <p>Pika 1 e variantit aktual të këtij neni nuk ka një përmbajtje normative, por është vetëm një përmbledhje e detyrimeve në nenet e tjera.</p> <p>Pika 2 aktualisht parashikon qe pagesat për frekuencat dhe numrat nuk specifikohen nga AKEP por nga Këshilli I Ministrave. Propozohet që të fshihen pagesat e ndara për administrimin e numrave dhe të mbulohen kostot administrative të administrimit të numrave nga pagesat sipas nenit 24 (shih më lart).</p> <p>Në lidhje me pagesat për menaxhimin e frekuencave pagesat aktuale janë mjaft mbi kostot administrative të AKEP (sipas nenit 117 pika 4 e ligjit) një pjesë e të cilave shkon për buxhetin e shtetit. Prandaj ligji aktual parashikon se këto pagesa kanë nevojë për miratimin e Këshillit të Ministrave.</p> <p>Në të ardhmen pagesat administrative (neni 24 dhe 78) do të bazohen ngushtësisht mbi kostot administrative. Meqë buxheti I AKEP duhet të miratohet nga Këshilli I Ministrave (neni 117 pika 2) nuk ka nevojë që Këshilli I Ministrave të miratojë edhe detajet e pagesave administrative për frekuencat.</p>

Amendimet e propozuara në ligjin 9918 për komunikimet elektronike

Neni	Arsyeja	Teksti aktual	Teksti i propozuar	Shpjegim
				Mund të diskutohet nëse Këshilli I Ministrave në të ardhmen duhet të vendosë për taksat mbi radiofrekuencat që shkojnë tek buxheti I shtetit. Këto taksa aktualisht janë bazuar në një udhëzim të përbashkët të Ministrit të financave dhe AKEP.
120	redaksionale	Neni 120 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve ...	Neni 120 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve ndërmjet sipërmarrësve (teksti i pandryshuar)	Titulli I ri do të marrë parasysh dallimin ndërmjet nenit 120 dhe nenit 120/1 (shih më poshtë).
120/ 1	BE 2002	(no article 120/1)	Neni 120/1 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve ndërmjet konsumatorëve dhe sipërmarrësve 1. Nëse një mosmarrëveshje mes një pajtimtari i cili është konsumator dhe një sipërmarrësi që ofron shërbime të komunikimit publik nuk mund të zgjidhet nëpërmjet procedurave për trajtimin e ankesave sipas nenit 107 të këtij ligji, pajtimtari mund të kërkojë nga AKEP të zgjidhë mosmarrëveshjen. 2. Kërkesa e pajtimtarit referuar në pikën 1 të këtij neni paraqitet me shkrim dhe duhet të përmbajë fakte dhe prova në të cilat është bazuar. Kërkesa duhet të paraqitet brenda 30 ditëve pasi pajtimtari të ketë marrë nga sipërmarrësi përgjigjen me shkrim të referuar në nenin 107 pika 4 e këtij ligji.	Neni I ri I propozuar 120/1 garanton procedurat për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërmjet konsumatorëve dhe operatorëve, jashtë gjykatave, sic parashikohet në nenin 34 të Direktivës së Shërbimit Universal. Merr gjithashtu parasysh amendimet e nenit 34. Në përgjithësi mosmarrëveshjet duhet të zgjidhen mes konsumatorëve dhe operatorit. Operatori do të detyrohet të zbatojë një skemë të përshtatshme për trajtimin e ankesave. Vetëm në çështjet kur një zgjidhje nuk mund të gjendet, AKEP duhet të funksionojë si arbitër. Nëse një autoriteti rregullator I jepet detyra që të zgjidhë mosmarrëveshjet e konsumatorëve, kjo nga njëra anë është një burim I rëndësishëm informacioni. Ky funksion zëvendëson në një farë mase nevojën për inspektim. Rregullatori nuk ka nevojë që të kërkojë aktivisht për raste

Amendimet e propozuara në ligjin 9918 për komunikimet elektronike

Neni	Arsyeja	Teksti aktual	Teksti i propozuar	Shpjegim
			<p>3. AKEP do të zgjidhë mosmarrëveshjet në mënyrë transparente, të thjeshtë, objektive dhe jodiskriminuese.</p> <p>4. Sipërmarrësit që ofrojnë shërbime të komunikimeve elektronike duhet të marrin pjesë në procedurat për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, duhet të bashkëpunojnë me AKEP me qëllim zgjidhjen e mosmarrëveshjes dhe t'i paraqesin AKEP të gjitha të dhënat e nevojshme.</p> <p>5. Kur AKEP të ketë shqyrtuar të gjitha provat në dispozicion, AKEP i paraqet pajtimtarit dhe sipërmarrësit një rekomandim me shkrim si duhet zgjidhur mosmarrëveshja. Nëse të dy, pajtimtari dhe sipërmarrësi pranojnë rekomandimin brenda 15 ditëve, ato bëhen të detyrueshme. Në rast të kundërt, secila palë mund ta referojë rastin në gjykatën kompetente sipas Kodit të Procedurës Administrative.</p> <p>6. AKEP përcakton procedurat për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve me anë të rregullores. Procedura për zgjidhjen e mosmarrëveshjes është pa pagesë. Konsumatori dhe sipërmarrësi i mbulojnë shpenzimet e tyre.</p> <p>7. Nëse AKEP konstaton se një çështje e caktuar është subjekt i shumë kërkesave për zgjidhje të mosmarrëveshjeve me një sipërmarrës të caktuar, AKEP ekzaminon nëse procedura për trajtimin e ankesave sipas nenit 107 të këtij ligji zbatohet në mënyrë të duhur nga sipërmarrësi. Nëse është e nevojshme, AKEP detyron</p>	<p>moszbatimi, pasi problemet më urgjente për konsumatorët do të bëhen menjëherë të dukshme për rregullatorin gjatë procesit të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve.</p> <p>Nga ana tjetër ka një rrezik që rregullatori të mbytet nga ankesat, të cilat mund të dëmtojnë efektshmërinë e rregullatorëve në fusha më të rëndësishme. Një rregullator nuk duhet të zgjidhe problemet rast pas rasti, por duke amenduar rregullat në një mënyrë të tillë që problemet të mos ndodhin që në fillim. Dispozita e propozuar parashikon mundësinë që AKEP të reduktojë numrin e ankesave që vijnë nga operatorët e detyruar për të rritur kapacitetin e menaxhimit të trajtimit të ankesave, për shembull trajtimi I disa çështjeve në një mënyrë të caktuar.</p> <p>Meqë procedura e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve jashtë gjykatave duhet të jetë e shpejtë dhe e thjeshtë, AKEP nuk do të jetë në gjendje që të hetojë çështjet në mënyrë të hollësishme sic mund të bëjë gjykata. Prandaj është parashikuar që AKEP të mos lëshojë një vendim detyrues, por një rekomandim jo-detyrues. Nëse të dy palët e pranojnë rekomandimin, ai bëhet I detyrueshëm. Përndryshe, cdo palë mund t'ia referojë çështjen gjykatës kompetente.</p>

Amendimet e propozuara në ligjin 9918 për komunikimet elektronike

Neni	Arsyeja	Teksti aktual	Teksti i propozuar	Shpjegim
			sipërmarrësin të përmirësojë procedurat për trajtimin e ankesave.	
122	BE 2009	<p>Neni 122</p> <p>Masat mbrojtëse</p> <p>1. Sipërmarrësit e rrjeteve dhe të shërbimeve të komunikimeve elektronike publike janë të detyruar që, individualisht ose kur është e nevojshme, në bashkëpunim me njëri-tjetrin, të zbatojnë masa teknike dhe organizative, për të realizuar sigurinë e rrjeteve dhe/ose të shërbimeve, të ofruara prej tyre.</p> <p>2. Këto masa duhet të sigurojnë një nivel të mbrojtjes dhe sigurisë së përshtatshme ndaj rreziqeve të mundshme, të parashikuara.</p> <p>3. Sipërmarrësit e rrjeteve dhe të shërbimeve të komunikimeve elektronike publike janë të detyruar të informojnë përdoruesit e tyre për një rrezik të veçantë, mënyrën se si rreziku mund të reduktohet nga përdoruesit, si dhe kostot e mundshme, që duhet të mbulohen nga përdoruesi, nëse rreziku që ndodh është jashtë masave, që mund të marrë sipërmarrësi.</p>	<p>Neni 122</p> <p>Integriteti dhe siguria e rrjetit dhe shërbimeve</p> <p>1. Sipërmarrësit e rrjeteve dhe të shërbimeve të komunikimeve elektronike publike janë të detyruar që, individualisht ose kur është e nevojshme, në bashkëpunim me njëri-tjetrin, të zbatojnë masa teknike dhe organizative, për të realizuar sigurinë e rrjeteve dhe/ose të shërbimeve, të ofruara prej tyre.</p> <p>2. Këto masa duhet të sigurojnë një nivel të mbrojtjes dhe sigurisë së përshtatshme ndaj rreziqeve të mundshme, të parashikuara. Masat duhet që të paktën:</p> <p>a) të sigurojnë që të dhënat personale janë të aksesueshme vetëm nga personeli i autorizuar për qëllime ligjore të autorizuar;</p> <p>b) të mbrojnë të dhënat personale të ruajtura ose të transmetuara nga aksidentet ose nga shkatërrimi i kundërligjshëm, humbja ose ndryshimi aksidental dhe ruajtja e paautorizuar ose e jashtëligjshme; dhe</p> <p>c) të sigurojnë implementimin e politikave të sigurisë lidhur me përpunimin e të dhënave personale.</p> <p>3. Sipërmarrësit e rrjeteve dhe të shërbimeve të komunikimeve elektronike publike janë të detyruar të informojnë përdoruesit e tyre për</p>	<p>Amendimet e propozuara të nenit 122 transpozojnë nenin e ri 4 të direktivës së Privatësisë dhe nenet e reja 13a dhe 13b të Direktivës Kuadër, që përshkruan masa sigurie më të hollësishme dhe detyrimin për të informuar pajtimtarët ose përdoruesit kur një shkelje e të dhënave personale ndodh.</p>

Amendimet e propozuara në ligjin 9918 për komunikimet elektronike

Neni	Arsyeja	Teksti aktual	Teksti i propozuar	Shpjegim
			<p>një rrezik të veçantë, mënyrën se si rreziku mund të reduktohet nga përdoruesit, si dhe kostot e mundshme, që duhet të mbuloohen nga përdoruesi, nëse rreziku që ndodh është jashtë masave, që mund të marrë sipërmarrësi.</p> <p>4. Në rast të shkeljes së të dhënave personale, sipërmarrësi që ofron shërbime të komunikimeve elektronike të vlefshme për publikun do të njoftojë AKEP pa vonesë për këtë shkelje.</p> <p>5. Kur një shkelje e të dhënave personale mund të ndikojë për keq në të dhënat personale dhe privatësinë e pajtimtarit ose individit, sipërmarrësi gjithashtu do të njoftojë pa vonesë pajtimtarin ose individin për shkeljen.</p> <p>6. Nëse sipërmarrësi i ka vërtetuar AKEP që i ka zbatuar masat e nevojshme mbrojtëse teknologjike dhe këto masa janë aplikuar për të dhënat përkatëse atëherë nuk kërkohet nga sipërmarrësi të njoftojë pajtimtarin ose individin për shkeljen e të dhënave personale. Këto masa mbrojtëse teknologjike i bëjnë këto të dhëna të palexueshme për çdo person që nuk ka akses të autorizuar në këto të dhëna.</p> <p>7. Pa paragjykim ndaj detyrimit të sipërmarrësit për të njoftuar pajtimtarët dhe individët në fjalë, nëse sipërmarrësi nuk e ka njoftuar pajtimtarin ose individin për shkelje të të dhënave personale, AKEP, pasi të ketë marrë parasysh ndikimin për keq të shkeljes, mund të kërkojë që sipërmarrësi të njoftojë pajtimtarin.</p>	

Amendimet e propozuara në ligjin 9918 për komunikimet elektronike

Neni	Arsyeja	Teksti aktual	Teksti i propozuar	Shpjegim
			<p>8. Njoftimi i pajtimtarit ose individit do të përshkruajë, të paktën, natyrën e shkeljes së të dhënave personale dhe personin e kontaktit ku mund të merret informacion më i detajuar dhe do të rekomandojë masa për të minimizuar efektet e mundshme të këqija të shkeljes së të dhënave personale. Njoftimi për AKEP, përveç kësaj, përshkruan pasojat dhe masat e propozuara ose të ndërmarra nga ofruesi për shkeljen e të dhënave personale.</p> <p>9. Sipërmarrësit mbajnë një inventar të shkeljeve të të dhënave personale, që përmban fakte lidhur me këto shkelje, ndikimin e tyre dhe masat e ndërmarra rregullatore, të mjaftueshme për t'i mundësuar autoriteteve kompetente kombëtare verifikimin e përputhjes me përcaktimet e paragrafit 3. Ky inventar do të përfshijë vetëm informacion të nevojshëm për këtë qëllim.</p> <p>10. AKEP mund të përcaktojë detyrimet e pikave 1 deri 9 të këtij neni me detaje me anë të një rregulloreje. Në veçanti AKEP mund të kërkojë që sipërmarrësit:</p> <p>a) të ofrojnë informacion të nevojshëm për të vlerësuar sigurinë dhe / ose integritetin e shërbimeve dhe rrjeteve, duke përfshirë politika të dokumentuara të sigurisë; dhe</p> <p>b) t'i paraqesin auditit të sigurisë të kryer nga një organ i certifikuar dhe i pavarur ose nga një autoritet kompetent kombëtar rezultatet dhe në këtë mënyrë t'i vënë ato në dispozicion të AKEP. Kosto e auditit do</p>	

Amendimet e propozuara në ligjin 9918 për komunikimet elektronike

Neni	Arsyeja	Teksti aktual	Teksti i propozuar	Shpjegim
			<p>të paguhet nga sipërmarrësi.</p> <p>11. Në rast të shkeljes së sigurisë ose kur auditi i sigurisë zbulon masa jo të mjaftueshme të sigurisë, AKEP detyron sipërmarrësit të zbatojnë masat e nevojshme të sigurisë me një vendim. AKEP mund të përcaktojë kërkesat minimale për masat që duhet të merren dhe afatet kohore për zbatimin e tyre.</p> <p>12. AKEP mund të informojë vetë publikun ose të kërkojë nga sipërmarrësi që ta njoftojë atë, nëse vlerëson që bërja publike e kësaj shkelje është në interes të publikut.</p> <p>13. AKEP mund të shkëmbejë informacion për shkeljet e sigurisë me Komisionin Europian, Rrjetet Europiane dhe Agjencinë për Sigurinë e Informacionit (ENISA) si dhe me autoritetet kompetente në vendet e tjera.</p>	
123	BE 2009	<p>Neni 123</p> <p>Konfidencialiteti i komunikimit</p> <p>...</p> <p>6. Përdorimi i rrjeteve të komunikimit elektronik për ruajtjen e të dhënave apo për marrjen e aksesit në të dhënat e ruajtura në pajisjet fundore të pajtimtarit ose të përdoruesit për përpunim të mëtejshëm lejohet vetëm në rastet kur sipërmarrësi i rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike publike:</p> <p>a) ka informuar paraprakisht pajtimtarin ose</p>	<p>Neni 123</p> <p>Konfidencialiteti i komunikimit</p> <p>...</p> <p>6. Përdorimi i rrjeteve të komunikimit elektronik për ruajtjen e të dhënave apo për marrjen e aksesit në të dhënat e ruajtura në pajisjet fundore të pajtimtarit ose të përdoruesit për përpunim të mëtejshëm lejohet vetëm në rastet kur pajtimtari ose përdoruesinë fjalë ka dhënë miratimin e tij / saj, duke ofruar informacion të qartë dhe gjithëpërfshirës për qëllim të përpunimit. Kjo nuk</p>	<p>Dispozita e re për 'cookies' në nenin 5 paragrafi 3 të Direktivës së Privatësisë do të parashikojë se ofruesit duhet të pyesin përdoruesin ose pajtimtarin për lejimin e tij paraprak, ndërsa sipas ligjit aktual do të ishte e mjaftueshme që përdoruesit t'i jepej mundësia për të refuzuar një përpunim të tillë. Propozim: të amendohet neni 123 pika 6 e ligjit 9918 në këtë mënyrë.</p>

Amendimet e propozuara në ligjin 9918 për komunikimet elektronike

Neni	Arsyeja	Teksti aktual	Teksti i propozuar	Shpjegim
		<p>përdoruesin për qëllimin e përpunimit të këtyre të dhënave;</p> <p>b) i jep pajtimtarit ose përdoruesit të drejtën për të mos e pranuar këtë kërkesë;</p> <p>c) i siguron pajtimtarit ose përdoruesit mënyrën dhe pikën e kontaktit, për të refuzuar.</p> <p>7. ...</p>	<p>parandalon çdo ruajtje teknike ose ose akses në të dhëna vetëm për transmetimin e komunikimit në një rrjet të komunikimeve elektronike, ose nëse kjo është e domosdoshme në mënyrë që ofruesi i shërbimit të shoqërisë së informacionit të ofrojë shërbimin nëse kërkohet në mënyrë të qartë nga pajtimtari.</p> <p>7. ...</p>	
124	BE 2002	<p>Neni 124</p> <p>Të dhëna për trafikun e komunikimit</p> <p>...</p> <p>6. Operatorët dhe ofruesit e shërbimeve të rrjeteve publike të komunikimit janë të detyruar t'i japin AKEP-it, për zhvillimin e veprimtarive të parashikuara nga ky ligj, të dhëna për trafikun, pas një kërkesë paraprake.</p>	<p>Neni 124</p> <p>Të dhëna për trafikun e komunikimit</p> <p>...</p> <p>6. Operatorët dhe ofruesit e shërbimeve të rrjeteve publike të komunikimit janë të detyruar t'i japin AKEP-it nëse këto të dhëna janë të domosdoshme për procedimin e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve sipas nenit 120 ose 120/1 të këtij ligji.</p>	<p>Neni 124 pika 6 e ligjit 9918 deyturon operatorët që të paraqesin të dhëna trafiku tek AKEP-i me kërkesë “për qëllim të procedimeve sipas këtij ligji”. Sipas dispozitës korresponduese në nenin 6 paragrafi 6 të Direktivës së Privatësisë të dhënat e trafikut mund të kërkohen vetëm për zgjidhjet e mosmarrëveshjeve për interkoneksion ose të faturimit.</p> <p>Amendimi I propozuar ndryshon nenin 124 pika 6.</p>
130	BE 2002	<p>Neni 130</p> <p>Numërori</p> <p>1. Përveç sa parashikohet në nenin 104 të këtij ligji, pajtimtarët duhet të informohen pa pagesë për qëllimin e numërorit dhe për të gjitha të dhënat, që do të përfshihen në numëror, para se ai të botohet. Shpenzimet e informimit të pajtimtarëve duhet të përballohen nga sipërmarrësi.</p> <p>2. Pajtimtarët duhet të kenë mundësinë të vendosin se cilat nga të dhënat e tyre personale,</p>	<p>(hiqet)</p>	<p>Shih nenin 104</p>

Amendimet e propozuara në ligjin 9918 për komunikimet elektronike

Neni	Arsyeja	Teksti aktual	Teksti i propozuar	Shpjegim
		të parashikuara në pikën 1 të nenit 129 të këtij ligji, do të përfshihen në një numëror publik. Pajtimtarët mund të verifikojnë të dhënat e tyre vetjake dhe të kërkojnë korrigjimin ose fshirjen e tyre. 3. Refuzimi për t'u përfshirë në numëror, verifikimi, ndryshimi ose fshirja e të dhënave vetjake tarifohen në bazë të kostove reale.		
132	të tjera	Neni 132 Inspektimi 1. Inspektimi i veprimtarisë së sipërmarrësit të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike publike ose çdo personi tjetër fizik apo juridik, që zhvillon veprimtari në fushën e komunikimeve elektronike, kryhet nga inspektorët e AKEP-it. 2. Inspektorët e AKEP-it pajisen me dokument të posaçëm identifikimi. Ata kryejnë inspektim në mjediset, ku sipërmarrësi zhvillon veprimtarinë edhe pa e njoftuar paraprakisht, për të verifikuar zbatimin e dispozitave të këtij ligji dhe të rregullave përkatëse, të nxjerra në zbatim të tij. 3. Sipërmarrësi ose çdo person tjetër, fizik apo juridik, që zhvillon veprimtari në fushën e komunikimeve elektronike, është i detyruar t'i lejojë inspektorët të kryejnë inspektimin kudo ku ka pajisje të komunikimeve elektronike, si dhe t'i ofrojnë inspektorëve të gjitha të dhënat dhe dokumentacionin e kërkuar prej tyre. 4. Kur nevojitet ekspertizë e veçantë, inspektori	Neni 132 Inspektimi Pika 1 deri në 4 e pandryshuar 5. Apelimet ndaj vendimeve të inspektorëve të AKEP-it sipas nenit 132 deri 135 të këtij ligji mund t'i paraqiten Këshillit Drejtues të AKEP-it Brenda 10 ditësh që nga dita që është marrë vendimi. Këshilli drejtues vendos për ankimin Brenda 30 ditëve që nga dita e ankimit.	Ne sugjerojmë që dispozita për ankimet ndaj vendimeve të inspektorëve të AKEP-it të zhvendoset nga neni 136 tek ky nen për të sqaruar se kjo zbatohet ndaj të gjithë vendimeve të inspektorëve. Ankimet e tjera ndaj vendimeve të Këshillit Drejtues trajtohen në nenin 115 pika 6. Meqë AKEP-I është një organ qëndror ne sugjerojmë që të gjitha ankimet të shqyrtohen nga e njëjta gjykatë (gjykata e Rrethit të Tiranës dhe më vonë mund të jetë gjykata administrative), kurse sipas ligjit actual ankimet ndaj vendimeve të Këshillit Drejtues për kundërvajtjet shyrtohen nga Gjykata e rrethit ky është kryer kundërvajtja. Kjo e fundit është e vështirë që të caktohet në shumë raste, pasi shumë kundërvajtje kanë të bëjnë me një sjellje të një sipërmarrësi që ka të bëjë me të gjithë vendin (psh refuzimi për të interkonektuar).

Amendimet e propozuara në ligjin 9918 për komunikimet elektronike

Neni	Arsyeja	Teksti aktual	Teksti i propozuar	Shpjegim
		mund të kërkojë ekspert.		
136 I vjetër	të tjera	<p>Neni 136 Ankimi</p> <p>1.Kundër gjobës së vendosur nga inspektori, sipas shkronjës ”a” të pikës 1 të nenit 135 të këtij ligji, bëhet ankim në Këshillin Drejtues të AKEP-it, brenda 10 ditëve nga data e dhënies së saj. Këshilli Drejtues merr vendim brenda 30 ditëve nga data e ankimit. Kundër vendimit të këshillit drejtues të AKEP-it mund të bëhet ankim, brenda 30 ditëve nga data e shpalljes ose e njoftimit në gjykatën e rrethit, ku është kryer kundërvajtja.</p> <p>2. Kundër vendimeve të Këshillit Drejtues të AKEP-it, sipas pikës 3 të nenit 134 të këtij ligji, mund të bëhet ankim në Gjykatën e Tiranës, brenda 30 ditësh nga marrja e vendimit.</p>	(zhvendosur tek një nen tjetër)	<p>Neni 136 trajton vetëm disa raste ankimesh.</p> <p>Pika 1 trajton ankimet ndaj gjobave të vendosura nga inspektorët, por jo ankimet ndaj vendimeve të inspektorëve psh për bllokimin e pajisjeve.</p> <p>Pika 2 trajton vetëm një tip jot ë zakonshëm të vendimeve të Këshillit Drejtues.</p> <p>Ne sugjerojmë që të trajtohen ankimet ndaj të gjitha llojeve të vendimeve të inspektorëve në nenin 132 dhe ankimet ndaj të gjitha llojeve të vendimeve të Këshillit Drejtues në nenin 115 pika 6.</p>
136 I	të tjera		Neni 136	Shih komentet më lart në hyrje.

Amendimet e propozuara në ligjin 9918 për komunikimet elektronike

Neni	Arsyeja	Teksti aktual	Teksti i propozuar	Shpjegim
ri			<p>Gjobat për shkeljet e rënda</p> <p>1. Shkeljet e mëposhtme, kur nuk përbëjnë vepër penale, do të konsiderohen kundërvajtje administrative. Këshilli drejtues I AKEP-it me vendim cakton gjoba sipas pikës 2 deri në 8 të këtij neni.</p> <p>2. Një gjobë deri në masën 10% të të ardhurës vjetore të vitit të mëparshëm të biznesit do të vendoset mbi personat juridik nëse personi juridik:</p> <p>a. Nuk zbaton detyrimin për transparencë sipas nenit 40 të këtij ligji;</p> <p>b. Nuk zbaton detyrimin për mosdiskriminim sipas nenit 39 të këtij ligji;</p> <p>c. Nuk zbaton detyrimin për mbajtjen e llogarive të ndara sipas nenit 41 të këtij ligji;</p> <p>d. Nuk zbaton detyrimet, që lidhen me kontrollin e tarifave ose llogaritjen e kostos, sipas neneve 45 dhe 59 të këtij ligji;</p> <p>e. Nuk zbaton vendimin e AKEP-it për rregullimin e tarifave, sipas nenit 58 të këtij ligji;</p> <p>f. Nuk zbaton urdhrin e AKEP-it për lidhjen e marrëveshjes për akses dhe intrekoneksion, sipas nenit 60 të këtij ligji;</p> <p>g. Nuk zbaton detyrimet e imponuara, që lidhen me sigurimin e një minimumi linjash me qira, sipas nenit 44 të këtij ligji;</p> <p>h. Nuk zbaton detyrimet e imponuara, që lidhen me lejimin e aksesit dhe përdorimin e faciliteteve të një rrjeti specifik, sipas neneve 46 dhe 47 të këtij ligji;</p> <p>i. Nuk zbaton detyrimet e imponuara, që lidhen</p>	<p>Kjo dispozitë merret me gjobat e shkeljeve të rënda që vendosen nga Këshilli Drejtues.</p> <p>Pika 2 deri në 4 përmban listën e shkeljeve më të rënda, dhe pikat 5 deri në 7 kategorinë e dytë të shkeljeve.</p> <p>Pika 5 duhet të numërtohet në procesin e përfundimit të projektligjit.</p> <p>Dispozita e pikës 4 a/1 zbaton detyrimin për paraqitjen e informacionit AKEP-it dhe Ministrin. Përqasja më sistematike është që AKEP të vendosë për kundërvajtjet. Nëse ministri do të ishte kompetent për kundërvajtjen për ofrimin, do të ishte e vetmja dispozitë kundërvajtjeje për Ministrin në këtë ligj dhe do të kërkonte rregulla të vecanta për ankimet.</p>

Amendimet e propozuara në ligjin 9918 për komunikimet elektronike

Neni	Arsyeja	Teksti aktual	Teksti i propozuar	Shpjegim
			<p>me sigurimin e zgjedhjes ose parazgjedhjes së bartësit, sipas nenit 43 të këtij ligji;</p> <p>j. Nuk zbaton detyrimet për ofertën referencë, sipas nenit 52 të këtij ligji;</p> <p>3. Një gjobë deri në masën 5% të të ardhurës vjetore të vitit të mëparshëm të biznesit do të vendoset mbi sipërmarrësit që janë persona fizikë, nëse sipërmarrësi ka kryer një kundërvajtje sipas pikës 2 të këtij neni.</p> <p>4. Një gjobë deri në masën 10 milionë Lek do të vendoset mbi personin juridik nëse personi juridik:</p> <p>a. nuk njofton AKEP-in para fillimit të ndërtimit dhe përdorimit të rrjeteve ose shërbimeve të komunikimeve elektronike sipas nenit 14 të këtij ligji;</p> <p>a/1. nuk jep informacionin e kërkuar nga AKEP ose Ministri sipas nenit 16 të këtij ligji;</p> <p>b. Nuk ka krijuar një person juridik të veçantë, ose nuk ka ndarë llogaritë financiare të të ardhurave nëse përdor rrjete apo shërbime publike komunikimi për vetveten, me qëllim ofrimin e shërbimit publik të komunikimit, sipas pikës 2 të nenit 23 të këtij ligji;</p> <p>c. Nuk siguron shërbimin universal sipas kërkesave të nenit 25 të këtij ligji;</p> <p>d. Përdor frekuenca pa marrë autorizim për përdorimin e tyre, sipas nenit 65 të këtij ligji;</p> <p>e. Përdor numra dhe seri numerike pa miratim të AKEP-it, sipas nenit 81 të këtij ligji;</p>	

Amendimet e propozuara në ligjin 9918 për komunikimet elektronike

Neni	Arsyeja	Teksti aktual	Teksti i propozuar	Shpjegim
			<p>f. Nuk jep të dhëna për rrjetin, sipas nenit 92 të këtij ligji;</p> <p>g. Kryen mbikëqyrje, përgjim, ndërprerje, regjistrim, ruajtje dhe devijim të komunikimit dhe të dhënave, në kundërshtim me kërkesat e nenit 123 pika 3 të këtij ligji;</p> <p>h. Nuk përmbush detyrimet për përgjimin e ligjshëm, sipas nenit 131 të këtij ligji;</p> <p>i. Nuk lejon inspektorët e AKEP-it të hyjnë në mjediset, ku gjenden pajisjet e komunikimit dhe pajisjet teknike, ose nuk dorëzon të dhënat dhe dokumentacionin e kërkuar nga inspektorët, sipas nenit 132 pika 3 të këtij ligji;</p> <p>j. Nuk ndërton apo krijon rrjete publike të komunikacioneve dhe facilitete shtesë që lidhen me to, për të mundësuar përdorimin e përbashkët të tyre, sipas pikës 1 të nenit 22 të këtij ligji;</p> <p>k. Nuk zbaton vendimin e AKEP-it për pagesën e përdorimit të përbashkët të rrjeteve dhe faciliteteve për sigurimin e rrjeteve dhe shërbimeve publike të komunikimit, sipas pikës 7 të nenit 22 të këtij ligji;</p> <p>l. Në rast se sipërmarrësi i caktuar si ofrues i shërbimit universal për publikimin e numërorit bën diskriminimin në përfshirjen e të dhënave të operatorëve të ndryshëm në numërorin e përgjithshëm ose në rubrikën e shërbimeve të informacionit, sipas nenit 25 të këtij ligji;</p> <p>m. Nuk zbaton tarifa të njëjta për shërbimet e siguruara nën skemën e shërbimit universal në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë,</p>	

Amendimet e propozuara në ligjin 9918 për komunikimet elektronike

Neni	Arsyeja	Teksti aktual	Teksti i propozuar	Shpjegim
			<p>sipas pikës 2 të nenit 27 të këtij ligji;</p> <p>n. Nuk përcakton tarifat dhe kushtet e përgjithshme të pagesës për shërbimet e veçanta të përfshira në skemën e shërbimit universal, sipas pikës 4 të nenit 27 të këtij ligji;</p> <p>o. Nuk përmbush parametrat e cilësisë, për të paktën 3 periudha të njëpasnjëshme, sipas pikës 5 të nenit 28 të këtij ligji;</p> <p>p. Nuk bën pagesën e nevojshme të kontributeve për mbulimin e kostove reale të shërbimit universal, brenda afatit kohor dhe në vlerën e përcaktuar nga AKEP-i, sipas pikës 4 të nenit 30 të këtij ligji;</p> <p>q. Nuk paraqet në AKEP informacionin e kërkuar mbi të ardhurat vjetore, sipas pikës 5 të nenit 30 të këtij ligji;</p> <p>r. Nuk i përgjigjet kërkesës për dhënie e ofertës së aksesit brenda afatit, sipas pikës 1 të nenit 46 të këtij ligji;</p> <p>s. Nuk plotëson detyrimin për interkoneksion, sipas pikës 1 të nenit 47 të këtij ligji;</p> <p>t. Nuk plotëson detyrimet për mbrojtjen e konfidencialitetit të të dhënave që shkëmbehen gjatë negociimit të interkoneksionit, sipas pikës 2 të nenit 47 të këtij ligji;</p> <p>u. Transferon të drejtën e përdorimit të frekuencave pa miratimin paraprak të AKEP-it, sipas pikës 1 të nenit 74 të këtij ligji;</p> <p>v. Nuk zbaton portabilitetin e numrit për pajtimtarët e tij, sipas nenit 87 të këtij ligji;</p> <p>w. Nuk publikon informacion transparent për tarifat dhe për kushtet e përgjithshme për</p>	

Amendimet e propozuara në ligjin 9918 për komunikimet elektronike

Neni	Arsyeja	Teksti aktual	Teksti i propozuar	Shpjegim
			<p>aksesin dhe përdorimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike publike, sipas pikës 1 të nenit 98 të këtij ligji;</p> <p>x. Nuk informon përdoruesit dhe AKEP-in për kufizimin ose ndalimin e aksesit në shërbimet e tyre, sipas pikës 2 të nenit 108 të këtij ligji;</p> <p>y. Kufizon aksesin në shërbimet e tij, ndërpret ose përfundon kontratën e pajtimtarëve në kundërshtim me përcaktimin e kontratës, sipas pikës 1 të nenit 109 të këtij ligji;</p> <p>z. Zbaton masa diskriminuese dhe jo-proporcionale, ndryshe nga sa përcaktohet në nenin 109 të këtij ligji;</p> <p>aa. Nuk informon me shkrim pajtimtarët e tij për shkeljet e bëra prej tyre, dhe nuk vendos një afat kohor për plotësimin e detyrimeve kontraktore, sipas pikës 3 të nenit 109 të këtij ligji;</p> <p>bb. Nuk harton dhe paraqet në AKEP planin e masave për situata të jashtëzakonshme, sipas pikës 2 të nenit 111 të këtij ligji;</p> <p>cc. Nuk përmbush detyrimet e pikës 1 të nenit 112 të këtij ligji;</p> <p>dd. Nuk siguron akses të pandërprerë në shërbimet e emergjencës brenda planit të masave, sipas nenit 113 të këtij ligji;</p> <p>ee. Nuk mbron dhe ruan konfidencialitetin e komunikimeve elektronike, sipas pikës 2 të nenit 121 të këtij ligji;</p> <p>ff. Përfiton për vete ose për ndonjë palë tjetër informacion mbi përmbajtjen, faktet dhe rrethanat e transmetimit të mesazhit në tejkallim të nivelit minimal të nevojshëm për ofrimin e</p>	

Amendimet e propozuara në ligjin 9918 për komunikimet elektronike

Neni	Arsyeja	Teksti aktual	Teksti i propozuar	Shpjegim
			<p>shërbimeve elektronike specifike, apo nuk i përdor këto të dhëna vetëm për ofrimin e shërbimit dhe në përputhje me kontratën specifike, sipas pikës 3 të nenit 123 të këtij ligji;</p> <p>gg. Nuk informon përdoruesit në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme për qëllimin dhe përdorimin e të dhënave, apo nuk i jep mundësinë përdoruesit të refuzojë përdorimin e të dhënave, apo nuk merr miratimin paraprak të përdoruesit për përdorimin e të dhënave, sipas pikës 6 të nenit 123 të këtij ligji;</p> <p>hh. Nuk fshin të dhënat mbi trafikun, apo nuk i bën anonime këto të dhëna pas përfundimit të nevojës për transmetim të mesazhit, sipas pikës 1 të nenit 124 të këtij ligji;</p> <p>ii. Përpunon të dhëna mbi trafikun pa miratimin paraprak të përdoruesit apo pajtimtarit, sipas pikës 3 të nenit 124 të këtij ligji;</p> <p>jj. Lejon persona të paaautorizuar të përpunojnë të dhëna mbi trafikun, sipas pikës 5 të nenit 124 të këtij ligji;</p> <p>kk. Nuk përpunon të dhëna për vendndodhjen, sipas përcaktimeve të nenit 126 të këtij ligji;</p> <p>ll. Lejon përdorimin e të dhënave mbi vendndodhjen nga ana e personave të paaautorizuar, sipas pikës 5 të nenit 126 të këtij ligji;</p> <p>mm. Përdor adresën elektronike të klientit për marketing direkt pa i dhënë të drejtën klientit ta refuzojë atë, sipas pikës 2 të nenit 128 ;</p> <p>nn. Përdor identitet të rremë, apo adresë të rreme në marketing gjatë përdorimit të</p>	

Amendimet e propozuara në ligjin 9918 për komunikimet elektronike

Neni	Arsyeja	Teksti aktual	Teksti i propozuar	Shpjegim
			<p>komunikimeve elektronike, sipas pikës 3 të nenit 128 të këtij ligji .</p> <p>5. Një gjobë deri në masën 5 milionë Lek do të vendoset mbi sipërmarrësit që janë persona fizikë, nëse sipërmarrësi ka kryer një kundërvajtje sipas pikës 4 të këtij neni.</p> <p>6. Të ardhurat vjetore sipas pikës 2 dhe 3 të këtij neni përfshijnë shumën që rrjedh nga viti I mëparshëm I biznesit si rezultat I ofrimit të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike pas zbritjes së taksave drejtpërdrejt të lidhura me të ardhurat. Nëse personi juridik e ka kryer shkeljen në vitin e parë të biznesit, gjoba do të llogaritet në bazë të të ardhurave të përfituara në vitin aktual.</p>	
137	të tjera		<p>Neni 137</p> <p>Gjoba për shkelje të tjera</p> <p>1. Shkeljet e mëposhtme, kur nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë, si më poshtë. Inspektorët e AKEP-it do të vnedosin gjoba sipas pikave 2 deri në 8 të këtij neni.</p> <p>2. Një gjobë deri në masën 1 milion Lek do të vendoset mbi personat juridikë nëse personi juridik:</p> <p>a. Nuk vepron në përputhje me kërkesat për miratimin dhe caktimin e frekuencave, sipas neneve 70 dhe 71;</p> <p>b. Nuk vepron në përputhje me kushtet për</p>	<p>Ky nen mbështetet tek neni aktual 137 pika IV dhe VI dhe trajton gjobat që vendosen nga inspektorët.</p> <p>Në vend të vendosjes së tavanit si përqindje të të ardhurave, vendos një tavan fiks.</p> <p>Ne propozojmë që të mos caktohet një prag (dysHEME), por një fushë të gjerë për rregullimin e gjobës sipas seriozitetit dhe kohëzgjatjes së shkeljes, psh 100,000 deri në 1 milion Lek.</p> <p>Mund të merret në konsideratë që disa prej shkeljeve të kalojnë nga neni 136 pika 4 e këtij neni, ose të ndahet ky nen në shkelje sipas seriozitetit (psh gjoba prej 100,000 deri në 1 milion lek dhe gjoba mbi 100,000lek).</p>

Amendimet e propozuara në ligjin 9918 për komunikimet elektronike

Neni	Arsyeja	Teksti aktual	Teksti i propozuar	Shpjegim
			<p>përdorimin e numrave dhe serive numerike, sipas nenit 83;</p> <p>c. Nuk planifikon rrjetet e komunikimeve elektronike, në mënyrë të tillë që të krijojnë sa më pak rreziqe dhe shqetësime ndaj pronës private, sipas pikës 3 të nenit 93;</p> <p>d. Nuk njofton paraprakisht autoritetet përkatëse përpara fillimit të punimeve, sipas pikës 4 të nenit 93;</p> <p>e. Kontrata e pajtimtarit nuk përmban të gjithë elementet e kërkuara, sipas pikës 1 të nenit 99</p> <p>f. Nuk informon paraprakisht pajtimtarët për ndryshimin e kushteve të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 99;</p> <p>g. Nuk i ofron pajtimtarëve një nivel të kënaqshëm të faturës së detajuar, në mënyrë që të lejojë pajtimtarin të kontrollojë shumën përfundimtare, sipas nenit 106;</p> <p>h. Fatura e detajuar nuk i përmban të gjitha të dhënat, sipas pikës 3 të nenit 106;</p> <p>i. Nuk siguron identifikimin e numrit të thirrur, si dhe parandalimin e tyre, sipas pikës 1 të nenit 125;</p> <p>j. Në kushtet e përgjithshme të kontratës së pajtimtarit nuk saktëson mundësinë e sigurimit të CLI (identifikimin e numrit të thirrur), si dhe parandalimin e tij, sipas pikës 8 të nenit 125;</p> <p>k. Nuk informon përdoruesin apo pajtimtarin për elementet e përshkruara në pikës 3 të nenin 126 të këtij ligji, para se ato të japin miratimin e tyre për përpunimin e të dhënave;</p> <p>l. Nuk i ofron përdoruesit apo pajtimtarit</p>	

Amendimet e propozuara në ligjin 9918 për komunikimet elektronike

Neni	Arsyeja	Teksti aktual	Teksti i propozuar	Shpjegim
			<p>mundësinë e refuzimit të përkohshëm të përpunimit të të dhënave të vendndodhjes, sipas pikës 4 të nenit 126 të këtij ligji;</p> <p>m. Nëse të dhënat e pajtimtarit përdoren në kundërshtim me pikën 2 të nenit 129;</p> <p>n. Nuk informon pa pagesë dhe paraprakisht pajtimtarin për numërorin dhe përdorimin e të dhënave në numëror, sipas pikës 1 të nenit 130 të këtij ligji;</p> <p>o. Nuk i ofron mundësinë përdoruesit se cilat prej të dhënave dëshiron të përfshihen në numëror, sipas pikës 2 të nenit 130;</p> <p>p. Refuzon që pa pagesë të mundësojë pajtimtarin që të verifikojë, të ndryshojë apo të fshijë të dhënat e numërorit, sipas pikës 3 të nenit 130;</p> <p>q. Nuk paguan shumën e plotë për mbikëqyrjen e tregut, sipas pikës 3 të nenit 24;</p> <p>r. Nuk paguan në kohë shumën e plotë për caktimin dhe përdorimin e frekuencave, sipas nenit 78;</p> <p>s. Nuk paguan në kohë shumën e plotë për caktimin dhe përdorimin e numrave dhe serive numerike, sipas nenit 86;</p> <p>t. nuk zbaton një vendim të AKEP-it që nuk është përmendur në nenin 136 ose më lart.</p> <p>3. Një gjobë në masën 500,000 Lek do të vendoset mbi sipërmarrësit që janë persona fizikë nëse sipërmarrësi ka kryer një kundërvajtje të përcaktuar në nenin 2 të këtij ligji.</p>	
137/	të tjera		Neni 137/1	Pika 1 jep udhëzime për përcaktimin e masës së

Amendimet e propozuara në ligjin 9918 për komunikimet elektronike

Neni	Arsyeja	Teksti aktual	Teksti i propozuar	Shpjegim
1			<p>Vendosja dhe ekzekutimi I gjobave</p> <p>1. Në vendosjen e gjobave sipas neneve 136 dhe 137 të këtij ligji, do të merret parasysh serioziteti dhe kohëzgjatja e shkeljes. Kur është e mundur të llogariten ose të vlerësohen objektivisht përfitimet e paligjshme të sipërmarrësve të realizuara nga shkelja e këtij ligji, ky përfitim përbën vlerën minimale të gjobës.</p> <p>2. gjobat e vendosura sipas neneve 136 dhe 137 të këtij ligji janë tituj ekzekutivë që mblidhen nga AKEP-I dhe I shkojnë buxhetit të shtetit.</p>	<p>gjobës sipas parashikimeve të neneve 136 dhe 137. Mbështetet në nenin 75 pika 1 e ligjit për “Mbrojtjen e Konkurrencës”.</p> <p>Pika 2 mbështetet në nenin 137 pika 2.</p>
138	BE 2009	(nuk ka pikë 5)	<p>5. AKEP do të imponojë detyrime rregullatore sipas neneve 43 dhe 44 të këtij ligji për aq sa është e nevojshme për të rregulluar dështimet e tregut dhe nëse detyrimet e imponuara rregullatore për tregjet me shumicë nuk janë të mjaftueshme.</p> <p>6. Neni 120/1 I këtij ligji hyn në fuqi më 1 Janar 2011.</p> <p>7. Procedura e konkurrimit publik sipas nenit 69 të këtij ligji mund të mbështetet në një këshillim publik të kryer para se amendimet e neneve 68 dhe 69 të hynin në fuqi.</p> <p>8. <VKM-ja për pagesat e frekuencave dhe numrat e cila po përgatitet aktualisht>, do të mbetet në fuqi deri më 31 dhjetor 2010. AKEP do të miratojë rregullore për tarifat e frekuencave dhe numrave sipas neneve 78 dhe 86 të këtij ligji, I cili do të hyjë në fuqi</p>	<p>Dispozitat për grupin minimal të linjave me qera dhe për përzgjedhjen e bartësit dhe parapërzgjedhjen e bartësit, do të fshihen nga kuadri rregullator I BE I 2009 (nenet 18 dhe 19 të Direktivës së Shërbimit Universal do të shfuqizohen). Do të ishte gjithsesi me vend që ato të mbaheshin në fuqi për pak kohë në ligjin shqiptar.</p> <p>Dispozita e propozuar tranzitore sqaron se këto detyrime do të shfuqizohen dhe se AKEP do të vendosë detyrime rregullatore sipas nenit 43 dhe 44 të ligjit 9918 për sa kohë që të jetë e nevojshme për të riparuar dështimet e tregut dhe nëse detyrimet e vendosura në tregjet me shumicë nuk janë të mjaftueshme.</p> <p>Dispozita që e bën AKEP-in përgjegjës për zgjidhjen e konflikteve ndërmjet konsumatorëve dhe sipërmarrësve do të hyjë në fuqi në fillim të 2011 pasi AKEP duhet të marrë parasysh detyrat në buxhet dhe të shtojë</p>

Amendimet e propozuara në ligjin 9918 për komunikimet elektronike

Neni	Arsyeja	Teksti aktual	Teksti i propozuar	Shpjegim
			më 1 janar 2011.	personelin.

Amendimet e propozuara për ligjin 8410 “Për radion dhe televizionin public dhe privat në Republikën e Shqipërisë”

Ne propozojmë që të zëvendësohet I gjithë kapitulli IX I ligjit 8410 (nenet 121 deri në 127) me nenin e mëposhtëm:

KAPITULLI IX
PROGRAMET KABLLORE RADIO-TELEVIZIVE

Neni 121
Radio-Televisionet kabllore

1. Shërbimet e programeve për publikun që transmetohen nëpërmjet një rrjeti kabllor radio-televizioni do të jenë në përputhje me këtë ligj në të njëjtën mënyrë dhe në të njëjtën masë si shërbimet për programet kombëtare që transmetohen me platforma tokësore. Këto shërbime mbulohen nga Konventa Europiane për Televizionin.
2. Operatorët e radiove dhe televizioneve të licensuar nga KKRT për transmetimin në mënyrë tokësore të programeve radio dhe televizive kanë të drejtën që t’i ritransmetojnë programet e tyre edhe nëpërmjet rrjeteve kabllore radio-televizive. Operatorët radio dhe televizivë të licensuar nga KKRT për transmetimin e programeve të tyre radio dhe televizive me rrjete kabllore radio-televizive kanë të drejtën që të ritransmetojnë programet e tyre edhe në mënyrë tokësore. KKRT vendos kushtet përkatëse në përputhje me këtë ligj.
3. Një rrjet kabllor radio-televiziv është një rrjet I komunikimeve elektronike dhe shërbimi për të transmetuar sinjalet me anë të një rrjeti kabllor radio-televiziv është një shërbim I komunikimeve elektronike. Ofrimi I rrjeteve dhe shërbimeve të tilla të komunikimeve elektronike rregullohet nga ligji 9918, datë 19.05.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”.

Dy pikat e para të këtij neni 121 mbështeten tek nenet 136 dhe 137 për transmetimin satelitor. Ato thjesht sqarojnë se të njëjtat rregulla që zbatohen nga programeve kombëtare tokësore, zbatohen edhe ndaj programeve (përmbajtjes) së shpërndarë nga rrjetet kabllore. Pika e tretë sqaron se ofrimi I një rrjeti kabllor dhe shërbimi I transportimit të sinjaleve nëpërmjet një rrjeti të tillë është sipas ligjit 9918 dhe jo sipas ligjit 8410.

Amendime të propozuara për Ligjin 9584 “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura të krijuar me ligj”

Në nenin 2 pika 1 e këtij ligji, fjalët “Enti Rregullator i Telekomunikacionit, ” do të hiqet.

Amendimet e propozuara në ligjin 9918 për komunikimet elektronike

Shih komentet e nenit 115 më lart.